

8SH-32

B 82

RAZI BRAHIMI

ZGJIM

PRANVERE

NOVELË

8PI-P83-32

5

1382 RAZI BRAHIMI

ZGJIM PRANVERE

(*novelë*)

~~37471~~

452

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJURAJEVE

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Piktor: HYSEN DEVOLLI

Tirazhi 7000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNDORI» — Tiranë, 1969

Ua kushtoj vajzave të Malësisë së
Veriut, që shqelmuar me guxim pra-
pambetje e paragjykime dhe punuan
për ndërtimin e hekurudhës Rrogozhë-
në-Fier.

KAPITULLI I PARË

Ato ditë kish bërë ftohtë, një i ftohtë plot lagështi, që të hyn në palcë dhe të bën të dridhesh.

Vuksan Ndreka e ndjente fort afrimin e dimrit fusharak; ai qe mësuar në fshatin e tij malor, ku të skuq fytyra prej thëllimit dhe gjaku të lëvrin në dej gjithë gjallëri. Atje ke qejf të fërkosh duart, të lëvizësh dhe një gaz i brendshëm jetësor të gëzon e të përtërin, ndërsa syri lbyret prej bardhësisë së borës së ngrirë, që ka mbuluar gjithshka dhe kërcet, duke u thërmuar në degët e rënduara të pishave, të aheve e të gështenjave.

Në Myzeqe nuk bën aq ftohtë, po ai mërdhin më tepër dhe i pëlqen të mbështillet më fort me gozhupin e pambuktë të aksionistit, të struket edhe më shumë nën strehën e barakës prej pupuliti, me shpresë mos e ngrohin ndopak rrezet e dobëta të diellit verdhacak. Të kish vajtur me shokët në trase, nuk do të mërdhinte aq shumë. Këmbët e mbathura me çizme të mëdha lastiku, të përthyerat poshtë gjunjëve, do t'i zhyteshin në baltën e ngjeshur, duart do t'i ngrinin kur të kapte e të lëshonte dorëzat e drunjta të karrocës, po ai do të vraponte përmes baltës, duke shtyrë karrocën, do të thërriste e do të dëgjonte thirrjet entuziazte

të shokëve dhe, sado ftohtë të bënte, gjaku do të lëvrinte dhe nga buzët do t'i dilte avull i vakët. Po i thanë të qëndronte në barakë, të ruante fjetoren dhe të shtronte tryezën e gjatë, ku do të drekonte brigada.

Ai nuk e kish për zemër këtë punë. I vinte zor të pastronte mësallën dhe të merrej me pjata, me lugë e me pirunë. Ajo ishte punë për vajza dhe në brigadën e tyre kishte prej tyre, që do ta pranonin me kënaqësi një detyrë të tillë. Vuksani kish biseduar me njërën nga ato. Ajo kish pranuar ta zëvendësonte, po kur e morën vesh të tjerët, i thirrën të dy në shtabin e brigadës dhe i qortuan rëndë. Vajza uli kokën, u skuq dhe kërkoi të falur. Vuksani u nxeh dhe u tha se nuk kish ardhur në hekurudhë për t'u bërë kamerier, po ata ngulën këmbë në vendimin e tyre dhe i thanë disa fjalë të rënda, që e bënë edhe atë të skuqej e të trembej mos e linin të shërbente në mensë për një kohë të gjatë, që të edukohej. Se ashtu i thanë: «Ti duhet të mësohesh të shtrosh tryezën dhe të mos e kesh për turp një punë të tillë, kurse kjo shoqja nuk duhet t'u bëjë bisht vështirësive».

Atë e kish shqetësuar ky mendim. Vështroi me bisht të syrit shenjat e sulmonjësit, të mbërthyera në gozhup, dhe mbështolli rrotull librin e vogël, që i kishin dhënë për të lexuar. U ngrit nga vendi, ku qe ulur, dhe lëvizi, duke përplasar këmbët që t'i ngroheshin.

Në oborrin e madh të sektorit të hekurudhës nuk kish lëvizje. Te dyert e barakave rrinin vullnetarë të veçuar si ai dhe, mbase, edhe të mërdhirë e të mërzhitur si ai.

Vetëm në kuzhinë kish hyrje e dalje të shpeshta. Mendoj një herë të vente atje e të ngrohej pranë zjarrit, po nuk i pëlqeu kjo mendje dhe u kthye përsëri në vendin e vet. U ul në fronin e gjatë dhe çeli përsëri librin e vogël, që i kishin dhënë të lexonte: ishte fjali-mi i gjashtë shkurtit, që do të diskutohej të nesërmen në mbledhjen e organizatës së rinisë. Ai duhej të fliste se ç'do të bënte kur të kthehej përsëri në fshat.

Vuksan Ndreka kish shumë dëshira dhe, si çdo tetëmbëdhjetëvjeçar, edhe ai vështronte vetëm përpara. Prapa nuk kish ç'të shihte. Asgjë nga e kaluara nuk e tërhiqte, ose, të paktën, ashtu kujtonte. Ai përmallohej për fshatin e vet. E merrte malli për njerëzit e shtëpisë, për shokët e fëmijërisë, për malet, për borën, po kur sillte ndër mend jetën e veçuar në kullën buzë një përroi të thellë, që verës mbulohej prej gjetheve e dimrit uturinte nga era, që sillte gryka e malit, i vinte keq që do të ndahej nga zhurma gazmore e sektorit të hekurudhës, nga ai gaz i vetvetishëm që sjell jeta e gjerë, puna e përbashkët, që kryhet pa interes dhe me dëshirë. Më parë nuk qe larguar ndonjëherë nga fshati dhe me shokët, që rronin edhe ata të veçuar nëpër kulla, takohej vetëm në mbledhjet e organizatës së rinisë dhe ditëve të stërvitjes paraushtarake. Ditët e tjera punonte në arën afër kullës, që, çdo vit, kur lërohej, nxirrte gurë, vente në pyll për dru e për dushk, mbledhte gështenja.

Kjo kish qenë jeta e tij, po nuk mund të ishte kjo. Edhe ajo duhej të ndërronte dhe do të

ndërronte. Kullës së lashtë, që ishte ngritur tri herë mbi rrënojat e veta me kryeneçësi, do t'i çelëshin dritare të mëdha, do t'i shtoheshin të ndarat dhe dhomave do t'u hidhej tavan, do t'u bëheshin dyer të reja... Shumë gjëra duhej të ndryshonin. Kur mendonte për to, ai nuk u vinte fre mendimeve të veta; stepej vetëm kur kujtonte të atin, kur mendonte se ishte djali më i vogël dhe fjala e tij nuk peshonte shumë në kuvendet familjare. Ai kish nevojë për përkrahje.

Vështroi edhe një herë librin e vogël, që ishte vjetëruar, duke kaluar dorë më dorë dhe që mbushur me shënime e me emra vullnetarësh, nxori nga xhepi i pantallonave një laps të përgjysmuar e të ciflosur dhe, pasi ndenji disa sekonda pa lëvizur, shënoi me gërma të mëdha në kapakun e librit: *do të bëhem komunist*. Mendoi pastaj se ç'mund të shtonte më, po iu duk se çdo fjalë tjetër do të ishte e tepërt, ndaj e futi lapsin përsëri në xhep, u mbështet mirë në pupulit dhe i ktheu fytyrën diellit.

Me sy të mbyllur, mundohej të përfytyronte jetën e tij të ardhshme atje në malësinë e veriut dhe, sadoqë përpiquej të mendonte gjëra të zakon-ta, filli i mendimeve gjithnjë i merrte një drejtim tepër fantastik. Për çudi, kurrë nuk e shkë-puste dot veten nga fshati i lindjes, edhe kur kujtonte vetëm të këqiat e tij.

E përmendi nga kjo kuturisje një tingull çiftelie. Nga altoparlanti u përhapën në gjithë oborrin e madh e të zbrazët të sektorit tingujt e çiftelisë dhe fjalët e vargëzuara të një kënge të panjohur.

Ai vuri veshin të dëgjonte më mirë.

Kënga ishte e re. Vuksani nuk e kish dëgjuar ndonjëherë më parë.

Këngëtari nuk ishte i keq: një malësor me zë të hollë pakëz të çjerrë, po vjershën e kish sajuar bukur. Atij i erdhi inat që nuk i pat shkuar ndër mend ta nxirrte vetë i pari një këngë të atillë.

Po kënga mbeti përgjysmë dhe tingujt e dashur të çiftelisë i mposhti, më në fund, zëri i spikerit.

Vuksanit i erdhi keq. Pati dëshirë ta mësonte edhe ai atë këngë. Sa për spikerin, as që deshi të pyeste. Edhe po të mos i dëgjonte ato që thoshte ai, po të qenë me rëndësi, do t'i lexonte të nesërmen në gazetë, ose do t'i merrte vesh në informacionin e përditshëm politik. Po e turbulloi emri i fshatit.

Ai u ngrit vetvetiu dhe iu afrua altoparllimit. Zemra i rrihte me nxitim. U shqetësua dhe priste me padurim vazhdimin e radio-reportazhit, siç pret njeriu kur dëgjon t'i zihet në gojë emri për një faj, që edhe ai vetë e ka harruar.

Emri i fshatit i kujtoi të fejuarën, një vajzë që ai nuk e njihte, po me të cilën do të martohej, pasi të kish kryer shërbimin ushtarak. Kështu kishin vendosur prindërit. Edhe njerëzit e nuses të këtij mendimi ishin. Vuksani nuk kish kundërshtuar. Ai nuk ndjente asgjë, veç kureshtjes që ka njeriu kur i afrohet diçkaje të sigurt, të natyrshme e të panjohur. Ajo i përkiste atij dhe ai, që kur kish njohur veten, ishte mësuar të mos mendonte ndryshe.

— I afrohemi një vajze, — tha spikeri dhe Vuksani u drodh. — Ajo rri pak e veçuar dhe bisedon nën zë me një shoqen e vet.

— Si quheni?

— Marta Prendi.

— Marta Prendi! — belbëzoi Vuksani dhe mbështeti gjithë trupin në shtyllën, që ndodhej aty pranë. Kohët e fundit qenë bërë gjë e zakonshme prishja e fejesave të lidhura në mituri. Mos edhe ajo..

— Emër të bukur paske! E gëzofsh!

— Ju falemnderit..

— Po, ajo është — tha me vete Vuksani. — Marta Prendi, e fejuara ime... Paska zë të ëmbël — dhe u mundua të përfytyronte fytyrën dhe trupin e vajzës, po spikeri i ngacmoi nervat me pyetjet e veta.

— Më thanë se ke qenë fejuar.

— Si urdhëron! Baba ka një mik mirditor. Kur linda unë, ai mori udhë të gjatë dhe erdhi tek ne për urim. Pastaj, në një dasmë, duke pirë raki e duke u rënë telave të çiftelisë, ata u bënë edhe krushq. Baba më fejoi me djalin e mikut të vet, kur isha foshnjë dhe sapo kisha mësuar emrin tim.

Ashtu kish ndodhur vërtet. Ajo nuk gënjente. Edhe Vuksani e dinte këtë gjë. E kish marrë vesh nga i ati. Ai i kish folur mirë për familjen e Martës dhe i kish treguar se miqësinë ndërmyjet tyre e kishin nisur gjyshërit, në kohën e kushtimeve të malësisë kundër turqve. Atëherë, të dy gjyshërit qenë miqësuar dhe kishin këmbyer hutat. Huta që Vuksani sapo kish



çelur sytë kish parë varur në murin e kullës, ishte arma e gjyshit të Marta Prendit. Edhe në shtëpi të saj duhej të ishte varur në mur një hutë e atillë.

— Unë nuk e njoh të fejuarin, — vazhdoi të flasë e qetë, e menduar, po edhe me një farë gëzimi, Marta Prendi.

Vuksanit iu vështirësua frymëmarrja dhe iu ndez gjaku.

— Nuk e kam parë ndonjëherë dhe as kam për ta parë. Për të më ka folur vetëm nëna, po edhe ajo sipas fjalëve të babës. Ai mund të jetë djalë i mirë. Unë as dua ta shaj, as dua ta mallëkoj. Ai nuk ka faj. Edhe atë e fejuan të mitur. As ai kurrë nuk më ka parë. Po si mund të vemi symbyllur te njëri-tjetri? Si mund të kalojmë një jetë të tërë së bashku pa u njohur? Edhe për mua, edhe për atë do të ishte e vështirë. Tani kohët kanë ndërruar. Në fshatin tonë sapo u ngrit kooperativa. Ne vendosëm në organizatën e rinisë t'i prishim të gjitha fejesat e bëra nga prindërit ndërmjet fëmijëve të mitur. Edhe unë e kam prishur fejesën...

— Po ai?

— Ai? Si të them... Edhe ai është i ri dhe duhet ta kuptojë, se jeta nuk mund të rrjedhë më në hullitë e vjetra. Unë e pata më të vështirë nga ai dhe e hodha këtë hap me guxim. Edhe baba u bind. Ai është djalë dhe djemtë e kanë më të lehtë...

— Pse?

— Vetëm se janë djem.

— Të lumtë, Marta Prendi, — thirri me gë-

zim të papërmbajtur spikeri i Radio Tiranës, —
të uroj suksese dhe lumtëri!

Vuksan Ndreka shtrëngoi dhëmbët dhe ndjeu një urrejtje të madhe për atë njeri të panjohur. Edhe ajo paskish qenë vajzë e paturpshme. Mund ta kish prishur fejesën, — kjo s'kish shumë rëndësi as për vetë Vuksanin, — po ç'ishte nevoja të fliste në mbledhje e në radio?

— Kush e di ç'flitet tani në fshat — mendoi ai dhe u turbullua edhe më tepër. Ajo nuk e kish përfillur. Edhe fjalët e mira që kish thënë për të dhe që atij i ngjajtën si një ngushullim, e kishin goditur keqas. E dinte ai ç'do të thoshte fshati. Në malësi ishte turpi më i madh po të të përgojonte një grua, aq më tepër ajo që ishte jotja, që ti e kishe aq të sigurt dhe e kujtoje aq të përkulur, sa që për të të dukej e tepërt edhe të mendoje.

Diçka e ngjajshme kish ndodhur edhe me vëllanë e madh të Vuksan Ndrekës. Ai la nusen, që i kish zënë baba dhe mori një tjetër. Baba u zemërua. Pas tij u ngrit prifti i fshatit, se nusja e re nuk ishte katolike. U hakërryen krushqit, u egërsuan të gjithë pleqtë dhe djali u detyrua të mos e sillte nusen në shtëpi, po hyri ai vetë në shtëpi të saj, gjersa i dhanë një të ndarë në banesat e minatorëve.

Vuksani hynte e dilte tek i vëllai. Në fillim edhe atij nuk i kish pëlqyer kokëfortësia e tij, jo se u jepte rëndësi zakoneve e paragjykimeve, po se nusja ishte banakiere në mensën e minatorëve. Kur e njohu nga afër, ndërroi mendje. Tani i pëlqente edhe të folurit e saj, që i qe dukur për të

qeshur, se ajo mudohej të thyente toskërishten e t'i afrohej dialektit të vendit.

Në fshat flitej akoma për besën e thyer dhe për zakonet e shkelur. Po ai kish ikur dhe nuk pyeste më për fjalët e botës, kurse Vuksani, dy muaj më vonë, do të kthehej në fshat.

Kur qe folur për herë të parë për prishjen e fejesave, edhe në shtëpinë e tyre qe hapur kjo bisedë. Vetë Vuksani kish kërkuar ta prishnin krushqinë. Ai tani për tani nuk kish ndër mend të martohej. Kur të vinte koha, do ta gjente një vajzë.

Babait nuk i kishin pëlqyer këto arësytetime. Edhe vëllai i dytë i Vuksanit kishte mbajtur anën e plakut dhe çështja kish mbetur pezull. Vetëm e motra e kish përkrahur, po fjalën e saj askush nuk e kish përfillur.

Kaluan disa javë dhe Vuksani ishte qetësuar. I ati i Marta Prendit kishte vajtur vetë në fshat dhe i kish siguruar se do ta mbante fjalën e dhënë, po kish kërkuar që, hëpërhë, sa të kalonte vala e parë e stuhisë që kish shpërthyer, as ai as ata të mos i zinin në gojë fejesën dhe kushtet e krushqisë së lidhur.

Kur ja thanë Vuksanit këto, atij i erdhi turp nga vetja. Gjithshka iu duk poshtëronjëse dhe prapë u përpoq t'i mbushte mendjen t'et, që të hiqte dorë nga këto marrëveshje. Plaku përsëri i qe kanosur dhe ai qe tërhequr i dëshpëruar dhe kish nisur të mendonte për herë të parë se sa e ulnin njeriun — jo vetëm vajzën, po edhe djalin, — zakonet dhe marrëveshjet e martesave.

Nuk i pëlqente të nënshtrohej, po edhe të ndahej nga shtëpia nuk kish dëshirë.

Tani duhej të duronte fyerje dhe poshtërime. Në fshat të gjithë do të qeshnin me të. Ai e parandjente këtë dhe i vinte të hante veten me dhëmbë, që nuk ishte treguar më i vendosur, më këmbëngulës dhe më krenar. Po ta kish prishur fejesën, ndryshe do të kishin qenë punët. Do të qëndronte ballëhapët para botës. Edhe grindjet në shtëpi do të vinte koha që të fashiteshin, kurse ajo...

E përmendën tingujt e çiftelisë që shpërthyen dhe zëri pakëz i çjerrë i malësorit.

Vuksani nuk deshi të dëgjonte më. U kthye përsëri në vendin e vet, u ul në fron dhe, siç e kanë për natyrë malësorët, u ngrys, u mbyll në botën e tij të vogël e të trazuar dhe fliste me vete, pa zë.

Libri i rëndonte në dorë si një peshë e madhe, që mezi e mbante. Fjalët e tij tani merrnin një kuptim më të qartë dhe më konkret. Ai tani shihte se si përzihej e vërteta e madhe edhe me fatin e tij, si ndeshej ajo me mendimet dhe me shqetësimin e tij, me sedrën e prekur dhe me frikën se mos të tjerët talleshin me të. Lufta nuk zhvillohej më vetëm rreth e qark tij. Ajo kish hyrë tek ai vetë dhe e kish tronditur. Kurrë nuk kish pandehur se do të ndeshej në këtë mënyrë me vetëveten dhe me të tjerët. Ai gjithnjë kish menduar se do të qëndronte në ballë, se që i bindur për ato pak të vërteta që njihte dhe që e sundonin në mënyrë të pushtetshme.

Edhe tani ai ndodhej nën pushtetin e atyre të vërtetave. Po seç kishte në thelësi të ndjenjave e të mendimeve që nuk e linte të qetë, që e turbullonte, e revoltonte dhe e vriste. Kjo fuqi, e fshehur në mentalitetin dhe në karakterin e tij, e shtynte për një kundërveprim të paarsyeshëm, në një dëshirë për të vënë në vend nderin e cënuar dhe për të kënaqur sedrën e prekur. Ai e kundërshtonte këtë ndjenjë të keqe mundonjëse, po ajo nuk fashitej, vepronte edhe kundër vullnetit të tij, tallej me të, i errësonte mendimet dhe i nxinte fytyrën. Kjo ishte një ngërdheshje tallëse, që merrte gjuhën dhe fytyrën e pleqve të fshatit, bile, edhe të moshatarëve të tij. Vuksani vetëm kaq shihte, vetëm kaq kuptonte. Ai nuk ishte në gjendje, në ato çaste, të zbulonte, se ajo ishte e njëjta ngërdheshje, që i kish mbajtur një-rëzit të përulur para zakoneve dhe që kish vrarë krenarinë e tyre, siç kish vrarë edhe krenarinë e tij dhe kish marrë nëpër këmbë fatin e tij e të Marta Prendit. Zakonet e vjetra kjo ngërdheshje i mbante më këmbë, siç mbajnë patericat një të gjymtuar. Ai e humbiste fillin e arësyes, kur përfytyronte talljet e fshatarëve dhe vetvetiu shtrëngonte dhëmbët e grushtet edhe kundër tyre, edhe kundër Marta Prendit, pa ditur ç'të bënte tjetër për t'u mbrojtur prej fyerjeve. Ai ishte vetëm dhe nuk donte të kishte shok në këtë fatkeqësi.

Gjëja më e rëndë i dukej që t'i hapte zemrën dikujt, se pandehte që gjithkush do të qeshte me të. Sedra nuk e linte të shikonte se nuk qe vetëm

ai që do të luftonte, po ishte një botë e tërë e re dhe e fuqishme, para së cilës nuk kishin vlerë e forcë ngërdheshjet e botës së vjetër. Prandaj, në këtë kapërthim mendimesh e ndjenjash të turbullta, duke shfajësuar veten, ai fajësonte edhe Marta Prendin, e cila, sipas tij, mund të kish vepruar më ndryshe dhe të mos e kish cenuar aq rëndë faqe botës. Kish vajza të tjera në malësi, që ishin martuar me burra të motuar, siç kishte edhe fëmijë që kishin marrë për gra vajza të rritura. Nusët e pleqve ishin shërbëtore. Nusët e të miturve qenë dado. Ai që tallur me këto martesë, kish folur kundër tyre në mbledhjet e organizatës së rinisë dhe prapë kujtonte se kish diçka të bukur në përuljen dhe vetëmohimin e vajzave, që u takonte një short i tillë. Ato qenë martire dhe, në vetësakrifikimin e tyre, pa kuptuar egoizmin e egër të burrave e të prindërve. Vuksan Ndreka shihte edhe një farë lumtërie, sado e dhimshme që të ishte. Kjo ishte logjika e priftit. Ajo kish depërtuar edhe tek ai vetvetiu, pa u ndjerë dhe në mënyrë aq të ngadalshme, sa që bërë e tija dhe ai nuk e vinte në dyshim dhe nuk e quante të huaj.

E tillë kish qenë jeta e grave në malësi, kurse ajo, Marta Prendi, që ngritur në mbledhje të fshatit dhe kish folur edhe në radio, sikur ai të kish qenë i lënë dhe i humbur.

Vuksani nuk ishte i atillë. Ai vështroi shenjatat e sulmonjësit, që kish mbërthyer në gozhup dhe prapë i hypi gjaku në kokë. Qenë shumë të forta sfondi i kuq dhe ngjyra e verdhë e këtyre shenjave! Ai nuk mund t'i shihte gjatë. I vinte rëndë; i vinte turp t'i shihte, ashtu siç i vinte

zor të kujtonte porosinë që «...gjithë partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë, të djegin me zjarr e t'i këputin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave». Edhe Marta Prendi prej këtyre fjalëve kishte marrë zemër dhe qe ngritur për të mbrojtur të drejtën e vet para gjithë botës. Kurse Vuksani ishte mësuar ta quante të tijën dhe të mendonte për të si për një send që i përkiste atij, si për një dhuratë që ja kishin premtuar dhe duhej t'ja sillnin patjetër. Në trurin e tij ende lëvrinte mendimi që gruaja i përket burrit. Ky duhej ta thoshte fjalën e pari, të pranonte e të kundërshtonte, të pëlqente e të shpëlqente. Kurse ajo...

— Vuksan! — thirri dikush që brenda barakës.

Djaloshi u hodh përpjetë dhe iu kujtua shoku i sëmurë, që rrinte shtrirë në krevatin prej dërrase. Ai e kish harruar fare të sëmurin dhe zëri i tij, në fillim, e trembi, pastaj e shqetësoi. Ai mund ta kish dëgjuar radion dhe do ta hapte fjalën në gjithë shokët e brigadës. Dhe, po të ndodhte kështu, atij i mbetej vetëm një rrugë: të ikte nga brigada e të vente diku, në një vend, ku të mos e njihte njeri, ku askush të mos e dinte të fshehtën e tij.

Iu afrua shokut dhe e pyeti me gjysmë zëri.

— Më thirre?

— Po, bre. Pashë një ëndërr të keqe dhe u tremba...

— Pse, po flije? — pyeti Vuksani i qetësuar

dhe vështroi me vëmendje e me një fije gëzimi fytyrën e buhavitur të shokut.

— Po, pra, se ëndrra me sy hapur nuk shihen, — qeshi tjetri me zor. — Pashë sikur isha në fshat dhe u takova me vetëveten.

— Me vetëveten?

— Kisha shkuar në pyll për dru dhe takohem atje me dikë. Herë isha unë ai e herë jo. Përpiqesha të largohesha e s'mundja. Mendohesha të kuptoja cili nga të dy isha unë dhe nuk arrija dot...

Vuksani i vuri dorën në ballë.

— Ti ke temperaturë — i tha. — Po vete të thërras mjekun!

Dhe, duke dalë, mendoj:

— Duhet të ketë qenë në kllapi, ndryshe s'kish si të shihte një ëndërr aq të çuditshme.

KAPITULLI I DYTË

Traseja kalonte përmes një vargu kodrash të buta. Vullnetarët shpesh punonin brenda një kanali të thellë, të gjerë e të gjatë, që mbaronte në fund të një kodrine dhe niste përsëri atje ku fillonte të merrte lartësi kodrina tjetër. Dheu ishte i butë. Vetëm në disa vende dilte ndonjë shtresë zhavorri, që ishte ngjeshur e lidhur gjatë shekujve, po edhe ai thërmohej me kazmë, pa shumë vështirësi.

Vuksan Ndreka punonte me karrocë dore. Kudo që kishte mbartje dheu ai merrte karrocën. I pëlqente të lëvizte me shpejtësi dhe, pas çdo rruge, të drejtonte shpinën gjersa vajzat ta mbushnin karrocën me dhe. Kur nuk kishte durim, e mbushte edhe vetë, duke ua marrë lopatën nga duart. Po asaj dite nuk ishte në formë dhe e shtynte karrocën me të gjithë peshën e trupit, duke shkelur rëndë në llucën, që ishte formuar nga shirat e ditëve të fundit. E kishin caktuar të punonte me një vullnetare nga krahina e Matit, që rrinte gjithnjë e veçuar dhe e ndrojtur. Ai nuk desh të punonte me të, po nuk kish mundur të kundërshtonte. E dinte që të gjithë do të ngriheshin kundër tij dhe mund të shpërthente papi-

tur diskutimi edhe për fejesën e prishur, që ai, deri asaj dite, nuk ja kish zënë në gojë askujt.

Ditën e parë dhe të dytën ai kish pasur frikë nga radiua dhe nga gazetata. Mbrëmjen e parë kish hyrë bashkë me djemtë e me vajzat e brigadës në sallën e madhe të konferencave dhe kish ndjekur tinëz emisionet e Radio-Tiranës, që transmetohehin me anë të altoparlantit, duke pritur mos përsëritej radiatorreportazhi i mëngjezit. Një mendje i thosh të largohej nga salla, që të mos ndodhej atje, kur të tjerët të dëgjonin emrin dhe fjalët e Marta Prendit, kurse një mendje tjetër i thosh të qëndronte. Mbase ishte më mirë ta shihte të keqen drejt në sy dhe me praninë e tij t'u priste udhën shpirtive. Ai e dinte që malësorët kurdoherë janë tallur — dhe janë tallur keqas — me ata që janë fyer dhe e kanë duruar fyerjen. Kish dëgjuar qindra histori vrasjesh e rrahjesh për një fjalë të shkelur e për një të qeshur. Ato histori kishin ushqyer pa u ndier edhe krenarinë dhe sedrën e tij, që tani ndesheshin me një tjetër realitet e me të tjera mendime jo fare pa fuqi. Malet as ai vetë nuk i kuptonte dot pa ato histori dhe pa ato zakone të lashta, që kishin kaluar nga gjaku në gjak, nga brezi në brez, nga një kohë në tjetrën, gjersa kishin arritur në ditët tona që të përplaseshin me mendimet e njerëzve të rinj, duke ngjitur shpesh edhe dallgë të turbullta në shpirtin e tyre.

Ai nuk kish arësye t'i shmangej Drande Pilsës dhe kish qenë nga ata, që ishte munduar ta afronte më tepër dhe t'i lehtësonte vetëminë. Se vajzat e brigadës, të gjitha mirditore, në fillim e vështronin me dyshim, si një të huaj, që

kish hyrë pa pyetur dhe papritur në shoqërinë e tyre. Kur dilnin shetitje, ato kapeshin dorë për dore me njëra-tjetrën. Drandja vente me to dhe s'dinte ç'të bënte me duart e veta. Edhe në trase ajo punonte e heshtur dhe kokulur gjersa lodhej. Në komunikatat e shtabit emri i saj u përmend që në ditët e para.

Atëhere Vuksani nuk e dinte historinë e saj, nuk e kish kuptuar pse rrinte e veçuar dhe e trishtuar Drandja dhe pse e kishin sjellë në brigadën e tyre. Këtë e kish marrë vesh një ditë më parë, kur u bë mbledhja e brigadës. Komandatja e sektorit, një vajzë topolake, me flokë të prerë si çun, e veshur si gjithë të tjerat me pantallona doku ngjyrë kremi dhe me gozhup kaki, u kish thënë se do të fliste Drande Pilsa.

— Drandja? — pëshpëritën të habitur vullnetarët dhe kthyen kokën ta shihnin ku ndodhej.

Drandja që ulur në fronin pranë derës dhe kish futur duart ndërmjet gjunjëve. Megjithëse ishte përgatitur me kohë për këtë takim, kur dëgjoi emrin e vet, u drodh. Fytyra iu skuq dhe gjithë trupin ja përshkuan mornica të forta. Ajo vështroi ankueshëm komandanten e sektorit, që i buzëqeshte dhe e shikonte me dashamirësi, po nuk i bënin këmbët të ngrihej.

— Hajde, Drande! — i thirri komandantja e sektorit dhe largoi karrigën, që të ulej.

Vajza u ngrit, iu afrua ngadalë tryezës së mbuluar me beze të kuqe dhe qëndroi para brigadës kryeulur. Fërkonte duart dhe vështronte çizmet e përbaltura që edhe ajo, si gjithë aksionistët, i kish përthyer poshtë gjunjëve.

— Unë, shokë dhe shoqe, — nisi të tregojë ajo me zë të ulët e të dredhur, — kam qenë e fejuar. Më patën fejuar prindërit qysh në djep, ashtu siç janë fejuar shumë e shumë vajza malësorësh. Të fejuarin tim nuk e kam parë ndonjëherë. As sot e kësaj dite nuk e kam parë. Dëgjoja gjithfarë fjalësh për të. Në shtëpi më thoshin se ishte pika e djalit, kurse shoqet, — edhe ato, siç kishin dëgjuar, — më gërgisnin e më thoshin se do të merrja alamet burri, që kish ardhur në fshatin tonë të zgjidhte nuse për dikë tjetër dhe kish gjetur nuse për vete. Ai ishte shkes e në shkesi po i kalonte jeta.

Kur doli fjalimi i shokut Enver, shumëkush u ngrit kundër të fejuarit tim. Edhe në fshatin tonë folën keq për të. M'u copëtua zemra dhe kisha turp të dilja para shoqeve. Baba më kanosej. Nëna mundohej të më ngushullonte. Vëllai i madh, të cilin e kish lënë e fejuara, ankimeve të mia u përgjigjej me të shara. Dhe nuk e di se qysh, — u nxitua baba apo dhëndri, — po më thanë se duhej të përgatitesha për dasmë...

Vuksani dëgjonte me vëmendje, sikur do të zbulonte në rrëfimin e saj edhe diçka nga ajo që i kish ndodhur atij vetë. Aty për aty, Drandja, që gjer aty përpara e pat afruar, iu duk e huaj, e largët. Ndërmjet tyre vërshoi një rrymë e ftohtë, e menjëhershme, e paarësyeshme, që as ai vetë nuk e shpjegonte dot, sado që mundohej të zbulonte lidhjen e fshehtë e të çuditshme ndërmjet fatit të saj dhe qëndrimit të Marta Prendit.

Drandja, edhe kur fliste, dukej e urtë, e turpshme dhe kokulur. Gozhupi i rrinte i gjerë,

i fshihte gjithë format e trupit dhe e tregonte më të shkurtër. Flokët i kish të drejtë e të ngjitur pas kokës; fytyrën e kish të madhe e gati të sheshtë, buzët të holla e të drejta, sytë të përhimtë. Duke folur, ajo kish marrë zemër dhe, herë-herë, ngrinte kokën të vështronte shoqet e brigadës, po kur shqiptoi fjalët e fundit, nuk pati guxim të vështronte njeri. Gërvishti me gishta bezen e kuqe të tryezës dhe pastaj, me të prapmen e dorës, fshiu lotët. Zëri iu ngashërye.

Vuksani e mposhti me zor keqardhjen.

— Dhe ndodhi që ato ditë, më herët nga ç'kishin kujtuar baba me dhëndrrin, u mblodh organizata e Frontit. Ne, vajzave të fejuara nga prindërit, na thirrën të gjitha dhe na porositën të flisnim. Unë iu luta edhe një herë nënës. Do të ishte mirë që baba ta prishte vetë këtë fejesë, po nuk më dëgjuan. Atëhere u detyrova të ngrihem në mblëdhje të fshatit dhe të flas. Baba nuk më kundërshtoi. Kur u kthyem në shtëpi, më mbylli në burgun e bagëtisë dhe më rrahu. Ndjeva goditje shpullash në fytyrë, shqelma... Pastaj më shpërtheu gjak nga goja dhe më ra në kokë një goditje vdekësore. Dëgjova vetëm këto fjalë:

— Nga dera ime do të dalësh o me duvakun e nusërisë, o me qefin!...

Dhe humba. Kur u përmenda, më sillej përpara si në ëndërr fytyra e egërsuar dhe sytë e frikshëm të babës. Trupi më dhimbte. Kokën nuk e lëvizja dot. Ndenja shtrirë gati një javë. Nëna më sillte ushqimin, kurse vëllai i vogël, kur dilte nga shkolla, vinte pranë meje, kryente detyrat dhe përgatiste mësimet për të nesërmen. Unë

PROFTE K.Q.I.P.P.



vajtoja fatin tim. Aty-aty më rrëmbente zemërimi dhe vendosja të ankohesha kundër tim eti. Më vinte edhe turp, edhe keq. Unë isha bija e tij dhe askush nuk do të më nderonte, po të pësonte gjë ai për shkakun tim. Pastaj, ndonëse më rrahu keq, unë isha e gëzuar: fejesa ishte prishur dhe tani askush nuk më fliste për martesë e për dasmë.

Dola e gënjer. Një ditë, pasi e pata marrë veten, më thanë të përgatitesha. Nëna më puthi në ballë e më pëshpëriti:

— Nusja e nënës! Mos ja kthe fjalën babës, se do të marrësh në qafë veten dhe gjithë shtëpinë... Është marri të vdesësh kaq e re dhe mëkat të vuajmë të gjithë. Shtroju fatit!...

— Ka vendosur të më vrasë?

Nëna tundi kokën dhe u largua. Mua m'u duk se nuk ishte prej mishi e kocke, po prej ere, prej mjergulle...

T'ju them të drejtën, nuk m'u dhimb vetja, sa m'u dhimb nëna, vëllezërit dhe... po, edhe baba. E mendova të lidhur me pranga dhe u rrënqetha.

Sytë iu përlotën përsëri, zëri iu mbyt.

Vuksani uli kokën dhe nuk e përmbajti dot psherëtimën.

Komandantja e sektorit, që sapo fshiu sytë, i afroi Drandes gotën e ujit dhe e pyeti:

— Pushojmë pak?

— Jo, pra, jo. Do ta çoj gjer në fund këtë histori të dhimbjeve të mia, — dhe, si lagu buzët e thara me një gllënjë ujë, vazhdoi:

— Mbeta vetëm. Kujt t'i qahesha? Kujt t'i kërkoja ndihmë? Dhe m'u kujtua vetëm diçka: partia. E ndjeja që partia ishte me mua, në gjakun tim, në zemrën time, në mendjen time. Ajo më mësoi të ngrihesha kundër përdhunimit, po ajo nuk e dinte se unë vuaja...

Do të trokas në derën e sekretarit të organizatës, — thashë me vete dhe u vodha nga shtëpia. Sekretari ishte një kushëriri ynë.

Ai nuk më priti mirë. Nuk më priti fare. «Nuk mundem të ndërhyj në çështje të tilla» më tha, duke qëndruar te dera e konakut. E pashë se, po të hidhja një hap para, trupi i tij do të zinte derën. Këtë turp nuk desha ta duroja, ndaj u ktheva prapsht...

Tani isha edhe e lirë, edhe pa strehë, edhe pa njeri. Në kokë më vërtitej vetëm një fjalë: partia. Kisha dëgjuar të flitej shumë për partinë, po se bëhej vërtetë kaq e afërt, kaq e dashur dhe kaq shpresëdhënëse për njerinë, vetëm në këto çaste e provova. Dhe mora zemër.

Udhëtova gjithë ditën. Në qytet arrita kur qenë ndezur dritat elektrike dhe rrugët qenë zbrazur. As në komitetin e partisë, as në komitetin ekzekutiv nuk gjeta njeri. Më erdhi keq. Po kisha besim se do ta gjeja partinë; ajo ishte kudo. Mund të trokitja në çdo derë dhe isha e sigurt, se edhe po të mos gjeja një komunist, do të ishte vështirë të mos gjeja një njeri të partisë. Të gjithë ne jemi të partisë.

Një polic më kujtoi degën e punëve të brendshme. U drodha. Pata frikë mos rrëfimi im i sillte dëm babës. Po, jo!

Iu afrova portës mëdyshas. Qëndrova disa herë. Dhe, mbase do të isha kthyer, sikur një rrugaç, nga ata që nuk qethin flokët dhe kalojnë udhëve si të hutuar, të mos më kish vërshëlyer me paturpësi.

Oficeri i rojes lajmëroi shefin e degës. Ai erdhi vetë, më mori në zyrë dhe më pyeti. Unë qava; pastaj i rrëfeva gjithë ç'më kish ndodhur. Ai më dëgjoi heshtazi. Në fund më tha:

— Mos u mërzit. Sonte do të flesh në hotel. Atje edhe do të hash. Nesër do të bisedojmë përsëri, — dhe pa më thënë fjalë tjetër, më përcolli gjer në bujtinë dhe më dha dorën.

Unë e vështrova drejt në sy. Ai më buzëqeshi. Kur pashë fytyrën e tij të qeshur e dashamirëse, mora zemër.

— Mos i bëni gjë babës... Ai nuk ka faj... Fajin e kanë kohët e shkuara, zakonet...

Kështu, pra, shokë e shoqe. Që atëhere kanë kaluar dy muaj. Unë nuk jam kthyer në shtëpi. Po, ani! Do të pres gjersa të bindet baba, pa merak, se shtëpia jonë e madhe është Shqipëria. I kam shkruar dy letra vëllait; po nuk më ka kthyer përgjegje. Në shtëpi, me siguri, ende vazhdon gjyqi.

Ajo heshti dhe vështroi komandanten e sektorit.

Vullnetarët, edhe pasi mbaroi rrëfimi, nuk luajtën nga vendi. Vuksani që tronditur më tepër nga të gjithë dhe, duke mos ja shqitur vështrimin fytyrës, mundahej të zbulonte se ku e kish gjetur gjithë atë forcë ajo vajzë e turpshme, e heshtur dhe e urtë. I vinte turp nga vetja. Atij nuk i kish

ndodhur asgjë përpara asaj që i kish ngjarë Drandes dhe, ndërsa vajza që rropatur të gjente partinë e të mbështetej tek ajo, ai, megjithëse donte të bëhej komunist, u shmangej shokëve dhe ua fshihte të keqen që e mundonte dhe i rëndonte në zemër. Mos do të kish qenë i kënaqur që edhe Marta! Prendi të kish pasur të njëjtin fat?

Ky mendim i papritur e përmendi. Ai nuk ishte aq i lig, po e kuptoi se prapa mendimeve dhe sedrës së tij të lënduar, një ligësi e tillë fshihej. Atij i vinte keq për Drande Pilsën, po rrëfimi i saj edhe e ftohu, e largoi dhe e bëri më të përmbajtur ndaj saj. Ai mendohej të përligjte veten, po shkaku i vërtetë i këtij largimi ishte ngjasimi ndërmjet sjelljes së saj dhe qëndrimit të Marta Prendit, ndaj tij. Pastaj edhe nuk i pëlqente që vajza të ngrihej në mbledhje dhe të fliste aq hapur për ngatërresat që kish pasur me prindërit dhe me të fejuarin. Ky ishte turp, ishte diçka që as ishte parë, as ishte dëgjuar më parë. Ai ishte djalë dhe i vinte zor t'u tregonte, qoftë edhe shokëve më të ngushtë, të fshehtë që e mundonte dhe që ai e ruante, siç ruajnë njerëzit plagët e trupit nga të goditurat.

Me mendime të tilla në kokë ai shtynte karrocën e dorës, duke shkelur rëndë në baltën e trasesë. Kur ngarkonte Drandia karrocën, ai futte duart në xhepet e gozhupit dhe vështronte fushën e gjerë dhe hapësirën e ngarkuar me lagështi. Nuk i fliste dhe nuk donte t'i rrëmbente lopatën nga duart, siç bënte ditët e tjera.

Vajza e pikasi menjëherë ndryshimin e Vuk-

sanit. Pas mbledhjes, një ndryshim të tillë e vuri re edhe në disa të tjerë. Ata, edhe kur nuk i largoheshin, me t'u afruar ajo, heshtnin dhe rrinin të menduar, të ndrojtur, të ftohtë. Sytë e tyre shprehnin keqardhje, po ajo nuk i shihte ata sy. Ky ndryshim ja përtëriti brengën, veç nuk e ligështoi. Ajo punonte pa pushim; donte të lodnej e të mos kishte mundësi të mendonte për keq, të mos u çelte shteg dobësive. Rruga e saj ishte e përcaktuar dhe cilatdo që të ishin vështirësitë, ajo duhej të ecte e vendosur, pa u lëkundur në atë rrugë.

Padashur ajo hodhi një lopatë me dhe në këmbët e Vuksanit. Ai e vështroi i vrënjtur dhe përplasi këmbët në tokë, që të shkundte çizmet.

— Më fal — i tha ajo me zë të ndrojtur.

— Puno më me kujdes — ja ktheu ai dhe nuk vështroi atë, po karrocën, që nuk ishte ngarkuar akoma.

— Si shumë i ngrysur po më dukesh sot — foli përsëri ajo dhe mbështeti duart në bishtin e lopatës.

Vuksani e pa. Vështrimi i tij ndeshi në sytë e trishtuar e të përmallshëm të Drandes, në të vilët vezulloi një shkëndijë jetëshkurtër përzemërsie. Ai u hutua për një çast prej asaj shkëndije dhe vetëm në ato pak sekonda e pa vërtet fytyrën e Drandes, në të cilën zbuloi shumë gjëra të papara ndonjëherë. Ajo nuk ishte vetëm një vajzë fatkeqe, e braktisur, kokulur; ajo ishte një njeri, ishte një zemër që rrihte, që kishte edhe ajo hovet dhe anët e veta të fshehta, ku nuk mund të depërtoje aq lehtë,

sa ç'kishte kujtuar Vuksani. Edhe fjalët e saj, edhe vështrimi i ndrojtur e i përzemërt, bënë që ai të ndihej i vogël e i pafuqishëm para saj. E pushtoi një valë kotësie dhe turpi për gjithë ç'kish menduar më parë, po nuk e shfaqti para vajzës këtë dobësi.

— Kohë e keqe! — i tha dhe u kollit që të mos psherëtinte.

— Dje unë fola me zemër të hapur, — vazhdoi Drandja me zë të ulët e monoton; — fola siç nuk flet as motra para vëllezërve... Mos...

— Ç'do të thuash? — u nxitua të pyesë Vuksani, që nuk e priste këtë ndërhyrje aq intime të vajzës dhe nuk e kuptonte akoma cili mund të ishte qëllimi i saj.

— Mos ke filluar të mendosh keq për mua?

— E pse të mendoj keq? — iu përgjigj ai me mospërfillje të shtirur, që të fshihte turbullimin. — Ti veprove ashtu siç deshe dhe unë s'kam pse të mendoj as mirë, as keq. Nuk jam mësuar të përziem në punët e të tjerëve.

Dhe, që t'i jepte fund kësaj bisede, i rrëmbeu lopatën dhe nisi ta ngarkojë vetë karrorën.

Drandja vështronte si ngulej lopata në grumbullin e baltës së ngjeshur dhe ndiqte lëvizjet e shpejta dhe energjike të duarve e të trupit të Vuksanit. Ishte e qartë. Ai nuk donte të bisedonte me të. Atij nuk i kish pëlqyer mbledhja e një dite më parë. Kur e ngarkoi karrocën, shkundi lopatën në një gur dhe deshi ta hidhte, po Drandja zgjati dorën. Ai u përmbajt dhe e vështroi përsëri.

Ajo i buzëqeshi turpshëm.

Ai pështyu duart dhe kapi dorezat e drunjta të karrocës dhe e shtyu atë me forcë, që të nxirrite rrotën nga vendi ku qe futur.

Drandja, duke pritur karrocën tjetër, e vështronte nga prapa.

Ai ecte rëndë, duke ngulur këmbët në baltë, sikur donte të fundoste mendimet e tij të këqia dhe të çliruhej prej ankthit që e mundonte. Marta Prendi, të cilën ai nuk e kish parë ndonjëherë i merre fytyrën e Drandes. Edhe historia e saj i ngatërrohej në mendje me historinë e Drande Pilsës. As njëra, as tjetra nuk kishin faj. Ato kishin vepruar drejt. Po ai ç'faj kishte?

«As unë nuk kam ndonjë faj — mendonte Vuksani duke shtyrë karrocën, pa e pasur mendjen te vullnetarët e tjerë të brigadës, që ishin shpërndarë gjatë trasesë. — Edhe unë si ato jam. Më kanë fejuar që kur isha kërthi dhe nuk e njoh të fejuarën time... Unë as e dua atë... Nuk e kam dashur ndonjëherë... Vetëm kam menduar për të... Jam munduar ta marr me mend si është, tamam si ai që blen një plaçkë të mbyllur në kuti dhe nxiton të shohë ç'ka blerë... Edhe mua më kanë poshtëruar... Edhe unë duhet të ngrihem kundër vetë fejesës sime, kundër vetës sime...»

Mendimi ifundit e tronditi. Një valë e nxehtë i përshkoi trupin dhe i hypi në kokë. Ndjeu dobësi në këmbë e në duar. Deshi të ndalej, po nuk u ndal. Shtrëngoi dhëmbët dhe vazhdoi të ecë përpara, duke shkelur rëndë në baltën e ngjeshur, sikur shkelte trazimet dhe shqetësimet e tij të kota. Ai e kishte më lehtë se Drandja, më

lehtë edhe se Marta Prendi. Ato ishin vajza dhe
qenë ngritur me guxim kundër gjithë zakoneve
e paragjykimeve. Dhe kishin fituar. Edhe ai duhej
të luftonte, edhe ai duhej të fitonte, po më parë
lypsej të luftonte kundër vetëvetes. Kjo ishte më
e vështira.

KAPITULLI I TRETË

Vullnetarët nuk e vunë re errësimin e shpejtë të qiellit dhe rrufeja e parë, që shkarkoi diku në fushë, u erdhi papritur dhe i tromaksi me dritën e saj verbonjëse dhe me krismën shurdhonyëse, që e pasoi. Retë e zeza po i tureshin diellit, që dukej se shkëlqente më fort. Gjithë qielli po sterrosej.

Filloi një shi i rrëmbyeshëm, që përplasej rreptas në tokë dhe hidhte përpjetë cirka balte, Maqina e përpunimit të llaçit e ndërpreu punën. Punëtori që e drejtonte vështroi qiellin dhe, kur shkrepëtiu rishtaz, hoqi edhe spinën elektrike nga priza. Vullnetarët e panë dhe rrufetë po u dukeshin më kërcnuese; ata u shtrënguan njëri pranë tjetrit nën platformën prej dërrase të maqinerisë dhe që andej vështronin fushën e gjerë dhe hapësirën e murme të prerë nga reshjet e vrullshme.

Askush nuk lëvizte. Në xhade kaloi me nxitim një kamionçinë nga ato të furnizimit. Siç dukej, shoferi nxitonte të hynte sa më parë në qytet dhe t'i jepte fund këtij udhëtimi të pakëndshëm. Dritat e automobilit zgjatëshin verdhacuke, si fasha të zbeta në hapësirën e murme.

Përroi nisi të grumbullojë ujë dhe uji zuri

të rrëshqasë i turbullt poshtë urës së papërfunduar. Ishte uji i parë që kalonte nën urën e ardhshme.

Edhe rruga e automobilit u përmbyt. Në fillim, uji rrëshqiste prej asfaltit në vijat anësore, po kur u mbushën vijat dhe arritën nivelin e rrugës, ai vërshoi drejt përpara, si një përrua i shpejtë dhe i cekët. Automobili hidhte anash stërkala uji të turbullt dhe dukej sikur lundronte.

— Po të vazhdojë kështu, do të përmbytet gjithë fusha — tha tekniku, duke u munduar t'i shmangej ujit, që i binte në qafë nga të çarrat e dërrasave të platformës.

— Andej nga ne nuk bien shira kaq të mëdha, — tha njëri prej vullnetarëve. — Ka raste kur gjithë dimrit bie vetëm borë...

— Edhe bora e shumtë është e keqe — tha tekniku kot.

— Mua më pëlqen. Bën ftohtë, po është e shëndetshme. Lagështia nuk durohet.

Përroi nisi të uturinte diku larg e të lëshonte një gjënim të rëndë. Uji përplasej në këmbët e paforcuar të urës, që mbaheshin prej dërrasave të armaturës. Ato një nga aksionistët i kish krahasuar me këmbët e futura në allçi.

Vullnetarët vështronin dhe heshtnin.

Edhe tekniku vështronte dhe heshte.

Të gjithë kishin një shqetësim dhe e fshihnin; kishin shpresë mos pushonte shiu dhe ndalej vërshimi i turbullt e i tërbuar i ujërave, që zbrisnin nga kodrat, gërryenin tokat e buta dhe derdhe-shin në përrua, duke marrë me vete llomishte e shkarpa. Po shiu vazhdonte dhe përroi sa vente

fryhej dhe bëhej më i rrëmbyeshëm, më gjëmimtar. Ujërat po u afroheshin shpatullave të urës.

Një tra i mbërthyer keq u shqye, u vërtit di-sa herë dhe mori tatëpjetë rrjedhën e rrëmbyesh-me.

Tekniku u bë nevrik. Deshi të ndizte një ciga-re, po ajo iu lag dhe u hap. Lëngu që lëshoi duha-ni i lagur i hidhëroi buzët.

— Ta marrë djalli — turfulloi ai dhe flaku cigaren e prishur. — Na vate mundimi dëm.

Vullnetarët nuk e kuptuan mirë ku e kishte fjalën: te ura apo te cigarja e prishur. Ai ishte nxi-rë në fytyrë dhe shtrëngonte dhëmbët. Kyçet e no-fullave i lëviznin me nxitim.

Komandanti i brigadës e vuri re dhe pyeti:
— A thua të pësojë gjë ura?

Tekniku e vështroi me zemërim, sikur të kish qenë ai shkaktari i gjithë kësaj fatkeqësie dhe bërtiti me inat, pa iu drejtuar kujt:

— Oj, ura po fluturon, ky më pyet a mund të pësojë gjë...

— Nuk e lemë të fluturojë — tha i vendosur komandanti i brigadës dhe u kthye nga sho-kët. — Si thoni, shokë?

Vullnetarët vështrojnë ujin, që përplasej e shkumëzonte dhe nuk iu përgjegjën në çast. Ata donin të bënin diçka. Ishin gati edhe të sakrifi-konin, po pyetja e komandantit u erdhi papritur. Ata nuk kishin menduar gjë deri në atë kohë dhe nuk parashikonin ç'kish ndër mend të bënte ai që pyeti.

— Hë, pra, si thoni?

— Ç'të ka shkrepur në kokë? — pyeti tekni-

ku i dëshpëruar. Edhe atij i vinte keq për urën. Edhe atij i dhimbsej ajo. Kishin punuar aq ditë dhe ja, një rrebesh i papritur do t'i jepte fund gjithshkaje, do ta shkallmonte brenda pak kohe, «Po le të të vijë keq sa të duash — mendonte tekniku. — Para disa fuqive të egra e të pakontrolluara të natyrës nuk ke ç'bën. Je i detyruar të lidhësh duart dhe të presësh me shpresë mos nuk ndodh e keqja më e madhe, mos shpëton qoftë edhe pak gjë nga gjithë ajo që shembet para syve të tu».

— Do të shpëtojme urën — tha komandanti.

Tekniku e pa me mosbesim dhe i tha me ironi:

— Hë... Gjepura... Ajo mbaroi — dhe lidhi duart, sikur me këtë veprim deshi t'u tregonte aksionistëve që çdo dëshirë e mirë e tyre ishte e kotë dhe çdo kundërshtim — pa vlerë.

— Jo, pra, jo — klithi kësaj radhe komandanti i brigadës i alarmuar dhe i nxehur nga qëndrimi apatik i teknikut. — Nuk mbaron ura, sa të jemi gjallë ne që e ndërtojmë. Partia na e ka besuar edhe ta ndërtojmë, edhe ta mbrojmë.

Teknikut nuk i erdhi mirë. Fjalët e fundit të komandantit të brigadës i goditën nervat. Atij kështu i ndodhte gjithnjë, kur dikush përdorte në bisedë fraza dhe parulla të përgjithshme politike. I dukej se ato përdroreshin vetëm për pompozitet, për lustër, kur njerëzve u mungonin argumentat konkrete dhe bindëse për çështjet që bisedoheshin. Deshi t'ja shfaqte këtë mendim komandantit të brigadës, po nuk foli. Vetëm nënqeshi me tallje.

— Të gjithë djemtë të vinë me mua — urdhëroi komandanti dhe, pa pritur pëlqimin e kujt, u vërsul përpara përmes shiut.

Kur kuptoi qëllimin e djaloshit, që u ndal buzë përroit të egërsuar, tekniku thirri:

— Mos bëni marrëzira, se do të mbyteni. Në djall të vejë ura...

Po vullnetarët, që i vajtën pas shokut të tyre, qenë zënë dorë për dore dhe pa hynin në përrua; ata nuk e dëgjuan zërin e tij; prej shungullimës së përroit mezi dëgjonin edhe shoku-shokun.

Një djalë i shkurtër, që i qe trembur vërshimit të ujit dhe nuk kish dalë prej strehës, kur pa shokët që ishin bërë gardh para urës, u nis drejt tyre me vrap dhe i tha teknikut të frikësuar:

— Mos u bëj merak. Po të kapemi fort me njëri-tjetrin, s'ka ç'na bën edhe lumi më i tërbuar...

«Qenkan të çmendur — tha tekniku me vete. «Edhe po s'u mbytën, do të pleviten» — dhe dridhja të ftohta i përshkuan trupin. Ai kishte përgjegjësi për këtë që ndodhte. Po të pësonte gjë ndonjëri prej aksionistëve, ai do të përgjigjej «pse i le?» — do t'i thoshnin. Mund të merrnin edhe ndonjë masë ndëshkimore kundër tij.

Vajzat shihnin teknikun dhe pëshpërisnin. Edhe ato mërdhinin dhe ndjenin të rrënqethura, duke parë shokët e zhytur në përrua, ndaj mbështilleshin më mirë dhe shtrëngoheshin më fort me duar të futura në sjetulla.

Ai e dinte që flisnin për të, që e vështronin me përçmim e me keqardhje dhe nuk guxonte të

kthehej nga ato. I vinte zor. Kish turp. Ai nuk qe më i mirë nga të tjerët, vetëm mbahej si më i zgjuar dhe më i ditur. Ata e kishin dëgjuar gjithnjë me vëmendje dhe me dashamirësi, kur u fliste, me aq sa dinte për shkencën dhe për teknikën, për ndërtimet e mëdha industriale dhe për perspektivat. Po ja, erdhi ky çast i vështirë dhe ai u nda prej tyre në një kohë kur duhej t'u vente pas, kur duhej të mësonte jo prej diturisë së tyre, po prej gadishmërisë për sakrifica dhe heroizma. Ai mbeti atje i poshtëruar prej aktit të aksionistëve dhe ishte i detyruar të duronte vështrimet dhe pëshpëritjet e vajzave.

«Ters e nisa me këta që në fillim» mendoi. Ngriti jakën e xhakëtës dhe e mbërtheu te fyti me një gjilpërë me kokë.

Kur u bisedua në shtabin e sektorit për ndërtimin e kësaj ure, ai kish propozuar që t'i besohej brigadës së teknikumit të ndërtimit, po një djalosh, që merrej me propagandën, e kish kundërshtuar me zemërim.

— Urën ta ndërtojnë aksionistët e malësisë, — kish thënë ai me vendosmëri, sa që të tjerëve u la përshtypjen, se nuk do të linte gur pa lëvizur për të realizuar mendimin e vet.

— Ata nuk dinë, — qe hedhur tekniku kundër tij.

— Pikërisht pse nuk dinë, urën duhet ta ngrenë ata...

Kjo mënyrë të arësytuari teknikut i qe dukur tepër paradoksale, ndaj nuk iu ndenj pa thënë:

— Ti flet përçart...

— Ashtu të duket, — i qe përgjegjur djaloshi, pa u fyer, — se nuk mendon thellë. Ne duhet t'i mësojmë njerëzit. Kazmën dhe lopatën ata e gjejnë edhe në fshat. E kanë pasur në dorë edhe dje, po nesër do të hyjë edhe atje betoni dhe do të kryhen ndërtime të mëdha. Dhe, lum miku, — përdori një shprehje karakteristike malësorësh, — ndërtonjës do të jenë ata. Nuk do të mbetemi vetëm unë dhe ti. Ata ne do t'i vemë të parët që të shtrojnë binarët dhe të montojnë shinat, sapo të mbarojë qoftë edhe një copë trase. Po të kishim mundësi në atë copë hekurudhë, do t'u sillnim edhe lokomotivën, që të shihnin me sy dhe të preknin me dorë frutin e punës së tyre revolucionare. Se ky është revolucion i madh, o shokë, — kish vazhduar propagandisti me ton patetik, — dhe në këtë revolucion kryesore nuk është ura, po njeriu. Bashkë me veprat që ngremë ne, ndërtojmë edhe njeriun e ri.

Tekniku edhe atëhere e kish dëgjuar me vështirësi këtë deklaratë të gjatë politike dhe nuk i qe mbushur mendja.

— Parimisht jam dakord, — meqë nuk deshi të kundërshtonte hapur, — po...

Kishin diskutuar gjatë. Më në fund shtabi kish vendosur me shumicë votash që urën ta ndërtonin aksionistët e malësisë.

Komandanti i brigadës, ai djalë i hollë e i gjatë, me fytyrë të mprehtë e thatime, me të dalë nga mbledhja, i qe afruar teknikut dhe i kish thënë:

— Mos u mërzi, shoku teknik... Ne vërtetë nuk dimë, po ti do të na mësosh dhe ne do të

bindemi. Ke pën të mbetur i kënaqur prej nesh... Unë që nesër do të mbledh brigadën në vendin ku do të ngrihet ura. Eja edhe ti dhe na folë... na folë për gjithshka: edhe për hekurin, edhe për çimenton, edhe për armaturat...

Tekniku e kish vështruar malësorin me simpati. I pëlqeu që komandanti i brigadës, megjithëse shtabi kish vendosur, sillej shumë butë me të dhe i fliste sikur donte t'i lutej. Ai kish dëgjuar se malësorët janë njerëz krenarë dhe i përbuzin fusharakët.

— Ne jemi njerëz krenarë — kish vazhduar djaloshi, sikur kish thithur mendimin dhe dyshimet e teknikut — dhe kemi sedër, po diturisë, punës dhe trimërisë i përulemi. Ke për të parë sa shpejt do të mësojmë dhe sa të bukur do ta bëjmë urën.


— Duhet e fortë, nuk duhet e bukur, — kish geshur ai.

— Edhe të fortë do ta bëjmë — ishte entuziazmuar djaloshi, që kish gjetur një gjuhë të përbashkët me teknikun.

Një pjesë e këtij entuziazmi kish rrëmbyer edhe teknikun.

Dhe malësorët vërtet mësuuan shpejt dhe punonin mirë. Tekniku u miqësua me ta. Ai gjente kohë të hidhej edhe në objekte të tjera të sektorit dhe ishte i sigurt, se udhëzimet e tij do të zbatoheshin me përpikmëri.

Tani ura ishte në të përfunduar e sipër. Gjithë mëngjezin qenë mbushur armaturat e këmbëve dhe karrocet e ngarkuara me beton derdheshin në zgavrat e shpatullave të ardhshme.



Mendimi dhe puna po materializoheshin në një vepër të re.

«Ters e nisa» përsëriti ai me vete, duke u shkëputur prej këtij kujtimi dhe, pa menduar më hollë, doli prej strehës dhe mori drejtimin e përroit. Ecte ngadalë dhe i pavendosur. Shiu e lagte. Rrjedha e furishme e ujit e trembte, po prapa nuk mund të kthehej më. Nuk donte të bëhej qesharak.

Kur mbëriti afër urës ishte qullur fare. Shiu i kish pëshkuar kanatieren dhe të mbathurat. Ai e ndjente ftohtësinë e lagësht të ujit në mish.

Rrjedha përplasej e turbullt dhe e shkumëzuar në gjokset e aksionistëve dhe u hidhej në fytyrë si me të tallur. Ata, duke u mbajtur me njëri-tjetrin, kërcenin përpjetë, pështynin dhe zinin vend përsëri.

Teknikut i vanë syt te vullnetari i shkurtër, që përkulej sa para prapa. Siç dukej, atij nuk i zinin këmbët dhe.

Ata nuk e shihnin teknikun; ata vështronin përpara, andej nga merrte vrull përroi i turbullt, sikur kishin shpresë se do të shteronte papandehur. Po përroi vinte gjithnjë e më i rrëmbyer dhe shiu nuk pushonte. Trupat e tyre, që u ftohën, tani pothuaj kishin ngrirë fare, ishin mpirë. Shqetësimin më të madh e kishin prej ujit, që u kullonte nga flokët dhe u hynte në sy dhe në vrimat e hundës. Nga ky siklet nuk kishin si të shpëtounin, ndaj fërkonin hundë e sy në supet e qullura të shokut, që kishin përkrah.

«Do hyj edhe unë» — vendosi tekniku. —
«Më mirë të sëmurem, se të duroj turpin» — dhe i zgjati dorën vullnetarit të anës.

Vajzat, që kishin mbetur nën strehë dhe e kishin ndjekur me vëmendje e me komente tallëse këtë skenë, rrahën duart dhe thirrën së bashku:

— Të lumtë, teknik!

Drandja u tha shoqeve:

— Tekniku bëri ç'bëri dhe hyri, më në fund, kurse ne vetëm vështrojmë dhe duartrokasim. A nuk është turp?

Shoqet e vështruan një copë herë të heshtura. Edhe ajo i vështroi të gjitha vajzat me radhë dhe e kuptoi se nuk do ta kishte të vështirë t'i tërhiqte me vete.

— Kush do të vijë me mua? — pyeti.

— E ç'të bëjmë?

— Të zëvendësojmë shokët. Ne do të kapemi pas teknikut dhe do të shtyjme djemtë, që të dalin në anën tjetër...

— Unë nuk mund të kapem me një burrë të huaj, — tha njëra nga vajzat, duke pasur parasysh teknikun.

— E para po hyj unë! — tha Drandja.

— E dyta unë!...

— E treta unë!...

— Unë e katërta!...

Vajzat më të mëdha dolën prej strehës dhe iu afruan përroit, po djemtë nuk pranuan të zëvendësoheshin; ata nuk shtyheshin, nuk lëviznin dhe nuk pranonin t'i linin vetëm vajzat përballë furisë së përroit. Drandja u mendua një çast dhe, meqë fjala nuk dëgjohej, iu kujtua të përdorte «telefonin pa tel» dhe i foli në vesh teknikut:

— Po hyjmë vetëm pesë vajza dhe të dalin pesë djem, sa të shtrydhin rrobat... Kur të kthehen ata, të dalin pesë të tjerë...

Tekniku, që ishte zverdhur në fytyrë dhe shtrëngonte nofullat, u tregua i gatshëm të transmetonte fonogramin e Drandes, i cili kaloi vesh më vesh dhe, kur arriti te komandanti i brigadës, mori formën e urdhërit të prerë:

— Të dalin pesë djemtë e anës së djathtë dhe të kthehen pas dhjetë minutash!

Më të ngrysur, shiu pushoi fare dhe niveli i ujit të përroit ra. Aksionistët e fundit dolën dhe e lanë rrjedhën të kalorte e qetë poshtë urës së papërfundur.

— A u ftohe, shoku teknik? — pyeti Vuk-san Ndreka, duke shtrydhur gozhupin e vet. Atë ditë ai kish harruar gjithshka dhe qe çelur në fytyrë si më parë.

Tekniku vështroi aksionistin dhe tha:

— Ju lumtë, djema! E shpëtuat urën!

— E shpëtua, thuj! — ndërhyri komandanti i brigadës.

Tekniku e vështroi me mirënjohje dhe tundi kokën. Para atyre malësorëve të rinj, vetja i dukej e vogël, pa rëndësi. Kish pasur të drejtë ai që i kish thënë, se po të kapeshin fort me njëri-tjetrin, mund t'i bënin ballë edhe lumit më të tërbuar.

KAPITULLI I KATËRT

— Zbrisni, xhaxho; arritëm në Rrogozhinë!

Nga vagoni i klasës së tretë të trenit të mbrëmjes zbriti me vështirësi, duke u mbajtur në hekurat e derës, një malësor me shtat të gjatë, me flokë e mustaqe të thinjura, i veshur me rroba të leshta karakteristike dhe i mbathur me opinga lëkure.

Malësori kaloi përmes turmës së madhe të udhëtarëve, që hypnin e zbrisnin nga treni, kapërxeu shinat e stacionit dhe mori udhën teposhtë, duke ndjekur të tjerët pas.

Në agjensinë e autobuseve nuk pati fat: kish shumë njerëz, që shtyheshin e grindeshin. Pyeti në ç'drejtim binte Lushnja dhe, i vetëm dhe i heshur, u nis më këmbë, me shkopin e thantë në dorë dhe me trastën e vjetër hedhur krahut. **E** ç'ishin për atë tri orë rrugë më këmbë? Ai kish ecur brinjave e shkrepave, honeve e greminave, pyjeve e brigjeve, dimrit e verës, natën dhe ditën, gjithnjë i vetëm, gjithnjë me shkop në dorë e me pushkë krahut, jo një orë e dy, po edhe dhjetë e dy mbëdhjetë orë rresht. Dhe ç'rrugë se! Ç'ishin tri orë udhëtim në këto rrugë të shtruara me asfalt para shtegëtimeve të tij të panumërta e të palo-



dhshme? Nga këmbët ishte i fortë. Edhe në përgjithësi mbahej mirë. Nuk ishte edhe shumë i mosshuar: me ç'mbante mend vetë, nuk duhej të ishte më tepër se pesëdhjetë e gjashtë vjeç. Dhe gjithë jetën kish qëndruar më këmbë.

Kaloi tregun e vogël të Rrogozhinës dhe u ndal pranë një turme vullnetarësh, që shkarkonin zhavor nga kamionat. Atje kish shumë kamiona, shumë zhavorr dhe shumë njerëz. Ai s'kish parë asnjëherë aq shumë kamiona; nuk kish parë asnjëherë varg aq të gjatë llambash elektrike, që kalonin tej-përtej lumin si një shirit i ndritshëm ngjyrë portokalli. Qëndroi e pyeti dikë për të birin, po i thanë se nuk e njihnin dhe se nga Mirdita nuk dinin të kish aksionistë në atë sektor.

— Duhet të mundoheni gjer në Lushnjë. Brigadat e malësisë punojnë në sektorin e qendrës.

Malësori përshëndeti me dcrë dhe vazhdoi udhën, duke u munduar të kuptonte përse duhej gjithë ai zhavor, që shkarkohej fushës dhe kish krijuar një brez të gjerë e të lartë, që lakohej si hark qindra metra i gjatë. Po ç'të mendohej më tepër! Rruga që kish për të bërë nuk qe e shkurtër dhe nata e tetorit kish rënë tejendane fushës e kodrinave, që nxinin në errësirë. Qielli ishte mbuluar me re të dendura e të zeza.

Sapo kaloi urën e vjetër dhe po vështronte si betonoheshin shpatullat e urës së re e të gjatë, para tij kaloi një veturë. Ai ngriti dorën, megjithëse nuk besonte se mund ta merrnin. Po nuk është mirë të mendosh e të ndjellësh kurdoherë të keqen. Vetura u ndal disa metra larg tij dhe shoferi nxori kokën nga dritarja dhe pyeti me zë të lartë:

— Ku do të vesh, xhaxho?

— Në Lushnjë... — Kam djalin aksionist — shtoi malësori, që t'i mbushte mendjen shoferit për ta marrë.

— Hyp — i tha shoferi dhe i çeli derën e prapme të automobilit.

Malësori rëndoi në ndenjësën e butë dhe vettura u lëkund, sa ai nënqeshi me vete, duke vështruar ata që ishin aty.

— A jeni burra? — përshëndeti.

— Mirë mbrëma.

Malësori tjetër, që ndodhej në automobil, nuk foli, po u shty pak më tutje që t'i lironte vendë të porsaardhurit. Ai kish lidhur duart sipër gjunjëve dhe shikonte përpara me një vështrim të humbur. Ishte edhe ai shtatgjatë dhe i thatë dhe s'dukej të ishte më i ri nga ai tjetri, po flokët, që i rrinin sert dhe formonin një tufë sipër ballit, nuk i kish dhe aq të thinjur.

— Trim pa zorrë në bark! — tha me vete malësori, pasi mbaroi hetimin e shokut që kishte për-krah dhe vështroi një djalë thatim, zeshkan e trupimtë, që ishte ulur pranë shoferit.

— Nga ju kemi? — pyeti zeshkani sa për të çelur bisedën.

— Mirditor jam. Kam një djalë aksionist në hekurudhë... — nxitoi të shpjegonte malësori.

— Të ka marrë malli?

— Jo, or ti shok, nuk më ka sjellë malli gjer këtu, po halli...

— Pse? — dhe zeshkani u kthye në brinjë, që ta shihte malësorin në fytyrë.

Malësori hetoi mirë fytyrën e djaloshit zeshkan,

sikur deshi të vendoste në i duhej besuar atij njeriu apo jo. Vështrimi i tij u duk i përzemërt, i çiltër dhe kërkimtar, po aty për aty nuk deshi të hapej aq shpejt para një të panjohuri. Bëri sikur nuk e dëgjoi dhe, në vend që t'i përgjigjej atij, i foli malësorit që kishte në krah:

— Malësor po më dukesh.

— Po. Nga Dukagjini.

— Nga ç'fshat? — pyeti i interesuar.

— Pecaj i thonë.

— E kam dëgjuar... Ke edhe ti njeri në hekurudhë?

— Po. Kam vajzën.

— Mirë boll ke bërë që ke zbritur ta shohësh. Vajzat e kërkojnë më fort kujdesin dhe dashurinë e prindit.

— Besa s'do ta kisha marrë këtë mundim, se vajzën nuk e kam lënë ndër të huaj, po në dorën e partisë — foli thjesht e qetë malësori, duke vështruar gjithnjë përpara i papërqëndruar — veçse më është plagosur vajza, or shok, ndaj po vij ta shoh, pale si është.

Ai u përlot dhe kapërdiu pështymën me zor.

— Të jetë rëndë? — pyeti i interesuar malësori.

— Unë me sytë e mi nuk e kam parë, po gjersa më thonë se për shëndetin e saj është kujdesur vetë Enver Hoxha dhe kur shoh nderin që po më bëhet, them se nuk do të jetë lehtë.

— Bre! — lëshoi një thirrje habie malësori dhe e vështroi edhe një herë në mënyrë hetonjëse dukagjinasin, mos dallonte ndonjë shenjë, që ta lartë-

sonte atë burrë për bijën e të cilit qenkej interesuar vetë Enver Hoxha. Nuk dalloj as shenja pozitive, as ndonjë gjurmë krenarie. Ai ishte i veshur thjesht. Duart i kishte të mëdha e të ashpora. Dukej se ishte punëtor krahu. Atëhere pse gjithë ai interesim për vajzën e tij dhe për atë vetë? Duhej të kish diçka në këtë mes, diçka që malësori nuk ja kish thënë.

— E madhe vajza? — pyeti tërthorazi për të nxjerrë në kish pasur ndonjë meritë të veçantë ajo.

— Pesëmbëdhjetë vjeçe...

— Njomëzake! — tha dhe kureshtja nuk iu shua. Për një fëmijë zor se interesohen kot aq tepër. Gjithë jetën ai kish dëgjuar të interesoheshin për njerëz me rëndësi, po kurrë për një njeri të zakonshëm e, aq më tepër, për një... vajzë, për një fëmijë. Pat menduar shpesh për fatin e njerëzve, duke lëruar arën e vogël midis shkëmbinjve dhe gjithnjë kish arritur në të njëjtin përfundim: ka njerëz të zotët, që çelin rrugë në jetë dhe merren me punë të mëdha e me njerëz të mëdhenj, kurse shumica ulin kokën në punët e veta. Për të parët interesohet shumëkush, ndërsa të dytët duhet ta gatuajnë vetë dhe vetëm fatin e tyre. Dhe a nuk është për t'u habitur kur degjon se po kujdesen aq fort për një vajzë pecjane dhe për të atin e saj? Diç duhet të ketë në këtë mes: o diçka që atij nuk ja thonë, ose diçka tjetër që ai nuk e kupton.

— Vërtet njomëzake, — ndërhyri djaloshi zeshkan në bisedë, — po ishte shpuzë. Kaq është — dhe hapi pëllëmbën. — Të gjithë e duan, qoftë për punë, qoftë për sjellje. S'ka si Shkurte Vata! — thonë. Edhe në spital nuk i është dëgjuar një herë

zëri. Unë kam qenë çdo ditë për ta parë, — vendosi të flasë ai, jo aq për t'i shpjeguar mirditasit, se sa që të përgatiste të atin për gjendjen e rëndë të së bijës. Pas disa minutash do të ishin në spital dhe ai duhej të mos ndodhej para të papriturës. — Mjekët, që janë kujdesur shumë, habiten me të dhe veç fjalë të mira dëgjon të thonë. Të gjitha operimet i ka përballuar si burrneshë. Edhe dhimbjet, që janë të forta, se ka pasur dhimbje të rënda, i duroi duke shtrënguar dhëmbët dhe duke kafshuar buzët. Dje, kur e pyeta si e ndjente veten, megjithëse sa kish dalë nga salla e operacioneve, u mundua të më buzëqeshte dhe më tha:

— Më mirë jam, shoku sekretar. Po do të qëndroj shumë këtu në spital. Kur të kem dalë unë, brigada do të jetë larguar...

— S'ka gjë — i thashë, — shërohu!...

— Po besoj që do të vijë edhe ndonjë brigadë tjetër nga Dukagjini. Atje ka edhe shumë djem e vajza që nuk kanë ardhur... Si thua, shoku sekretar?

— Patjetër do të vijë.

Ajo buzëqeshi.

— Unë do të qëndroj me ta... — dhe u lëshua në shtrat.

— Vajzë trime! — psherëtiu mirditori, kurse Pal Vata, i ati i aksionistes së plagosur, fshiu lotët me dorën e djathtë.

— Ke vajzë të mrekullueshme, shoku Pal, — i tha sekretari i komitetit të partisë së hekurudhës me entuziazëm, duke u munduar që në zërin e tij të mos ndihej asnjë notë shqetësimi.

— Tani po kuptoj gjithshka — tha Pal Vata dhe mbështeti shpatullat në kreshtën e ndenjës së veturës. U lodh menjëherë. Deri në atë çast ai kish pasur një tension të brendshëm, një shqetësim dhe një shpresë. Tani, që sekretari i komitetit të partisë ja tregoi haptas si qëndronin punët, në një minutë ai ndjeu gjithë drobitjen e atyre ditëve, gjithë peshën e jetës e të moshës së vet. Për një të qindën e sekondës mendoi se vajza mund edhe të kish vdekur. Kur e përfytyroi ashtu të shtrirë, të ngrirë, pa frymë, u drodh dhe i sëmboi zemra. E largoi shpejt këtë mendim ogurzi dhe me gjithë shpirt besoi fjalët e vërteta të sekretarit. «Njerëzit e partisë nuk gënjejnë kurrë», tha me vete dhe përsëri fshiu lotët.

Nuk kish pandehur ndonjëherë më parë se do të ishte aq i dhëmbshur. Ishte nga ata njerëz për të cilët nuk thuhet se kanë jetuar, po kanë luftuar me jetën për t'i rrëmbyer diçka. Gjithë jetën kish luftuar me egërsinë e maleve, me shterpësinë e asaj copë toke, që i mbante gjallë shpirtin, me thëllimet e ashpra të dimrit që i përballonte mezi në konakun e vogël të ngritur buzë një shkëmbi, me sëmundjet. Jeta, si një kudhër vigane, e kish ashpërsuar dhe e kish kalitur karakterin e tij. Sado që e donte të bijën dhe i gëzohej zgjuarsisë së saj, sado që e shihte me dhëmbshuri kur ajo merrte fluturimet e para në jetë ashtu si fëmijë, prapë dashurinë dhe shpresën më të madhe e kish shtënë tek i biri, i cili, megjithëse më i vogël nga e motra, do t'i dilte krah dhe do t'i lehtësonte barrën e rëndë të jetës.

— Mbahu, he burrë! — tha mirditori dhe i

hodhi dorën në krah Pal Vatës. — Gjersa thotë sekretari, vajzën do ta gjesh vërtet mirë — dhe priti që sekretari të fliste përsëri për të zbutur përshtypjen e fjalëve që kish thënë pak më parë. Po sekretari nuk foli më dhe në veturë të gjithë heshtnin.

«Duket se është shumë keq» mendoi mirditori dhe u mundua të përfytyronte vajzën e plagosur, në shëmbëllim me vajzat e tjera malësore. «Djali vërtet të dhimbset më tepër» mendoi ai, «po për vajzën të vjen më keq. Fatkeqësitë, dhimbjet, madje edhe vdekja vetë sikur janë krijuar më tepër për burrat. Vajzat sesi të ngjan se janë të pambrojtura para atyre dhe prandaj edhe të vjen më keq për to».

— Ju nuk na thatë pse keni zbritur në Lushnjë — pyeti sekretari, duke dashur të çelë një bisedë që do t'ja largonte mendjen Pal Vatës nga e bija.

Mirditori u drodh. Pasi kish dëgjuar historinë e vajzës së plagosur, atij i vinte turp të tregonte pse kish zbritur nga malet dhe me ç'mendime po vinte tek i biri. U mundua t'i bëjë bisht përgjegjes:

— Kam djalin në aksion. Mbase ja keni dëgjuar zërin, Vuksan Ndreka quhet...

Sekretari rrudhi ballin. Ishte pothuajse i sigurt që nuk e njihte, po emrin mbase edhe mund t'ja kish dëgjuar.

— Nuk më kujtohet — i tha. — Po besoj se punon mirë. Sa vjeç është?

— Tetëmbëdhjetë...

— E ke fejuar?

Malësori përsëri u drodh dhe tha me majë të buzëve:

— Po.

— Kot pyeta — vazhdoi sekretari, — se e di që ju i fejoni shumë herët fëmijët tuaj. Po a i ke gjetur ndonjë farë vajze?

— Si të të them — u përtyp mirditori, duke u përpjekur të mos i japë një përgjegje të saktë edhe kësaj radhe. — Vajzë e mirë boll ka qenë.

— Po tani nuk është? — qeshi sekretari.

Malësori bëri një lëvizje përçmimi me dorë dhe nuk foli.

Sekretarit i pëlqeu biseda. Do të ishte ndonjë nga ato historitë e fejesave të prishura kohët e fundit. Malësorit i vinte zor të tregonte që krushqit i kishin dalë fjalet dhe ai s'kish gjetur rrugë tjetër, po kish ardhur të takonte djalin për t'u ngushlluar me të dhe, mbase, edhe për të gjykuar ç'duhej të bënin para kësaj të keqeje. Për të vazhduar bisedën që mirditori e ndërpreu me atë lëvizjen përçmonjëse të dorës e që dukej se i thosh: mos më pyetni më gjatë se nuk ju përgjigjem, sekretari e hodhi përsëri fjalën larg:

— Si ju quejnë?

— Pjetër... Pjetër Ndreka...

— Po mirë, mor shoku Pjetër, ju e prishët krushqinë apo familja e vajzës?

— Nga e di ti se është prishur krushqia? — u nxeh Pjetër Ndreka, të cilit pyetja e sekretarit iu duk e paturpshme.

— E marr me mend...

— Shumë gjëra merr me mend njeriu, po të gjitha nuk duhet t'i besojë si të vërteta. Burrat mentarë nuk flasin kurrë me hamendje — sulmoi Pjetri, që ta detyronte sekretarin të heshte, po ai nuk u nxeh dhe nuk u fye, siç pat parashikuar malësori. Mendoj një çast dhe pastaj tha:

— Fjalë me vend, veçse unë vetëm një gjë di të them: po të kesh zbritur nga malësia për këtë punë, nuk ke bërë edhe aq mirë...

— Ku do të qëndroni? — pyeti Pjetrin shoferi.

Ai ngriti supet.

Shoferi shikoi sekretarin.

— Para hotelit...

Vetura qëndroi. Pjetri zbriti dhe përshëndet me dorë.

Kur mbeti vetëm dhe nuk dinte nga të vërtitej, mendoj edhe vetë që kot i kish hyrë atij mendimi të madh, se, me të vërtetë, asgjë me rëndësi nuk do të ishte i zoti të bënte. Kohët po ndryshonin dhe ai do ta kishte shumë të vështirë të përshtatej me mendimet e reja, që po hynin në jetë me fërtymë. Edhe të luftonte kundër tyre as donte, as mundej. Kish diçka që e detyronte t'u përshtatej këtyre mendimeve, siç kish diçka edhe që nuk e linte të pajtohej plotësisht me to. Ai nuk e kuptonte plotësisht këtë nyjë, ndaj edhe e kishte vështirë ta zgjidhte.

«Si nuk vajta edhe unë në spital bashkë me ta?» tha me vete. «Zakoni e lypte... Dhe jo vetëm zakoni».

Po ishte vonë. Ai nuk dinte të orientohej në

qytetin e vogël e të panjohur, që i ngjante më i madh nga ç'ishte, se nata, siç zmadhon të gjitha gjërat, zmadhon edhe qytetet.

«Duhej të kisha vajtur» psherëtiu dhe hyri në hotel për të kërkuar vend. Me të birin do të takoj të nesërmen.

Kishte kohë.

KAPITULLI I PESTË

Kur e morën vesh në brigadë që Vuksan, Ndrekën e kish lënë e fejuara, të gjithëve u erdhi keq. Atij nuk i thanë gjë, po me njëri-tjetrin e biseduan gjatë dhe e shtjelluan hollë këtë çështje, duke thënë secili fjalën e vet. Përgjithësisht punët e të tjerëve zgjidhen më lehtë nga ngatërresat vetiake. U shprehën shumë mendime. Një palë thoshin se Vuksani e kish gabim që dëshpërohej e veçohej nga shokët. Vajza kish vepruar drejt, si revolucionare, kurse atij duhej t'i hiqnin veshin, që nuk i kish hapur zemrën organizatës së rinisë në mbledhjen që patën bërë për prishjen e fejesave të lidhura në mituri. Një palë tjetër, më të paktë se të parët, mendonin se vajza vërtet kish vepruar drejt, po para se të merrte vendimin, do të kish qenë më mirë të pyeste kush ishte Vuksan Ndreka. Shumë vajza kështu kishin vepruar. Ishin njohur me të fejuarit e tyre dhe nuk e kishin prishur krushqinë. Kish nga ato që u kishin dërguar edhe letra dhe i kishin tërhequr me vete në aksionet e rinisë. Vuksani ishte deli djalë, në daç në të parë, në daç për punë e për çifteli. Po të parët këtë zgjidhje e quanin oportuniste. Kështu zakoni i

vjetër do të vazhdonte me një formë të re, vërtet më të mirë se fejesat në djep, po shumë të keqe në krahasim me atë që duhej arritur. Pastaj, vazhdonin ata, edhe e mirë të kish qenë një zgjidhje e atillë, prapë Vuksani e kish fajin më të madh. Ai vetë duhej t'i kish dalë së keges përpara, t'i kish shkruar një letër ose (pse jo?) edhe të kish vajtur drejt e në fshatin e saj dhe të njihej me të. Kështu, mbase, edhe do të ishin pëlqyer dhe fejesa nuk do të ishte prishur. Mirëpo e keqja është se prindërit e tij dhe ai vetë e patën menduar gjithnjë si të mbaruar atë punë, se i mbronte zakoni. Nuk ua merrte mendja t'u dilte doret nusja e ardhshme, për të cilën kishin paguar edhe pare. Për këtë Vuksanit ishte mirë t'i bëhej një dush i ftohtë, që të mblidhte veten dhe të shkëputej pa ngurim nga mendimet e mykura. Edhe i ati, që nuk e linte një minutë vetëm në orët e lira, duhej të merrte pjesë në mbledhjen e brigadës dhe, po të mos bindej, t'i dërgohej një fletërrufe në fshat. Dukej ai që kish ardhur me qëllime të këqia, se gjithnjë rrinte i ngrysur dhe pinte duhan.

Nuk duhet gjykuar aq ashpër dhe aq me lehtësi, thoshte ndonjëri. Njeriu, kur gjykon e flet për shokun, duhet të mendojë sikur është ai vetë që po gjykohet. Vetëm kështu mund t'i shtrihet dora tjetrit dhe t'u jepet udhë halleve të tij. Dhe halli i Vuksanit këtyre nuk u dukej aq i rëndë e i vështirë për t'i dhënë një rrugë të pëlqyeshme. Po të ishin të gjithë në një mendje, këta propozonin që brigada t'i dërgonte një letër Marta Prendit, ta përgëzonte për qëndrimin e saj revolucionar që kish mbajtur ndaj një zakoni sa të

vjetër, aq edhe çnjerëzore, po dhe t'i thoshte se Vuksan Ndreka kish dalë, si askush tjetër në brigadë, katër herë sulmonjës...

— Tani e qelbët fare — u hodh e tha një aksionist. — Ne Vuksanin e kemi shok, po për hir të shoqërisë nuk ka hije të veprojmë kaq marrëzisht. Partia thotë që të kalitemi si revolucionarë, kurse ju doni ta bëni zvaranik. Ai vetë duhet të ngrihet kundër zakoneve të poshtëra dhe, po të jetë puna për letër, ai duhet t'i shkruajë Marta Prendit...

— Dole te fjala jonë — e ndërpreu dikush.

— Mos u ngutni — tha aksionisti, duke u bërë shenjë me dorë. — Te fjala juaj dalin vetëm ata që duan të veshin zakonet e vjetra me kostum të ri... Unë dua të them tjetër gjë. Ai t'i shkruajë e t'i thotë se deri sot ka pasur byk në kokë...

— E provofsh vetë — sulmoi një tjetër.

— E kam provuar — tha djali, — veç nuk prita gjatë, ndaj edhe nuk vuaj si ai që i janë mbytur gjemitë. Pa ditur ç'do të bënte vajza, u ngrita në mbledhjen e organizatës së rinisë dhe e quajta të paarësyeshme martesën me një të panjohur... Ne themi se duhet të çlirojmë gruan, po duhet të çlirohemi edhe vetë nga shumë të këqia...

— Siç duket, ti do t'i kesh vënë syrin ndo një thëllëze tjetër, që je treguar aq i gatshëm — e ngacmuan djaloshin.

Ai vuri buzën në gaz dhe kroi kokën me çap-kënëri.

— S'është për t'u habitur! Unë nuk jam as skllav, as i metë... Edhe e fejuara ime mbase ka qenë e mirë, e bukur, e zgjuar. Unë nuk

pendohem. Edhe ajo s'ka pse të dëshpërohet. Ne nuk shkelëm njëri-tjetrin. As ajo, as unë nuk jemi lecka. Ne shkelëm zakonin dhe këtë gjë duhej ta bënim patjetër, që t'u nxjerrim rrënjët e kalbura çibanëve të kohës së shkuar...

— Kuptohet... Ti për vete e paske vënë festen mbi sy, prandaj flet serbes...

— E, pra, — e kapërxeu bisedën i pari, — Vuksan Ndreka është punëtor i mirë, po nuk është revolucionar i vendosur. Ai nuk ka menduar dhe nuk ka vepruar drejt. Në kokën e tij duhet të ketë shumë byk.

— Myk thuaj...

— Sa për të atin, unë them ta shohim punën më shtruar. Në qoftë se ai ka ardhur këtu për punë të krushqisë së prishur, ne nuk duhet të rrimë duarkryq. Të mundohemi ta bindim dhe, po nuk u bind, t'i tregojmë rrugën nga ka ardhur.

— Ti, Sadri Mehmeti, ke të drejtë — tha një tjetër aksionist. — Ne u nxituam. U nisëm për t'i bërë mirë shokut dhe, padashur, shumë vendin e shkuesve. Po veç një gjë: mos na folë me aq zjarr për atë Marta Prendin. Nuk është çudi që asaj t'i ketë prishur mendjen ndonjë bukurosh atje në fshat dhe ka gjetur shkas tani të prishë fejesën...

— Edhe sikur të ketë ndodhur ashtu siç thoni ju, ç'të keqe ka?

— Ajo ishte e fejuar. Vërtet ka qenë fejuar sipas zakoneve, po prapë duhej t'i qëndronte besnik atij që edhe mund ta kish marrë burrë... Nderi i vajzës e lyp kaq gjë, apo jo?...

— Ti, lum miku, — sulmoi përsëri Sadri Mehmeti, që nuk deshë të dorëzohet dhe që e shihte se fjalët e tij po bënin për vete gjithë brigadën — nga mendimet qenke më i ndryshkur se gjyshi im, prandaj del kaq hapur në mbrojtje të kanunit...

— Unë nuk fola për ndonjë kanun...

— Fole, s'fole, pak rëndësi ka. Ti mbase edhe nuk e kupton që, duke kërkuar besnikëri nga vajzat e fejuara në djep, kërkon bash atë që kërkojnë edhe kanunet... Si thoni ju, shoqe?.. — iu drejtua vajzave që rrinin mënjanë dhe përsërisnin me njëra-tjetrën, duke zhvilluar edhe ato një diskutim më vete, me zë të ulët, po jo më pak të rëndësishëm nga diskutimi i të rinjve.

Pyetja e Sadri Mehmetit i përmendi, po prapë nuk deshën t'i shprehnin mendimet me zë të lartë.

— Duhet të thoni edhe ju fjalën tuaj.

— Ne kot flasim — ndërhyri Drande Pilsa, pa luajtur nga vendi. — Të gjitha këto që themi është mirë t'i dëgjojë edhe Vuksan Ndreka, edhe i ati i tij. Dikush tha që t'i shkruajmë letër Marta Prendit, po a do të pranonte Vuksani të përulej?

— Fjalë me vend — e ndërpreu aksionisti, që mbante anën e djalit, një i ri me fytyrë të vogël e të stërpikur nga lia. — Edhe unë jam i sigurt që Vuksani nuk do ta ulte veten kaq shumë. Ne jemi malësorë dhe krenarinë e kemi në gjak.

Drandja vështroi djalin fytyrëvogël, që i qeshnin sytë e përhimtë e tinzarë dhe u mat mirë para se të fliste përsëri.

— Unë nuk desha të them ashtu — vazhdoi ajo me kujdes, që të mos e preknin fjalët e saj shokun që e kish përkrahur. — Krenaria dhe e drejta duhet të jenë në ujdi... — dhe e la fjalën përgjysmë.

Në sallën që shërbente për konferenca e koncerte, hyri Vuksan Ndreka me të atin.

— Aq më mirë — tha Sadri Mehmeti, duke vështruar nga hyrja dhe ja bëri me dorë Vuksanit, që nuk e vuri re. — Ne për ata bisedojmë... Edhe ata do ta kuptojnë që për të mirën e tyre e kemi. Ne i duam ata ndaj edhe merremi me të metat e tyre... Kështu ndodh gjithnjë në jetë. Nëna lan e pastron fëmijën kur bëhet pis dhe fëmija përtërihet. Mjeku viziton të sëmurin, e mjekon, e shëron dhe i sëmuri gjallërohet përsëri... Nënë e mjek ne kemi shoqërinë, jemi të gjithë për njëritjetrin.

— Po ka edhe fëmijë, që qajnë e lebetiten kur i lajnë, — tha aksionisti fytyrëvogël, që prapë deshi të kundërshtonte dhe i hyoi në kokë ta çelte përsëri bisedën atje ku e kishin lënë. Kur të vinte Vuksani ai deshi të ndodhej duke folur mirë për të.

— Ka edhe të sëmurë që gënjejnë mjekun, që fshehin sëmundjet e tyre ose që kanë më shumë frikë nga ilaçet, se sa nga shërimi.

— Po pse, pa?

— Jua them unë. Njerëzit akoma i mbrojnë të metat e tyre, ashtu siç mbronte pronari i dikurshëm pasurinë e vet. Kjo ndodh gjithnjë kur nuk e kemi të qartë qëllimin, kur nuk jemi të vendosur për rrugën që duhet ndjekur... Po ç'u

bënë ata? — dhe Sadriu u ngrit në majë të këmbëve, që të shihte gjithë sallën sipër kokave të aksionistëve.

Pjetër Ndreka ish ndalur në hyrje të sallës dhe vështronte rrotull.

Aksionistët, të mbledhur aty-këtu nëpër fronet e lëvizur nga vendi, zhurmonin e lëviznin pranë njeri-tjetrit dhe nuk u bënte përshtypje as shama-ta, as ngushtësia. Pjetrit, që vështronte, i mbështetur në krah të hyrjes, edhe pa hyrë në vorbullin shurdhonyesë të këngëve, të bisedave me zë të lartë, të të qeshurave pa fre, të lëvizjeve e të kërcimeve të asaj morie djemsh e vajzash, të veshur të gjithë me uniformë doku, i vinte mendja rrotull. Nuk i pëlqente të hynte edhe ai në atë rrëmujë gazmore. Përpara tij, kundruall hyrjes, një grup aksionistësh nga Labëria ja kishin marrë këngës për një pilot trim. Ai që ja kthente, e zgjatte dhe e dridhte aq bukur e aq me shpirt zërin, që dukej se dilte nga thellësi shekujsh e jo nga gjoks njeriu, sa që Pjetri, që nuk e dinte kush kish qenë ai pilot, e kuptoi se kënga ishte një vajtim i vërtetë trimash. Në këngë, jo në fjalë, po në zërin e këngëtorëve, bëheshin një dhimbja me krenarinë. Pak më tutje, një tjetër grup, edhe ai nga jugu, siç dukej, kërcente, duke përplasur këmbët fort në dysHEME dhe ja thoshte këngës:

*Një Azia, një Evropa...
Dy luanë ka sot bota:*

Këto fjalë i pëlqyen Pjetër Ndrekes dhe i përsëriti me vete, që t'i mbante mend, po nuk e ndoqi dot këngën, se mu aty pranë tij, në të djathtë, i përkëdhelën veshin dhe e gëzuan tingujt e çiftelisë. Një djalë i gjatë e hollak, me flokë të qethur si ushtar, mbështetur në murin e barakës, kish vënë këmbën e djathtë mbi fron dhe bërrylin mbi gju dhe, me kokën pakëz të mënjanuar, vështronte telat e çiftelisë dhe dorën që lëvizte mbi ta, gjersa erdhi çasti që ngriti kokën dhe shpërtheu këngën me një «ohej» të gjatë e të fortë.

Pjetër Ndreka u afrua pranë grupit të aksionistëve malësorë. Duke dëgjuar këngën, që fliste për një vajzë malësie, e cila kish lënë burrin plak e mjekërcjap që i kishin dhënë prindërit dhe punonte në kooperativën e porsangritur, i shungullonin në vesh ushtima malesh, gurgullima prozhmesh. Jehona legjendash të hershme që ai i kish dëgjuar kushedi sa herë.

— Aman, një rumba, — u dëgjua zëri i një gjimnazistes, që i lutej fisarmoniçistit, duke e tërhequr nga mënga e xhaketës, — një rumba, të keqen motra, se na mpive e na mërzite me këto tangot pleqërishte.

Pjetri ktheu kokën andej. Gjimnazistët kishin pushtuar fundin e barakës dhe kishin hequr fronat që i kishin hedhur sipër njëri-tjetrit pa kujdes në qoshen e sallës. Dhe nisi rumba. Djemtë rrëmbyen vajzat dhe vajzat rrëmbyen djemtë. Pjetrit iu errësuan sytë dhe bëri «shyqyr» me vete që nuk kish pranuar të dërgonte të bijën në hekurudhë. Në çast iu pështirën të gjitha: edhe kënga

labçe, edhe rapsodia e shoqëruar me çifteli, edhe ajo vallja e rëndë me «hopa», që kërcehej në anën tjetër të sallës, mu pranë skenës. Dhe, për çudi, tani sikur po kuptonte shumë gjëra njëherësh.

Iu kujtua i biri dhe e kërkoi me sy në rrëmujën gazmore të sallës. Ai kish qëndrur më këmbë pranë aksionistëve të brigadës së tij, që qenë mbledhur edhe ata në qoshen e rrjeshtave të parë.

Pjetri u ndie i braktisur dhe nuk i erdhi mirë që i biri qe larguar dhe e kish lënë vetëm atje, pranë hyrjes së barakës prej pupuliti. Deshi të ikte, ta linte këtë botë të hareshme rinie, që edhe e rrëmbente edhe e shtynte dhe e përplaste në skutat e mendimeve e të kujtimeve të tij. I kujtohej mosha e rinisë, dhinë, gështenjat, çiftelia, që kish tingëlluar gjithnjë e vetëmuar. Bota tani kish ndërruar. Koha kish gjëllitur bashkë me rininë e tij edhe atë vetëminë shekullore të kullave të malësisë. Tamam ashtu siç zbresin përrenjtë malesh, ashtu kishin zbritur në këtë barakë qindra djem e vajza malësore dhe shpërthenin e shamatonin, si një lumë i rrëmbyeshëm. Pjetrit i merreshin mendtë prej rrjedhjes së këtij lumi.

U mat edhe një herë tjetër të largohej, po nuk i bënë këmbët. Nuk deshi të tërhiqej i mundur, nuk deshi të pranonte që i biri e kish braktisur, i joshur nga gëzimi i moshës e i moshatarëve të vet. Ai ishte i ati; ai ishte më i rëndësishmi, kryesori. Edhe në qoftë se kish vajtuar atje, kish vajtur jo për të birin, që ta ngushullonte e ta qetësonte; po për veten e tij, për nderin e tij. Ai kish vajtur që t'i ndizte gjakun

Vuksanit, ta bënte për vete, ta çonte më këmbë që të mbronte nderin, t'i fuste në gjak helmin e zakoneve, që të bëhej i papërulur, të mbetej kryelartë, siç kish qenë ai vetë. Ditët e para ai kish folur shumë dhe kishte shumë shpresa. Vuksani e dëgjonte dhe nuk i përgjigjej; as i jepte të drejtë, as e kundërshtonte. Ai nuk e kish kundërshtuar kurrë, ndaj edhe shpresonte shumë Pjetër Ndreka. Jeta e kish mësuar të besonte se bindja e vërtetë vjen pas veprimit. Kështu qenë ruajtur zakonet në male; kështu kishin hyrë ato në gjakun e njerëzve. Po Vuksani nuk kish folur, as kur i qenë mbaruar fjalët plakut. Kish ditë që ata rrinin dy orë e tri pa folur. Secili mendonte më vete dhe, gjithnjë e më shpesh, mendimet i largonin prej njëri-tjetrit dhe prej hallit që i bashkonte. Pjetrit, kur përmendej, i vinte maraz dhe i bëhej një lëmsh në zemër. Kish inat me të birin, që, siç pandehte plakun, nuk i kish dhënë rëndësi fejesës së prishur.

Ai vështroi edhe një herë në krye të sallës. Vuksani qeshte me shokët. Atje kishte edhe vajza. Duhej të ishin malësore, po ai nuk i dallonte, se edhe ato kishin veshur uniformën e aksionistëve. Vetëm baluket u shquanin.

— Kushedi — mendoi, — mund të ketë gjetur ndonjë tjetër. Ka bërë mend të ndjekë rrugën e të vëllait... — dhe u mat të vente edhe ai atje tek ishte i biri, po prapë nuk vendosi dot. Kur të vente ai, askush nuk do të fliste më, askush nuk do të qeshte. Më parë i kish pëlqyer një gjë e tillë. Edhe ai, si gjithë prindërit e tjerë, kish lakmuar heshtjen, bindjen, nënsatrimin e fëmijëve. Para tij as mund të qeshte, as mund të fliste

njeri: as gruaja, as fëmijët. Tani e kuptonte se ky nuk kish qenë respekt, po nënshtrim. Ai kish vrarë gëzimin e fëmijëve të vet. Edhe po t'u afrohej akzionistëve, ata do të heshtnin, se do t'u rëndonte prania e tij, do t'ua shuante hovin e hareshëm të moshës. Ata vetëm një të keqe mund të prisnin prej tij. Dhe ai për të bërë një të keqe kish vajtur. Për këtë qe i bindur. Të keqes gjithnjë me të keq i qenë përgjegjur.

— Ata mbase qeshin me mua — u dëshpërua edhe më tepër ai. — Ai u rrëfen ç'kemi biseduar dhe ata qeshin. . .

Kërciti dhëmbët dhe vendosi përfundimisht të mos luante vendit. Tani i ngjante vetja si një gur varri, i mbuluar nga myshku, një gur varri i mënjanuar në një varr të shembur, që të ngjall vetëm trishtim. E si mund të ishte ndryshe? Si mund të ngjante ndryshe para botës gazmore të të rinjve? Ai kurrë nuk kish parë kaq zhurmë e kaq gëzim në jetën e vet.

I erdhi keq për veten. Ishte plakur. Pat qenë edhe ai njëherë i ri, po jeta qe treguar njerjë me të dhe ai kish luftuar me jetën. Që i ri ishte veçuar në kullën e vjetër buzë përroit dhe qe rropatur ta mbante më këmbë. Gjyshi i kish kallëzuar historinë e kullës së vjetër. Atë e kishin ngritur në atë vend aty e dyqind vjet të shkuara. Të parët e familjes së tij qenë shpërngulur nga fusha, që të shpëtonin nga mizoritë e turqve, me shpresë se do të ktheheshin shpejt në truallin e tyre. Po lufta zgjati shumë. Ata jo vetëm nuk u kthyen në fushë, po braktisën edhe fshatin, ku kishin hedhur themelet e një shtëpie të re, se edhe atje

i zunë turqit. Katragjyshi i Pjetrit, që paskish qenë burrë trim e mentar, siç e tregonin ata që e kishin njohur, kur u shpërngulën për herë të dytë, kish zgjedhur vendin buzë përroit dhe u kish thënë vëllezërve dhe bijve të tij:

— Deri këtu mbërritëm. Më tutje nuk kemi ku shkojmë. Po erdhën turqit edhe këtu, ose do të luftojmë e do të shuhemi në luftë, ose do të hidhemi, ja, këtu — dhe u kish treguar me dorë greminën. Dhe ata filluan prapë nga e para, veç kësaj radhe nuk ngritën shtëpi, po një kullë të lartë me frëngji të ngushta, atë që ishte akoma.

Nga të gjithë burrat e fisit të tij vetëm ai kish mbetur dhe kish mbledhur gjithë vrerin e shekujve. Malet, luftat, gjakmarrjet, drobitja në punë për të nxjerrë copën e bukës e kishin fortësuar dhe ashpërsuar karakterin dhe zemrën e tij. Edhe ai vetë donte të kish qenë i ri në këtë kohë. Mbase atëhere do të mendonte ndryshe. Edhe ai ndofta do të qe sjellë me të atin, ashtu siç sillej Vuksani me të.

— Mirë mbrëma, axha Pjetër! — e përshëndeti një vullnetar dhe i zgjati dorën.

Pjetri e vështroi heshtas. Ishte një djalë fytyrëmprehtë e i kuqërremtë, me flokë të verdhë të prerë shkurtër. Rrobat e aksionit i rrinin pas trupit dhe e tregonin të zhdërvjellët.

— Mirë mbrëma! — ja ktheu ai pa dëshirë dhe me një farë dyshimi, duke ndjekur tinëz lëvizjen e dorës së zgjatur të djalit, që ra posht e ndrojtur.

Pjetri shikoi nga i biri, po ai vazhdonte bisedën me shokët dhe qeshte. Nuk e kish mendjen tek i ati.

— Mora vesh që kishit ardhur dhe desha t'ju takoj — i tha aksionisti me përzemërsi e me gëzim.

— I kujt je ti? — e pyeti plaku dhe e vështroi me vëmendje që ta shembëllente. Dy sy si të atij, të vegjël, të ndritshëm, të lëvizshëm e tinzarë kish parë edhe herë tjetër, po se ku, nuk i kujtohej.

— Babën tim ju nuk e njihni — i tha djali.
— Mua më thonë Sadri Mehmeti... Punoj bashkë me Vuksanin...

— Ashtu? — tha mendueshëm Pjetër Ndreka dhe e shikoi edhe një herë aksionistin me vëmendje.

— Erdha t'ju ftoj të vini në brigadën tonë. Të gjithë duan të njihen me ju... Se, të themi të drejtën, nuk na vjen mirë që keni disa ditë në Lushnjë dhe nuk ju kemi takuar akoma...

— Nuk jam në moshën tuaj dhe as jua kam ngenë — e kundërshtoi hapur e pa qëllim Pjetri.
— Unë kam ardhur të bisedoj me tim bir, nuk kam ardhur të bëj miq.

— Këtë e dimë — tha Sadri Mehmeti dhe vendosi aty për aty që t'i hapej plotësisht. — Vuksanin e ka lënë e fejuara dhe ju keni ardhur t'i mbushni mendjen që të hakmerret për të vënë nderin e familjes në vend...

— Si tepër po i jep gjuhës! — iu hakërrye Pjetër Ndreka dhe tendosi trupin kërcënonjë. Fytyra iu errësua, sytë iu egërsuan.

Sadriu i qëndroi përballë dhe buzëqeshi.

Plaku nuk e priste, që pas fjalëve që i kish thënë, ai të buzëqeshte dhe i erdhi inat.

— Edhe unë kam pasur të njëjtin hall...

Po a e dini ç'më tha baba? — gënjeu ai. — Kur e mori vesh se qe prishur krushqia, më thirri e më tha: — Mos u mërzit, bir. Ti nuk je ndonjë djalë i humbur. Një tjetër nuse ke për të gjetur, ashtu si të ta dojë zemra. Unë atë prisja. Të fejuarën as e njihja, as e kisha parë. E pse duhej të më merrte ajo mua dhe unë atë? Apo e kam keq?

Pjetër Ndreka u mendua para se të fliste. Si gjithë malësorët e moshës së tij, edhe ai i jepte rëndësi fjalës që do të thoshte.

— Djalë i zgjuar po më dukesh — i tha, pa iu përgjegjur pyetjes, — veç nuk e di në do të jesh vërtetë aq i mirë, sa tregohesh...

— Mos pandehni se ju gënjeva? — ndërhyri Sadriu dhe gjeti rastin e volitshëm t'i hidhte kra-hun plakut.

Pjetri e shikoi dhe qeshi.

— Ajo s'ka rëndësi — i tha dhe e kapi nga flokët e i mbështeti kokën në gjoksin e vet. — Fjalët e tua qenë fjalë të mençura. Nuk ka rëndësi në është e vërtetë apo e trilluar historia që tregove.

Pastaj, vazhdoi mendueshëm, duke u larguar disa hapa prej Sadriut, që ta shihte më mirë:

— Unë u bëra kaq dhe nuk më kish vajtur kurrë në mendje, se, duke shitur e blerë gratë, ne ulim edhe veten tonë. Këtë e mësova sonte...

— Do të vini të takoheni me brigadën? — e pyeti me entuziazëm të papërmbajtur Sadriu. — Ata duan të njihen së afërmi me ju...

— Atje në qoshe janë? — pyeti Pjetër Ndreka

dhe tregoi me gisht grupin e vullnetarëve, ku ndodhej edhe i biri.

— Po, ata janë.

Pjetri ishte nisur pa thënë fjalët e fundit Sadri Mehmeti. Ai kalonte ngadalë ndërmjet vullnetarëve, duke u rënë me dorë supeve, që t'i hapnin rrugën. Të rinjtë kthenin kokën dhe e shikonin me kureshtje. Ai ecte përpara dhe buzëqeshte. I dukej se po kthehej edhe një herë në moshën e rinisë, siç mund të qe kthyer vetëm në ëndërr. Dhe ishte i lehtë, vështronte përpara dhe mendonte ç'histori gazmore do t'u rrëfente të rinjve që të mos bëhej i mërzitshëm.

KAPITULLI I GJASHTË

Dita ishte e gjatë, e mërzitshme, me shi. Pjetër Ndreka kish mbetur vetëm. Vullnetarët e brigadës «Heronjtë e Vigut», ku bënte pjesë edhe i biri, kishin shkuar në punë para agimit dhe nuk qenë kthyer akoma. Edhe drekë nuk kishin ngrënë. Në sallën e madhe të mensës tryezat e tyre kishin mbetur të shtruara. Gjella qe ftohur.

Ai qe mërzitur shumë; edhe qe lodhur; gjithë paraditen kish bredhur rrugëve të Lushnjës, kish hyrë dyqan më dyqan, e kish qëndruar vitrinë më vitrinë. Vetëm shihte. Mendimet, që i vërtiteshin në kokë, qenë aq të shpejta, aq të lehta e pa rëndësi, sa i dukej se nuk mendonte fare. E kish harruar veten. Egzistonte vetëm bota jashtë tij me të cilën e lidhnin vetëm sytë. Sytë dhe asgjë tjetër. Pas aq ditë bisedash me të birin dhe, sidomos, pas afrimit me vullnetarët, ai kish ndërruar shumë, kish parë një tjetër jetë, qe ndeshur me një mënyrë tjetër të menduari. Në fshat ai më tepër fliste me vetëveten; fliste me vetëveten kur rregullonte gjerdhet, kur kujdesej për dhitë; me vetëveten fliste dhe kur ulej buzë përroit dhe vështronte mendueshëm kullën e vjetër, që kish nevojë të meremetohej e të mëkëmbej, po djemtë nuk donin. Atyre u qe mbushur mendja ta shembnin

kullën dhe me gurët e saj të ngrinin muret e një shtëpie të re pranë shtëpive të tjera, që do të ndërtonin fshatarët. Ata nuk e donin kullën; ata nuk e kuptonin gjuhën e atyre mureve të vjetra të trasha e të larta, gjuhën si vërshëllimë plumbi të frëngjive të ngushta, prandaj dhe nuk i donin, i urrenin. «Ka ndërruar koha, bablok, i thoshnin, s'na duhen më kullat; do të ngremë shtëpi të re pranë njerëzve». Ai steronte. I vinte inat; i vinte edhe keq. Ulej buzë përroit dhe fliste me vete, kuvendonte me kullën. Edhe moshatarëve të vet nuk ua hapte zemrën. I vinte turp. Burrat e maleve nuk janë qarë kurrë. Edhe kur e kanë shtruar çështjen në kuvend, prapë ata kanë qenë që i kanë dalë zot vetes. Kuvendi vendoste. Ata qenë që vepronin. E si do të qajej ai tani për fëmijët e vet, që donin të shembnin kullën dhe për të fejuarën e të birit, që kish prishur krushqinë? Këdo që të pyeste nga moshatarët e vet, do t'i thoshte: «Turp, Pjetër Ndreka, turp! A nuk je ti kreu i shtëpisë?»

Një gjë e tillë nuk ndodhte vetëm tani. Kështu kish ndodhur gjithnjë. Edhe më parë, malësori nuk vente me aq dëshirë, sa ç'kujtojnë, në kuvend. Ai mendonte shumë, fliste me vetëveten, që e kishte edhe shok, i bënte mirë llogaritë, numëronte me gisht burrat e kuvendit, parashihte të mirën e të keqen dhe pastaj hidhte hapin. Dhe kur vinte puna të pushka, prapë nisnin bisedat me vetëveten. Kësaj radhe ato qenë biseda më të gjata, më nervoze, më tronditëse.

Tani shumë gjëra kishin ndërruar, po kuvendi i përhershëm i pleqve me vetëveten kish mbetur si një muzikë e shurdhët, si një jehonë e mbytur

e kohës së kaluar, si një zë i thellë e i zvarrisur, që e dëgjonin vetëm ata. Njeriu, u thoshte shpesh prifti, lind vetëm dhe vdes vetëm. Dhe ata e kishin besuar priftin, se vetë jeta i provonte fjalët e tij. Kurse tani... Tani njeriu kërkon njerinë. Prandaj janë edhe më të hedhur, edhe më të gëzuar të rinjtë, prandaj i urrejnë kullat e veçuara dhe mendojnë ndryshe. Ndërsa pleqtë lidhen me të vjetrën e me kujtimet, të rinjtë shohin përpara, mendojnë të bëjnë diçka të re. Dhe nuk mendojnë keq, nuk punojnë keq.

Pjetër Ndreka u ndesh me mendimet dhe me gëzimet e tyre vetëm atje, në hekurudhë. Nuk ishte vetëm moshë. Edhe ai vetë kish qenë i ri dhe e kujtonte për bukuri djalërinë e vet. Kulla, dhitë, çiftelia dhe pushka... E përse duhej të mendonte tjetër? Kurse djali i tij, shokët e të birit, gjithë të rinjtë janë ndryshe, mendojnë ndryshe. Ai nuk kish pyetur ndonjëherë për mendimet e tyre; as për punën e tyre nuk kish pyetur. Edhe këtu, në hekurudhë, i kish parë me dyshim e me armiqësi. Nuk i kish pëlqyer zhurma. Nuk i shihte dot vajzat e veshura me pantallona doku, që qeshnin e bisedonin me çunat, sikur i kishin vëllezër të një barku. Nga gjithë puna në hekurudhë vetëm stërvitja ushtarake i kish pëlqyer që në fillim. I shihte me zili vullnetarët me pushkë automatike, që mësonin të gjuanin në shenjë. Dukeshin pushkë të bukura e të mira. Mbanin dhjetë fishekë. Kurse ai kish mbetur me atë pushkën e vjetër serbe të trashëguar nga luftat e përparme.

Armiqësia dhe dyshimet u zbutën pak nga pak e vetvetiu. Vështirë e pati vetëm në fillim, kur

vrinte ende ndër dej, që po e pajtonte me të rinjtë dhe e afronte me ta.

Ora po vente gjashtë e mbrëmjes. Vullnetarët e brigadës «Herojt e Vigut» nuk po dukeshin akoma. Ai u mërzi. Edhe përgjegjësi i rojeve të sektorit, një djalë i shkurtër me flokë kokorithka të zez e fjalaman, sikur nuk po ja varte më. E kish mbajtur me fjalë dy orë. Tani, siç dukej, që mërzi-tur edhe ai dhe seç i thoshte mënjanë e me zë të ulët një vajze të gjatë e të hollë, me fytyrë pikalloshe.

Pjetri e pa që ishte i tepërt në atë bisedë dhe u largua. I erdhi rrotull barakave të sektorit. Në baraka kishin hyrë vullnetarët. Ata rrinin ndënjur në shtretërit e gjerë dhe bisedonin me zë të lartë, i binin njëri-tjetrit me jastëkë, ndërroheshin, kriheshin. . . Ai i shihte nga dritaret dhe kalonte pranë tyre me mendjen tek i biri, që nuk po kthehej akoma. Nuk kishte merak, se ishte bashkë me shokët, po qejfi nuk ja kish të rrinte vetëm e të vinte rrotull sektorit, si një i huaj, që nuk e lenë të hyjë brenda.

Brigadës i kish ndodhur një fatkeqësi e papritur. Nga shirat që kishin rënë ditët e fundit, kodrinat e buta qenë gërryer dhe që shembur dheu mbi trase. Dëm në njerëz nuk kish pasur, po grumbujt e dheut kishin mbuluar shumë vegla pune dhe gozhupe që vullnetarët i kishin lënë rrëzë kodrinës. Në fillim gjithkush kërkonte plaçkat e veta, duke larguar dheun me lopata, po se kush tha dy fjalë dhe puna ndërroi krejt.

— Ne nuk duhet të largohemi nga traseja, pa pastruar gjithë dheun e shembur. . .

— Ç'punë kemi ne me dheun e shembur?

— Ne e realizuam normën!

— E tejkaluam!

— Si mund të flasim për realizim, kur punëtonë e mbuloi balta? Ne punuam mirë, po një pjesë e punës na vate kot. Nuk është mirë të mendojmë se e kemi kryer detyrën e ditës, pa pas-truar sektorin e punës.

— Unë jam dakord, po me një kusht.

— Ç'kusht?

— Të na shënohet në normë edhe heqja e dheut.

— Edhe unë ashtu them.

Pak nga pak pranë dheut të shembur që mbledhur gjithë brigada dhe po zhvillohej një diskutim i gjallë e i vetëvetëshëm. Vullnetarët, të lodhur e të përbaltur, flisnin pa radhë, të gjithë menjëherë. Shumica këmbenin mendim me njëri-tjetrit, kurse disa, që u jepnin më tepër rëndësi fjalëve të tyre, e ngrinin zërin lart dhe bërtisnin. Fjalët e tyre ndesheshin me njëra-tjetrën në ajrin e lagësht dhe shkaktonin një zhurmë nga e cila mezi mund të kapje fillin e mendimeve, që shpreheshin.

Komandanti i brigadës, pasi u mundua kot të vinte rregull e të mbante qetësi, tundi duart në ajër dhe u ngjit mbi grumbullin e dheut që të tërhiqte vëmendjen e të rinjve, po dheu rrëshqiti. Ai, pa pasur ku të mbahej, ra në kurriz dhe shkau bashkë me dheun të këmbët e vullnetarëve. Brigada heshti disa sekonda. Vullnetarët u afruan edhe më tepër që të shihnin ç'kish ndodhur. Kur panë që ai u ngrit, shpërthyen të qeshurat dhe komentet me zë të lartë.

Komandanti shkundi rrobat dhe, që ta kalonte

në heshtje atë që ndodhi, pyeti vullnetarët, duke bërëtitur me sa fuqi pati:

— E, shokë, si thoni?

Turma heshti. Aty për aty nuk e kuptuan pyetjen. Një pjesë e mirë as e kish dëgjuar.

— Do ta heqim dheun e shembur?

— Të na shënohet në normë!

— Ta heqin teknikët, që nuk marrin masa me kohë për ngritjen e armaturave!

Prapë filluan diskutimet me zhurmë. Komandanti i brigadës u detyrua të mblidhte shtabin. U tërhoqën mënjanë dhe morën në shqyrtim propozimin që ish bërë. Flisnin më këmbë dhe vështrojnë nga vullnetarët, që po kërkonin plaçkat e mbuluara në baltë. Sa gjendej diçka, shpërthenin britma gazmore dhe të qeshura. Shtabi vendosi të hiqej gjithë dheun i shembur dhe puna që do të kryhej të mos llogaritej në normë.

— Nuk punojmë për lavdi... Ne jemi të bindur që kjo punë duhet kryer dhe do ta kryejmë...

Diskusimet u ndërprejnë. Kompanitë dhe skuadrat vanë në sektorët e tyre të punës. Kur e morën vesh këtë vendim në shtabin e hekurudhës, dërguan lajm që brigada të kthehej në sektor, se nuk lejohej të punonin më tepër se tetë orë. Po ky kundërshtim i shtabit e bëri edhe më të ndërgjegjshëm vendimin e vullnetarëve; edhe lodhjen sikur e mposhti.

Kur u kthye Pjetër Ndreka te postbloku i sektorit dhe u mat të pyeste përgjegjësin e rojeve, që larg u duk vargu i gjatë vullnetarëve të brigadës, që po kthehej nga traseja me veglat e punës hedhur supave, me fytyra të nxira nga lodhja, me çizme

e me pantallona gjithë baltë. Ata kalonin në heshtje, të lodhur e të uritur, po krenarë për detyrën që kishin kryer.

— Në orën tetë ka mbledhje në sallën e kulturës — u thoshtë përgjegjësi i rojeve vullnetarëve, që hynin njëri pas tjetrit në oborrin e sektorit.

Pjetër Ndreka takoi të birin.

Vuksani i rrëfeu ç'u kish ndodhur dhe e mori me vete.

— Eja edhe ti në mbledhje — i tha. — S'ke ku rri vetëm.

Plaku nuk e kundërshtoi. Kur mbaroi darka, ai hyri bashkë me të birin në sallën e madhe dhe u ul pranë tij. Flitej se do të jepej një lajm me rëndësi, po se ç'ishte ky lajm, askush nuk e dinte. Flisnin kuturu, me hamendje. Pjetri i dëgjonte pa kthyer kokën. I vinte edhe inat me ata që hiqeshin sikur merrnin me mend gjithshka.

Perdja e skenës ishte çelur dhe skena ishte bosh, po të gjithë atje vështronin e jo në altoparlantët me membranë, që ishin vënë anëve të sallës.

Komandantja e sektorit, që vinte e vinte para rreshtit të parë, qëndroi për një çast, dhe vështroi sallën. Ishte e menduar. Aksionistët pritën që ajo t'iu thoshte diçka. Ajo e kuptonte interesimin dhe kurreshtjen e tyre.

Kujdestari i ditës mbylli portën e barakës dhe i bëri shenjë me duar, se të gjithë vullnetarët e dy turneve ishin në sallë.

Vajza nxori duart nga xhepet e pantallonave, u kthye nga aksionistët dhe, sado që foli me zë të

ulët e të zvargur, fjalët e saj u dëgjuan kthjellët.

— Pardje — tha ajo, — në sektorin e Dushkut, ra në krye të detyrës aksionistja pesëmbëdhjetëvjeçare e brigadës «Mehmet Shpendi» Shkurte Pal Vata!...

— Mos! — u hodh Pjetër Ndreka dhe iu kujtua malësori i gjatë e thatim, me të cilin kish ardhur nga Rrogozhina në Lushnjë. — E njoha të atin e saj — i pëshpëriti të birit.

— Kur? — pyeti Vuksani, po plaku i ra me bërryl dhe dëgjonte me vëmendje fjalët e vajzës së veshur me uniformën e aksionistit.

Komandantja përsëriste pothuajse të njëjtat gjëra, që Pjetri i kish dëgjuar disa ditë më parë prej sekretarit të partisë së hekurudhës dhe, për këtë arsye, i dëgjonte edhe më me interes, si diçka që kish të bënte jo vetëm me të tjerët, po edhe me atë vetë, si një fakt me rëndësi të jetës së tij.

— Edhe në çastet e fundit — vazhdonte vajza, — pas disa operimeve të rënda, kur dhimbjet çenë bërë të padurueshme dhe vdekja i qëndronte fare pranë, Shkurte Vata, kur pa të atin që ishte për-lotur, e qortoi si burrneshë! Ajo i tha:

— Babë, nuk të kanë hije lotët... Shkurta, edhe në qoftë se vdes, dije se nuk të ka koritë. Mbahu si burrat dhe, kur të kthehesh në fshat, bëj gjithnjë ashtu siç thotë Partia dhe Enveri ynë...

Kështu vdiq, si trimat, cuca malësore. Ajo...

Komandantja deshi të fliste edhe më me sy të për-lotur e me zë të ngashëryer, duke lexuar dhimbjen dhe krenarinë në sytë e të gjithë aksionistëve,

po që nga altoparlanti u dëgjua një zë i njohur, që tha edhe këtë herë fjalët e zakonta: *Ju flet Tirana. Po japim lajmet.*

Kësaj radhe askujt nuk i dukën të zakonta këto fjalë. Ato fshihnin prapa qetësisë dhe veshjes së zakonit të tyre lajmin e rëndësishëm që aksionistët prisnin, ndaj edhe tingëlluan ndryshe nga çdo herë tjetër. Së paku ashtu i duk atyre se tingëlluan.

— Shoku Enver Hoxha — vazhdoi spikerja e Radio Tiranës — i dërgoi këtë letër malësorit Pal Vata, të atit të aksionistes Shkurte Vata, që ra për ndërtimin e hekurudhës Rrogzhinë-Fier.

— I dashur shoku Pal!

Pjetri nuk di pse u drodh nga këto fjalë dhe vështroi të birin. Vuksani dëgjonte si gjithë të tjerët. Plakut fytyra e të birit iu duk më e hequr, më e zeshkët dhe më burrërore. Ai nuk ishte më femijë.

Në këto ditë të mëdha hovi revolucionar që po kalon vendi ynë për ndërtimin e jetës së re socialiste, vargut të madh të mijëra dëshmorëve të lavdishëm të luftës dhe të punës iu shtua edhe emri i bijës suaj Shkurta, malësore revolucionare, anëtares së organizatës së BRPSH, bijës së paharruar të popullit shqiptar.

Megjithëse e vogël nga mosha, pse të pesëmbëdhjetat sapo i kishte mbushur, por tepër e madhe, e pjekur, e zgjuar dhe e vendosur nga vepra, si një bijë e denjë e një familjeje patriote, bijë e popullit të malësive tona kreshnike, që kanë qëndruar kryelartë e të papërkulur kundër çdo armiku e rrebeshi, me aktin e saj heroik e trimëror, Shkurta dha

një shembull të lartë patriotizmi, trimërie e dashurie të pakufishme për Atdheun, Partinë dhe popullin e vet. Akti i saj do të frymëzojë rininë heroike dhe gjithë punonjësit e vendit tonë se si duhet të punohet e të luftohet për socializëm, si duhet të mposhten pa u përkulur çdo vështirësi e pengesë, zakonet prapanike, feja e kanunet poshtëronjëse ndaj femrës shqiptare.

Pjetër Ndreka vështroi përsëri të birin me bisht të syrit. Vuksani e ndjeu vështrimin e të atit, po nuk i dha të kuptonte. Vetëm muskujt e fytyrës i lëvizën vetëvetiu. Ai e merrte me mend ç'donte të thoshte plaku me atë vështrim. Fjalët e fundit e kishin sëmbar në zemër. Ato ushtuan si një thirrje tjetër e fuqishme, që dilte nga gjiri i tokës, si një ushtimë e brigjeve dhe e maleve, që e shtynte Pjetër Ndreken e këdo tjetër të hidheshin përpara.

— Prandaj — vazhdoi zëri i spikerës — kujtimi i saj do të mbetet i paharruar dhe do të nderohet kurdoherë me respektin më të madh nga të gjithë.

Ju më njoftuat në letër, i nderuari shoku Pal, se çikën nuk e qatë, pse ashtu, siç i ka hije shqiptarit, trimëreshat nuk qahen dhe, së bashku me mbesën, vendosët dhe shkuat në hekurudhë në vend të saj për ta zëvendësuar. Ky është një tjetër shembull patriotizmi të lartë socialist që jepni ju, një akt tjetër i madh atdhedashurie e besnikërie ndaj Partisë, popullit dhe Atdheut, është një përtëritje në një shkallë më të lartë e traditës patriotike të familjes suaj, gjyshit, axhës e babës suaj, që derdhën gjakun duke luftuar kundër pushtuesve turq, malazez e regjimit satrap të Zogut. Duke mposhtur

dhimbjen e thellë që ju shkaktoi humbja e vajzës së dashur, Shkurtës, në pranverën e jetës së saj, ju vutë mbi të gjitha interesin e përgjithshëm mbi atë personal e të familjes dhe, megjithëse i shkuar në moshë, u drejtua në hekurudhë, që ajo të ndërtohet në kohën e duhur për të mirën e gjithë popullit, për lulëzimin e forcimin e Atdheut.

Partia krenohet me bij dhe bija të tilla të dala nga gjiri i popullit tonë, i malësorëve trima e të papërkulur, që me burrinë, mençurinë, besnikërinë dhe frymën e lartë të sakrificës dhe me heroizmin në luftë e në punë, pa u thyer përpara asnjë vështirësie, zbatojnë në jetë me një vendosmëri të admirueshme mësimet jetëdhënëse të partisë në zhvillimin më të lartë të traditave të lavdishme të të parëve tanë.

Populli ynë nuk do t'i harrojë kurrë, dhe rapso-dës gojëartë e poetët tanë të talentuar do t'u këndojnë brez pas brezi dhe do të përjetësojnë në shekuj emrat e bijave dhe të bijve të këtij trualli, që nuk kursejnë as gjënë më të shtrenjtë për lirinë e pavarësinë e Atdheut, për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit.

Ju uroj shëndet e punë të mbarë në hekurudhë e në fshatin tuaj malor, dhe familjes suaj patriotë gjithë të mirat. Zëmra juaj bujare paskëtaj qoftë kurdoherë e gëzuar dhe e lumtur në Atdheun tonë të lirë socialist, për të cilin bija juaj Shkurta dha gjënë më të shtrenjtë, jetën e saj të re.

I Juaji
Enver Hoxha

Disa sekonda, salla vazhdoi të heshtë. Askush nuk lëvizi nga vendi. Kish vajza që akoma fshinin lotët, duke menduar për pesëmbëdhjetëvjeçaren e vdekur, që kish punuar aty pranë tyre dhe ato nuk e kishin njohur. Ajo kish qenë një vajzë trupvogël dhe e zbetë, e urtë dhe e heshtur, që punonte pa u ndier, ashtu siç kish jetuar pa u ndier, si mijëra vullnetare moshatare të saj, po që kish pasur guximin të shkelte zakone e kanune të vjetra dhe të ëndërronte për ditë të ra. Ajo kish qenë e thjeshtë, e pastër e zemërzjarrtë, si vetë mosha e rinisë, si vetë ato aksionistet, që fshinin lotët, duke menduar atë, malësoren e vogël, që kish hyrë e qe përzier në mendimet, ëndrrat dhe kujtimet e tyre në mënyrë të vetvetishme e të thjeshtë.

Lotët e vajzave dhe heshtjen e sallës i trembi një thirrje e fuqishme, që shpërtheu papritur, e vetëmuar, po rrëmbenjese nga mesi i aksionistëve. Një djalë u çua më këmbë dhe thirri i pari:

— Parti, Enver, jemi gati kurdoher'! — dhe, pas tij, qindra të tjerë u ngritën dhe thirrja ushtoi shumë më e fortë. Baraka gjëmonte.

— E ka bërë si burrat! — pëshpëriti Pjetër Ndreka, i prekur e i entuziazmuar. Ai përplaste duart me ritmin e të rinjve.

— Për kë e ke fjalën? — pyeti Vuksani.

— Për atë, Pal Vatën... Ashtu duhej... si në luftime... Vendi nuk lihet kurrë bosh e pushka shkretë... Veç diçka ai po e bën i pari. Gjer tani i ka zënë vendin burri burrit e djali babës, po vendin e së bijës ta zëjë i ati, kjo tani po ndodh...

Vuksani rrudhi vetullat dhe sa nuk i foli të

atit me qortim. Fjalët i mbetën në buzë, se plaku ndoqi mendimin e vet:

— Veç kanë ndërruar kohët... A e dëgjove si thoshte Enveri për të? Paska qenë trimëreshë ajo vajzë, ani se nuk ishte burrë. Vajzave të tilla u pinë dollinë... Mirë boll ka bërë Pal Vata! Edhe unë po të kisha qenë...

— Baba! — u rrëmbye në çast Vuksani dhe i doli të atit përpara, duke folur me zë të lartë, që ta dëgjonin edhe të tjerët e t'i mbanin anën. — A nuk do të kish qenë mirë të qëndroje edhe ti në hekurudhë këtë muaj?

Pjetri vështroi të birin me habi dhe duart u ndalën vetëvetiu në ajër e u lëshuan poshtë pa fuqi. Edhe ata që ndodhën pranë dhe dëgjuan fjalët e Vuksanit nuk duartrokisnin më; ata vështronin Pjetër Ndrekën që kish ndërruar në fytyrë. Sytë e tij u bënë të paqëndrueshëm, lëviznin shpejt nga njëri te tjetri dhe herë përshkënditeshin herë mje-gulloheshin e ftoheshin. Zor ta merrje vesh ç'mendonte ai në ato çaste i shoqëruar nga thirrjet dhe duartrokitjet ritmike të vullnetarëve, që dukej se shoqëronin mendimet e tij dhe përshëndesnin përtëritjen në zemrën e plakut.

— Pa frikë do të kisha qëndruar, po nuk e sheh se jam thinjë krejt? Pastaj, atje në fshat...

— Ani se je plak! Ti je i fortë... Edhe Pal Vata plak është, — u hodh prapa krahëve të Pjetrit Sadri Mehmeti. — Edhe në brigadat e tjera ka pleq e plaka... Nuk i ke parë?

— Si thua, babë?

— Po më duket çudi, — u hutua edhe më fort

Pjetër Ndreka, pa vendosur si të bënte. — Ju jeni kërthinj, — nënqeshi ai dhe vështroi shkaras djath-tas e majtas mos i kish fyer aksionistët me fjalët që kish thënë.

— Keni për t'u mësuar shpejt, — e nxiste Sadriu i padurueshëm e ngacmimtar. — Nuk të lemë ne të lodhesh.

— Këtë fjalë nuk e duroj — u vrënjt dhe u krekos plaku. — Sa për punë mos t'ju hajë fort meraku.

— Domethënë vendosët?

— Për çfarë?

— Që të qëndroni me ne.

Plaku ngurronte; ai kish ardhur për tjetër punë. Kish ardhur të hakmerrej kundër një vajze, kurse tani një tjetër vajzë po bëhej shkak që të ndërronte mendje e qëllim.

Vuksani e vështronte drejt në sy. Edhe Pjetri e shikoi të birin për një çast në sy dhe, kur ndeshi në vështrimin gjithë gaz e shpresë të të birit, u bind edhe më shumë që ai i takonte një tjetër bote, një tjetër jete. Vërtet kish ardhur koha që prindi të shkelte në gjurmët e bijve të tij. U hodhi duart në supe dy aksionistëve që kish pranë dhe tha me zë të plotë:

— Mirë, pra. Do të qëndroj një muaj bashkë me ju! U bëftë dëshira e rinisë!..

— Urra! — thirri Sadriu dhe, papritur ta ndiqnin të tjerët, hypi mbi fron dhe u kthye nga aksionistët, duke ngritur dorën e djathtë përperjetë.

— Shokë! Brigadës sonë iu shtua edhe një vullnetar i ri. Nën shembullin e Pal Vatës dhe duke iu

përgjegjur në çast letrës së shokut Enver, plaku gjashtëdhjetëvjeçar, Pjetër Ndreka, që ndodhet midis nesh, vendosi të regjistrohet vullnetar për ndërtimin e hekurudhës Brogozhinë-Fier...

— Urra!..

Pjetri u hutua fare. Gjithë ato britma i dukej se i drejtoheshin një tjetër njeriu e jo atij. Edhe vendimin një tjetër sikur e kish marrë. Emri i tij, kur e shqiptoi Sadri Mehmeti, iu duk i çuditshëm. Ai nuk e kish dëgjuar asnjëherë të përmendej me zë aq të lartë dhe me aq bujë e brohori.

Komandantja e sektorit iu afrua grupit të mälësorëve dhe, duke u ngritur me majat e gishtërinjve të këmbës, përqafoi Pjetër Ndreken që e rrethuan menjëherë dhjetëra djem e vajza; ata i zgjatnin duart, i buzëqeshnin, i thoshin ndonjë fjalë, po ai, megjithëse buzëqeshte, fjalët e tyre nuk i dëgjonte. Edhe fytyrat e tyre thuajse nuk i shihte.

— Na jep një pusullë për priftin — i tha përgjegjëses së sektorit komandanti i brigadës.

Pjetri hapi sytë dhe vështroi djaloshin që kish folur, po ai ja shoi kureshtjen aty për aty:

— Mos u habit, axhë. Prift ne i themi një magazinieri. Ai vërtet ka qenë prift dhe nga ata me mjekër të gjatë, bile, po tani e ka rruar mjekrën dhe punon në magazinën e sektorit tonë. Do ta njihni së shpejti, kur të vemi të marrim rrobat dhe veglat e punës. Është shakatar...

— Tani duhej të isha i ri, — psherëtiu Pjetër Ndreka, duke dalë mendueshëm nga salla. — Një tjetër jetë është kjo. Të tjerë njerëz po rriten... Ne kot mburremi. Këta janë trima dhe dinë se ç'bëjnë, se partia nuk i lëshuaka doret... Po —

hoqi me gjithë zemër dhe ndoqi pas komandatin e brigadës, që e shpinte në magazinat e sektorit.

Vuksani u gëzua shumë nga kjo kthesë e të atit. Ata do të ktheheshin së bashku në fshat, me shallët e aksionistit të lidhura në qafë; do të ktheheshin fitimtarë e të nderuar, jo kokulur, siç pat menduar më kot ai, kur mori lajmin e prishjes së krushqisë.

Ai qëndroi te porta e barakës dhe vërente figurën e të atit, që ndiqte komandantin e brigadës. U mundua ta përfytyronte të veshur me rrobat e vullnetarit dhe nënqeshi.

KAPITULLI I SHTATË

Gazetat kishin ditë që botonin lajme, korrespondenca, artikuj dhe fotografi për Shkurtë Vatën, për familjen e saj dhe për jehonën që pati në të katër anët e vendit akti i saj dhe letrat që këmbyen shoku Enver me Pal Vatën. Disa ditë pas njoftimeve të para, në krye të gazetave, u botua me gërma të mëdha vendimi i posaçëm i Komitetit Qëndror të partisë për pranimin e Shkurte Vatës në parti, pas vdekjes. Portreti i saj, i vizatuar sipas fotografive, po mernte gjithnjë e më tepër format e përgjithësuara të një simboli, të një embleme të aksioneve revolucionare të rinisë. Për të diskutonin në mbledhjet e organizatave të Bashkimit të Rinisë, bisedonin në familje dhe sidomos në autobuset e linjave të largëta, që vinin nga jugu dhe kalonin pranë vendit, ku qe ngritur një lapidar i thjeshtë, i mbuluar me kurora. Nga qytete e fshatra të largëta turma të mëdha djemsh e vajzash marshonin ditë e net më këmbë që të venin në vendin, ku kish rënë shoqja e tyre e rinisë.

Gjithë ç'ndodhte në ato ditë i ngjante një poeme të madhe heroike, një kënge të fuqishme revolucionare, që shpërthente njëherësh nga mijëra

gjokse. Para lapidarit, udhëheqës të organizatave të partisë u dorëzonin të rinjve tesrat e anëtarit të Bashkimit të Rinisë. Ato tesra të kuqe shëmbëllenin si lulëkuqe rrotull lapidarit. Drejt tyre zgjateshin duart e të rinjve. Ata i merrnin të ngashëryer dhe i hapnin aty për aty, që të shihnin në faqen e parë të tesrave emrin e tyre të shkruar me bojë nga një i panjohur. Ata emra, të shënuar në fletët e tesrave, i shtoheshin listës së gjatë të luftëtarëve të rinj, të heroizmave të reja. Oh, ndjenja të pastërta dhe mendime të kthjellta të rinisë së parë! Kush ju ka provuar dhe ju ka harruar? Kush nuk e kujton çastin e lumtur, kur e ka thirrur në fshehtësi sekretari i organizatës dhe e ka njoftuar se është pranuar në Rininë Komuniste? Ç'gëzim kemi ndier atëherë! Ç'krenari! Janë kujtime që nuk mund të harrohen. Janë ndjenja që nuk shuhen kurrë. As këta të rinj, që vinë nga ana e anës dhe zgjatin duart për të marrë tesrën e kuqe të rinisë, as kur të plaken, nuk do ta harrojnë këtë ditë, do ta kujtojnë gjithnjë me ngashëri këtë çast dhe gjithë jetën do t'i qëndrojnë besnik e do të përpiqen që emrat e tyre të mos hiqen kurrë nga lista e madhe e luftëtarëve të komunizmit, po të lexohen në çdo apel, të llogariten për çdo betejë e çdo heroizëm. E ç'janë vështirësitë e pengesat para kësaj ndjenjë të madhe e të lartë? Ç'janë lodhja e mundimet?

Në brigadat e vullnetarëve lexoheshin çdo ditë lajmet, korrespondencat dhe artikujt e gazetave. Për ndërtimin e hekurudhës po punonte tani gjithë Shqipëria, që u jepte zemër dhe u shtonte fuqitë aksionistëve të rinj.

Kjo ishte hekurudha më e re, po të pakta qenë ato hekurudha, që ndërtoheshin si kjo dhe të paktë ata ndërtonjës në botë, që ndiqnin me aq padurim gërmimin e çdo metër kubi, shtrimin e çdo binari, vendosjen e çdo shine në hekurudhën e re.

Vuksan Ndreka sapo ishte kthyer nga ceremonia e ndarjes së tesrave të rinisë nxënësve të një shkollë të Durrësit dhe po punonte bashkë me Sadri Mehmetin për mbartjen e shinave nga ana e rrugës së automobilit, ku qenë shkarkuar në trase. Ato qenë të rënda, të këputnin duart, po dy të rinjtë shtrëngonin dhëmbët e ngulnin fort çizmet në tokën e pjerrët që të mos rrëshqisnin. Ata vetë i kishin propozuar shtabit që të merreshin me këtë punë. Donin ta shihnin me sytë e tyre të përfunduar qoftë edhe një copë nga hekurudha e ardhshme, ta bënin vetë gjithshka: edhe çeljen e trasesë, edhe vendosjen e binarëve, edhe shtrimin e shinave, edhe zhavorrimin. Po të qe e mundur ata do të donin të ishin edhe udhëtarët e parë të trenit të ri, që do të kalonte jo sipër shinave, po sipër mundit e djersës së tyre.

— Çlodhemi pak!

Sadri Mehmeti pa togun e madh të shinave në anë të rrugës, vështroi pëllëmbët e duarve të veshura nga ndryshku dhe fshiu ballin me bërryl. Që prapa reve u duk një sy dielli dhe përtej, në kodrat, që i vinin kufi fushës së gjerë, që kish nisur të gjelbëronte nga gruri i ri i porsambirë, hodhi harkun e vet të shumëngjyrshëm një ylber.

— Çplodhemi — tha edhe ai dhe kërkoi vend ku të ulej.

Vuksani fshiu duart në pantallona dhe pa të atin, që punonte nja dyqind metra më larg. Ai, tok me një teknik të hekurudhave, bashkonte shinat dhe shtrëngonte vidat e hekurta, duke rënduar me gjithë trupin në çelësin e madh. Djalit edhe i vinte mirë edhe i qeshej me punën e t'et. Atij i kish ardhur për të qeshur edhe disa ditë më parë, kur e kish parë Pjetër Ndreken të veshur me uniformën e vullnetarit dhe me shallin e ri të lidhur në qafë.

Plaku rrinte si i ngrirë, siç rri kushdo kur vesh rroba të reja. Ai çuditej me vetëveten. Si kish pranuar aq lehtë të qëndronte në hekurudhë? Kish shumë punë e shumë andralla në fshat. Edhe kjo jeta me dishiplinë e me orar iu mërziit shpejt. Në kapanon natën e parë vullnetarët nuk bënë zhurmë. Që të mos i prishnin qetësinë plakut, edhe anekdotat i tregonin me zë të ulët dhe qeshnin mbyturazi. Po që natën e dytë e panë që ashtu nuk i delej dot dhe filluan prapë si më parë, duke heshtur vetëm kur ndërhynin kujdestarët e ditës, që bërtisnin me autoritet dhe jepnin këshilla, që të nesërmen ata vetë nuk do t'i zbatonin. Pjetër Ndreka mbështetej në bërryl dhe dëgjonte ç'thoshin vullnetarët. Herë-herë edhe qeshte bashkë me ta. Atij i flihej, po i vinte zor të ankohej e të ndërhynte. Nuk deshë të mbetej gjithnjë i huaj për të rinjtë. Vështirë është të pajtohen interesat e moshave të ndryshme. Çdo moshë ka logjikën e vet, aspiratat e veta. Ndërmjet tyre nuk mund të ketë kurrë njëjësime. Mund të ketë vetëm mirëkuptim dhe lëshime të dyanshme. Këtë e kupton më mirë ai që është i ri dhe

ka të bëjë me pleq ose është plak dhe ka të bëjë me të rinj, siç po i ndodhte Pjetër Ndrekës.

Në punë ai lehtësohej. Atje kish me se të merrrej dhe i pëlqente të hynte në garë me të rinjtë e të mos mbetej prapa. Është e vërtetë që i merrrej fryma, i skuqej fytyra, i fryheshin damarët e qafës dhe, në darkë, i çanin kyçet e gjymtyrëve, po këto pasoja të moshës ai mundohej t'i mposhte me vullnet. Nuk donte të turpërohej. Po të rinjtë, që ditët e para e nxitnin dhe e ngacmonin, e kuptuan sforcimin e tij dhe nuk i binin më në qafë, gjersa gjetën rastin dhe e bashkuan me teknikun, që lidhte shinat.

— E, Vuksan, ç'mundohe të grabitësh me atë vështrimin tënd? — e shpoi Sadri Mehmeti shokun e vet.

— Po shoh bablokun dhe bëj çudi — tha gëlltërisht Vuksani. — U bë teknik i mbaruar ai që deri dje nuk kish hypur as në kamion...

— S'është çudi për t'u çuditur ajo që thua ti. Gjithë Shqipëria ashtu është: nga qerrja e vjetër po hypën në trenin e ri — dhe pa i lënë rast tjetrit të kënaqej me këtë mendim, shtoi: — Po ti nuk e ke mendjen te babloku...

— Si?!

— Diku gjetkë vështron syri sytë...

— Nuk po të marr vesh — tha prapë i qetë Vuksani — ku e ke fjalën.

Sadri Mehmeti i luajti syrin.

— Eh, shok i lig! Edhe nga unë do të fshihesh?

Vuksani iu afrua dhe u ul në një binar aty pranë tij.

— Ku e ke fjalën? — pyeti.

— Më duket se shumë po e vren atë Dranden. . . .

— Ç'flet? — thirri Vuksani dhe vështrori përsëri në drejtim të t'et. Atje vërtet punonte edhe Drandja me katër shoqe të tjera. Ato po zhavorronin trasenë dhe ecnin në drejtim të tyre.

— U hutove, ë? — qeshi Sadriu dhe i ra shpatullave me grusht. . .

— Mos folë marrëzira!

— Edhe ajo sikur po të afrohet shumë.

— Ti s'je në vete! A nuk e kupton se është turp të përgojësh një vajzë? Aq më tepër. . .

— Unë nuk shoh asgjë të keqe. Është vajzë e mirë. Po deshe ti, bisedojmë edhe me axhën dhe i japim fund kësaj pune me të mbaruar hekurdha.

— More, — u nxeh Vuksani dhe u kthye me fytyrë nga shoku — unë kujtoja se bëje shaka, po ti e paske me gjithë mend, me sa duket. . .

— Në këto punë nuk bëhet shaka — tha seriozisht Sadriu. — Unë po të pyes si shok. Dua të të ndihmoj.

— S'kam nevojë për ndihmën tënde! Dhe dije mirë: po më fole edhe një herë kështu, do ta shtroj çështjen në mbledhjen e rinisë. . . Nuk më pëlqejnë ngatërresa të tilla. . .

— Ou!

— Kështu si të them unë! — dhe Vuksan Ndreka u çua më këmbë. — Nuk kemi ardhur këtu as për të parë vajzat e botës, as për të shpifur kundër tyre.

Pa pritur të fliste Sadriu, ai zbriti tatëpjetë skarpatën e trasesë dhe lëvizi nga vendi me po-tere një shinë.

Sadri Mehmeti e pa dhe buzëqeshi. Tej në horizont ylberi po zbehej e po tretej në sfondin e murmë të qiellit me re.

— Djalë sedërkeq — tha me vete dhe u çua. — Nuk pranon asnjë shaka...

Kurse Vuksanit i tha:

— Më fal. Nuk e dija se do të të digjte kaq shumë, — dhe, që të mos i linte rast të zemërohej më keq, ja plasi të qeshurit me zë të lartë dhe e mbërtheu për beli me sa fuqi kishte.

Kujdestari i ditës i ra çangës.

— Po kjo? — tha Vuksani dhe u çlirua me vështirësi nga krahët e shokut.

Të gjithë vullnetarët kishin lënë punën dhe qëndronin në vend, pa kuptuar përse i binin çangës. Kush kish orë shihte orën, të tjerët shihnin diellin. Ishte herët akoma. As pesë orë nuk kishin punuar.

Edhe në brigadat e tjera po binte çanga. Në rrugë zbrisnin vullnetarët, që radhiteshin sipas skuadrave e kompanive të punës. Ata merrnin edhe veglat me vete.

— Do të ketë ndodhur diçka, ndryshe nuk do të na hiqnin kaq heret...

— Ç'ka ndodhur?

— Urdhër i shtabit — tha kujdestari i ditës, një djalë qimekuq e syverdhë, që shokët e thërrisnin Kuqo.

— Pse?

— Nuk e di — u përgjegjej preras Kuqua dhe

i jepte rëndësi vetes. — Më njoftuan të ndërpritet puna dhe vullnetarët të kthehen sa më shpejt në sektor. Kaq di unë — thoshte ai dhe lëvizte poshtë e përpjetë për të vënë rregull në rrjeshta.

— Ti e di, po e mban fshehtë — e ngacmonin disa. Ai i vështronte në sy, e kuptonte që talle-shin dhe largohej.

— Hajde, shokë, mos na vononi!

Oborri i madh i sektorit që zbukuroar me flamurë të kuq, me pllakata e me parulla të shkruara në karton me ngjyra të ndryshme. Brigadat, që kishin mbërritur më parë, kishin lënë veglat e punës dhe bridhnin lirisht, sipas qejfit. Përgjegjësi i rojeve të sektorit mbante në dorë një flamur të ri atllazi. Sadriu e shpalosi dhe lexoi: «Brigada Shkurte Vata».

— Ja ç'na qenka! — tha dhe hyri përsëri në radhë. — Po na vjen brigada e vajzave të malësisë. Na kanë thirrur që t'i presim.

Dhe ashtu ishte vërtet. Në gazeta kish ditë që shkruhej për malësoret e reja, të cilat regjistroheshin vullnetare për në hekurudhë. Ato qenë shumë. Me emrin e Shkurte Vatës dhe me fjalën e partisë në gojë instruktorët dhe udhëheqësit e komiteteve të Bashkimit të Rinisë kalonin fshat më fshat, organizonin mbledhje e mitingje, i bënin thirrje ndërgjegjes së zgjuar të djemve e vajzave, i jepnin hov dëshirës e vullnetit të tyre për t'u shkëputur përfundimisht nga ato mentalitete e zakone, që i mbanin të ndrydhur, nga ajo jetë e ngushtë me interesime të vogla, që i topiste dhe i ndante nga jeta e madhe, që rridhte me shpërthime në të katër anët e vendit. Kudo ata

gjenin mirëkuptimin e të rinjve dhe dëshirën e tyre për t'u hedhur në krahët e një jete të re. Ata ishin të gatshëm për këtë. Kish ardhur koha që t'i jepej lamtumirë, jo me lot e me psherëtima, po me vendosmëri revolucionare, gjithshkaje të vjetër, që përpiqej me kryeneçësi të ruante pozitat e veta. Bindja e të rinjve dhe e të rejave ishte e thellë. Vendosmëria e tyre, sidomos e vajzave, nuk ishte aq e madhe, po kushdo e kuptonte që nuk mund të ndodhte ndryshe. Hapi i parë do të shkelte ndrojtjen dhe frikën dhe, pastaj, në marshim e sipër, ato do të shkelnin edhe pasigurinë, edhe nënvleftësimin e forcave të tyre, do të mësoheshin të shihnin më larg, të mendonin më thellë, të kaliteshin si luftëtare. Ato ishin shumë. Nuk ishte një ose disa. Ato nuk mund t'i nëpërkëmbte njeri siç ndodhte dikur. Kishin mbështetjen e njëra-tjetrës, kishin përkrahjen e partisë dhe e shihnin edhe vetë si thyeshin e mposhteshin opinionet e vjetra. Kur të ktheheshin përsëri në fshat, ato do të mbanin edhe për një kohë uniformën e aksioneve dhe nuk do ta hiqnin shallin nga qafa, po do të mburreshin me të.

Autobuset u ndalën në mes të sheshit të sektorit. Aksionistët vështronin me vëmendje vajzat e veshura me fustane të gjata basme, që zbrisnin me kujdes dhe nuk hidhnin çap përpara, pa kthyer kokën nga shoqet që s'kishin zbritur akoma. Autobusi, që i kish shpurë atje, sikur mbante erën e malësisë. Sheshi i madh i sektorit, i mbushur me djem e vajza të veshur njësoj, që tundnin duart dhe shamitë, ishte për to një botë tjetër, që akoma u dukej e huaj dhe e çuditshme, për shumë gjëra

e panjohur dhe e pakuptueshme. Prapa krahëve ato kishin shoqet e fshatrave nga kishin zbritur dhe porositë e rrepta të nënave të tvre, kurse përpara — një turmë shumë të madhe djemsh e vajzash të panjohura, të cilat në të parë shembëllenin shumë me njëri-tjetrin.

— Dile! — thirri një aksioniste, që njohu shoqen e vet.

— Mrika! — dhe një tjetër aksioniste doli përpara vullnetarëve dhe iu hodh në qafë malësore, që sapo kish zbritur nga automobili.

Pjetër Ndreka shtangu për një cast. Nga autobusi zbriste një vajzë e njohur, me flokë të drejtë e të gjatë, me fytyrë flakë të kuqe. Ajo, duke vështruar turmën e madhe të vullnetarëve, buzëqeshi me gëzim dhe u mbajt pas hekurit të derës së autobusit, që të hidhej në tokë. Pjetri shtyu me bërryl vullnetarët që kishte në krah dhe, duke zgjatur kokën, dalloi fytyrën e të birit, që rrinte pak më tej. Iu afrua me vështirësi dhe i pëshpëriti:

— Vreje! Ajo është Marta Prendi...

Vuksani e shikoi vajzën me vëmendje. Për një cast zemra i rrahu fort dhe sytë iu errësuan, po shpejt u qetësua dhe vazhdoi të shohë vjedhurazi të atin, pa ndonjë shqetësim. Ajo ishte një vajzë si gjithë vajzat e tjera. Asgjë nuk e shtynte drejt saj. Gjithë parafytyrimet e tij të mistershme tani e kishin humbur fuqinë e tyre të dikurshme sugjestjononjëse.

— E pe? — pyeti përsëri Pjetër Ndreka, kur vajza humbi në turmën e madhe të aksionistëve, që piqeshin e përqafoheshin.

Vuksani dalloi në zërin dhe në vështrimin e t'et një valë të re ligësie kundër vajzës dhe një notë therëse talljeje kundër vetes dhe të birit. Nusja e pabesë po u vinte atje. Të nesërmen ajo, si edhe ata vetë, do të vishte uniformën e vullnetarëve dhe do të punonte pranë tyre. Mbase edhe do të donte të fliste e të qeshte me ta, siç flasin e qeshin aksionistët me shoku-shokun. Këtë Pjetër Ndreka nuk e duronte dot. Ai nuk e kish harruar, po që rropatur ta zhvleftësonte fyerjen që u kish bërë Marta Prendi dhe kish filluar të mendonte disi ndryshe për kuptimin e asaj, që kish ndodhur. Dhe që qetësuar. Qenë fashitur hovet e zemëratës dhe të etjes për hakmarrje. Edhe në ndërgjegjen e në mendimin e tij kishin përshkuar rreze të reja të një dielli të ri dhe, në mos që bindur, të paktën që lëkundur dhe kish gjetur rrugën për t'u krenuar para të tjerëve e për t'u përligjur para vetes. Kurse tani ajo kish dalë papritur si një re, që i errësonte diellin, i ndizte gjakun, i turbullonte mendjen dhe u jepte hov të ri gjithë fuqive të së keqes, që nisën të lëviznin prapë në shpirtin e tij të trazuar.

— Ishte Marta Prendi — i tha të birit, që heshte dhe vështronte vajzat, që zbrisnin nga autobuset.

— E pashë — iu përgjigj Vuksani, duke u munduar të fshehë çdo ndenjje e çdo mendim në fytyrë dhe në theksin e fjalëve. Në çast atij i vetëtiu në kokë një mendim i ri. Sikur të mos kish qenë Pjetër Ndreka pranë tij dhe sikur ai të mos e kish ndier orë e çast si një peshë të rëndë praninë e t'et, nuk do të kish qenë aq i qetë e i qartë. Duke pasur orë e çast parasysh të kundër-

tën e vet, të kundërtën e asaj që atij i dukej e drejtë dhe e vërtetë, i qenë forcuar edhe më tepër bindjet dhe, ndërsa i ati përpiquej ta afronte me veten, ai gjithnjë e më tepër largohej nga vjetërsia e mendimeve të plakut, nga brengat e shqetësimet e kota të tij.

— Po ndenji ajo këtu, unë do të iki! — tha plaku, pa ditur ç'të thoshte tjetër. — Nuk e duroj dot! — turfulloi i rrëmbyer, duke parë se edhe vetë, si gjithë të tjerët, po ecte në një tokë të re. Ky terren ishte i gjerë, i madh, i qëndrueshëm. Ai ndërronte pavarësisht nga vullneti i një njeriu të vetëm. Atë e ndërronin të gjithë, sado që të gjithë mund të kishin edhe diçka të tyre, që nuk pajtohej me atë që ndodhte. Zotësia është të kapesht pas asaj që është kryesore, e rëndësishme, e gjallë dhe të hedhësh prapa krahëve vogëlsirat, gjërat pa rëndësi, ato që vdesin, kotësit. Për hir të tyre, nuk ja vlen të vrasësh veten me kryeneçësi. Këtë të vërtetë nuk e kuptonte aq mirë Pjetër Ndreka, ose, më mirë të themi, e shihte, po nuk kish qejf ta pranonte pa kundërshtuar.

— Mos folë kështu, se është turp — guxoi ta kundërshtonte Vuksani. — Ne punojmë për vete dhe nuk mund të ndalojmë të tjerët... Ajo e ka veten në dorë...

— Po unë? — u nxeh më keq Pjetri.

— Edhe ne — tha Vuksani, duke u munduar ta qetësojë. — Njeriu ka në dorë të bëjë edhe të mirën, edhe të keqen.

— Ashtu, ë?... Ajo bëka të mirën, kurse unë dashkam të bëj të keqen, ë? — u tall plaku. — Kështu thua ti.



50

— Atë nuk e dëbon dot — iu kthye me vendosmëri Vuksani, që e pa se duhej një ndërhyrje e fortë në këtë rast. — Kurse ti, po të largohesh, do t'u japësh shkas gojëve të këqia të flasin. . . Në fshat nuk do ta lënë pa e diskutuar një gjë të tillë — dhe u zgjat të shihte më mirë një fytyrë vajze, që u duk te dera e autobusit.

— Mos ke ndër mend t'i vërtitesh rrotull si lingua? — i shkrepri në kokë një mendim ters Pjetër Ndrekes, që e shihte se i biri kish të drejtë dhe e shikoi me egërsi.

Vuksani nuk i dëgjoi këto fjalë.

— Trinka! — thirri i gëzuar, kur u sigurua se kish ardhur edhe e motra bashkë me malësoret e tjera dhe ngriti dorën për ta përshëndetur, duke çarë me vështirësi përmes vullnetarëve të ngjeshur pranë njëri-tjetrit.

— Trinka? — u habit dhe u egërsua më keq Pjetër Ndreka dhe ndjeu menjëherë një dobësi të madhe në të gjithë trupin. Këmbët dhe duart i dridheshin. Donte të ulëj ose të mbështetej diku, po s'kish se ku. Dhe do të kishte rënë, sikur të mos shtrëngohej rrotull tij turma e madhe e vullnetarëve. Ata e mbajtën më këmbë.

— Asgjë nuk po marr vesh!.. — pëshpëriti. — Më duket si ëndërr... dhe, pasi vështroi uniformën e tij dhe shallin që kish hedhur në qafë, tundi kokën dhe heshti.

Njeriu i vetëm, sado i fortë e kryeneç që të ishte, nuk mund t'i bënte dot ballë vullit që kish shpërthyer.

KAPITULLI I TETË

Turnet e natës janë të vështira. Ato janë të vështira edhe në uzina e fabrika, jo më në kantierët e ndërtimit e, aq më tepër, në prak të dimrit. Kur të ka zënë gjumi mirë dhe kolovitesh në krahë ëndrrash, i mbuluar me jorgan në dhomën e ngrohtë a në barakën e vakur nga frymët e sho-keve, që të ngushtojnë më të dy krahët, ty të tremb gjumin e ëndërrat zilja e orës, zëri i shokut ose thirrja e mprehtë e kujdestarit të natës:
— Çohu!

Për disa sekonda ti nuk e di si je: zgjuar apo në gjumë, po menjëherë mbledh veten, shtyn jorganin ose batanien me këmbë dhe kërcën nga shtratit. Ddridhja të ftohta të përshkojnë trupin dhe ti kërkon rrobat. Vishe shpejt e shpejt, u hedh një grusht ujë syve dhe nise për në stacionin e autobuseve, merr rrugën më këmbë ose del në sheshin e sektorit dhe pret shokët e brigadës, që të rreshtohen e të vesh bashkë me ta në trase.

Marta Prendi nuk ishte zgjuar ndonjëherë natën në të tillë mënyrë. Atje, në malësi, ajo që mësuar të binte herët, sapo errësohej dhe të zgjohej kur dielli kish praruar kreshtën e maleve kundruall fshatit. Po, megjithatë, ajo u përmend menjë-

herë, kur dëgjoji thirrjen e kujdestares së natës dhe, e përgjumur, kërkoi më kot fustanin e gjatë prej basme. Vetëm kur i zuri syri pantallonat e hedhura në fund të shtratit, u kujtua të mernte gozhupin poshtë jastëkut dhe të zbriste për të mbathur çizmet.

— Sonte, shokë dhe shoqe aksioniste, — tha komandantja e sektorit, kur të gjitha brigadat qenë rreshtuar dhe prisnin të niseshin, — do të punojmë në sektorin e Dushkut, atje ku ra komunistja pesëmbëdhjetëvjeçare, Shkurte Pal Vata. Kjo do të jetë një natë sulmi. Do të kemi ftohët, mund të na zërë edhe shiu, — tha dhe vështroi qiellin që nxinte, — po besoj se do t'u bëjmë ballë me trimëri vështirësive dhe nuk do ta turpërojmë sektorin tonë...

— Ç'natë! — mendonte Marta Prendi, duke vështuar rreth e qark sheshin e sektorit dhe duke u munduar të shquante nga larg të njohurit e saj nën dritën e fuqishme të prozhektorëve, që e bënin natën ditë. Ajo sillte ndër mend me trishtim netët e thella të malësisë, frikën kur i takonte të dilte jashtë, guximin që i jepte drita e pishës ose edhe e llambës me vajguri, që mezi përshkonte xhamet e dritares së vogël të konakut.

— Netve të tilla, edhe mund të punosh, edhe mund të këndosh...

Brigadat u nisën dhe, me gjithë urdhërin e prerë që të mos bënin zhurmë rrugëve, gjimnazistët, që në përgjithësi e kishin më të vështirë t'u bindeshin urdhërave e t'u nënshtroheshin rregullave, sapo kaluan portën e jashtme të sektorit, ja morën këngës me zë të ulët. Po kënga i rrëmbeu,

dhe zëri i tyre shpërtheu i fuqishëm e u përhap në qetësinë dhe në errësirën e natës:

*Mbi supe shi, në këmbë baltë,
Në trup uri, uri edhe plagë,
Ecim, shkojmë drejt diellit,
Çajmë përpara, si masa vigane...*

Kjo ishte një këngë e re, një këngë që aksionistët e malësisë nuk e kishin mësuar akoma, kurse Marta Prendi dhe shoqet e saj ishte hera e parë që e dëgjonin. Dhe kënga vërtet i ngrohu. Hapat u shpejtuan vetëvetiu, duke ndjekur ritmin e këngës dhe një rrënoqethje ngashërie përshkoi gjithë vullnetarët e rinj, që ecnin nëpër natë dhe këndonin për lavdinë partizane.

Lushnja flinte. Sheshi i zbrazët e i qetë ndriste nga llambat me neon. Para zyrave të komitetit të partisë e të komitetit ekzekutiv qëndronin disa automobila. Edhe ata dukeshin të heshtur e të fjetur; prisnin mëngjezin që të niseshin fshatrave të rrethit për të shpënë një fjalë të re të partisë ose për t'i sjellë partisë një mendim të ri, që kish mbirë fushave të Myzeqesë.

Në disa apartamente u ndezën dritat. Dikush çeli dritaren të shihte ç'po ndodhte. Mbase ishte edhe ai një punëtor i turnit të natës, që nuk ishte zgjuar kësaj radhe, si zakonisht, nga zëri i së shoqes, — se gratë e kanë gjumin më të lehtë nga burrat, — po nga kënga e fortë e brigadave të vullnetarëve.

Edhe në hotel u ndezën disa drita, njëra pas tjetrës. Një djalë ja mori këngës dhe aksionistët, që

kalonin poshtë tij, njohën artistin, që disa orë më parë u kishte kënduar në skenën e sektorit.

Dikush nga aksionistët i thirri këngëtorit në emër. Ai tundi duart dhe vazhdoi këngën, megjithëse mbi shpatulla i rëndonin shokët e dhomës, që ishin ngritur për të parë.

Vuksan Ndreka që rrëmbyer në valën e kësaj nate të gëzueshme dhe, duke luajtur gishtat e dorës, mundohej të gjente fjalët e një kënge që kish nisur të thurte për Shkurte Vatën. Kjo këngë po e mundonte shumë. Sa thurte vargjet e para për të atin e kushërirën e saj, që erdhën ta zëvendësonin, radjua dhe gazetat jepnin lajmin se një brigadë të rejash do të zbriste nga malësitë e veriut në Myzeqe dhe një tjetër brigadë do të nisej nga Lushnja në malësi për të punuar e jetuar bashkë me fshatarët e atyre anëve. Dhe kënga zgjatej, po jeta, si për inat të Vuksan Ndrekes, që donte ta këndonte sa më parë këtë këngë të re, zbulonte të tjera anë të bukurisë e të madhështisë së vet. Kooperativa bujqësore që mori emrin e Shkurte Vatës, se në tokat e saj mbeti malësorja e re, kish vendosur të ndihmonte kooperativat e reja të malësisë, duke u dërguar disa dhjetëra krerë lopë. Fill pas saj, shumë kooperativa të tjera të fushës ndoqën shembullin e saj. Mijëra lopë, dhën e dhi, do t'u qepeshin maleve të Veriut, se ne, siç thoshin kooperativistët lushnjarë, jemi degë të një lisi, fjalë që Vuksani deshi t'i fuste patjetër në këngën e vet për Shkurte Vatën.

Kështu zgjatej kënga, gjithnjë shtoheshin vargje të reja, që lindnin gjatë punës në trase, në orët e pushimit dhe kur Vuksani ecte, si asaj nate,

i rrëmbyer nga këngët dhe thirrjet luftarake të të rinjve. Po tani ajo nuk para i pëlqente malësorit të ri. Ai fliste për gjithë ç'kish ndodhur gjatë atyre muajve, po e shihte edhe vetë se kuptimin e tyre nuk e kish zbuluar dot. Ai nuk arrinte të përshkonte në thellësi të këtyre ngjarjeve, që pasonin njëra-tjetrën e lidheshin aq thjeshtë me emrin e Shkurte Vatës, ndaj edhe në këngë ato nuk shkriheshin dot me njëra-tjetrën, nuk bëheshin, siç ishin me të vërtetë, një e tërë e pandarë, siç ishte, fjala vjen, zgjimi pranveror i natyrës, kur mijëra lule çelin, po të gjitha ndillen e rriten nga toka, nga dielli. Para gjithë këtyre ngjarjeve të mëdha, në sytë e Vuksan Ndrekes, Shkurte Vata, që ai e kish përfytyruar e përshkruar, sipas vizatimeve të botuara në gazeta, i humbiste pak nga pak ato tipare konkrete njerëzore dhe kthehej edhe ajo në një ngjarje të madhe, në një fenomen të kohës. Vuksani i sillej rrotull zgjimit pranveror me shpresë se krahasimi do ta ndihmonte më parë të kuptonte e pastaj të shprehte gjithë ç'po ndodhte para syve të tij.

Pjetër Ndreka kish marrë të bijën për dore dhe ecte i heshtur e i menduar, duke ndjekur vargun e gjatë të aksionistëve të rinj, që kaloi përmes sheshit dhe mori drejt veriut, duke ndjekur rrugën e automobilit, që të nxirrte nga qyteti. Trinkta ecte përkrah të atit, si e ngrirë, pa guxuar të lëvizte as gishtërinjtë e dorës, që i kish mbërthyer Pjetri në pëllëmbën e vet të madhe, që shtrëngohej e çlirohej, sipas mendimeve që i shkrepnin në kokë. Në fillim ai ndenji i zemëruar me të bijën dhe i foli rëndë, që kish dalë nga shtëpia pa pëlqimin e tij.

Tani, sado që buza nuk i kish qeshur një herë dhe shpesh hetonte të bijën mos i gjente ndonjë ndryshim të papëlqyeshëm, nuk ishte më aq i egër.

Prapa tyre, dy rreshta më pas, vinte Marta Prendi. Edhe ajo ecte e menduar dhe vështronte nëpër mugëtirë shpinën pakëz të kërrusur të Pjetër Ndrekes dhe jakën e gozhupit të tij që e kish ngritur lart për të mbështjellë qafën. Ajo e njihte. Rrugës për në Lushnjë kish njohur edhe Trinkën. Kishin mjaftuar vetëm dy fjalë për t'u njohur.

— Si e ke emrin?

— Trinkka Ndreka. Po ti?

— Marta Prendi — kish pëshpëritur tjetra.

Ato kishin vështruar njëra-tjetrën, Trinkka me mëri e Marta me lutje për shfajësim. Pastaj nuk kishin folur më, sado që Marta, kur i kalonte pranë, gjithnië e nërshëndeste shoqen e vet me gjysmë zëri.

— Si ndryshuaka jeta! — mendonte Marta Prendi, duke ecur. — Gjashtëmbëdhjetë vjet e fejuar dhe kurrë nuk e kisha parë të fejuarin tim! Kur, ja, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, fejesa u prish dhe, fill pas kësaj, unë kaloj në një rrugë me të, jetoj pranë tij dhe afër tij punoj. A nuk është për të bërë çudi?

Në fillim, ajo nuk e njihte Vuksan Ndreken, po shpejt e mori vesh prej shoqeve që ai ndodhej në hekurudhë, bile në sektorin e tyre. Ajo desh ta njihte. Diçka, një farë kureshtje — jo një kureshtje e thjeshtë, — e shtynte të interesohej për të, po turpi nuk e linte të pyeste shoqet, gjersa një ditë e pa me të motrën, duke ndënjur para barakës së vajzave. Ajo kthehej nga mensa dhe deshi të hynte

në fjetore. Kur pa atë, ose, më mirë të themi, kur e mori me mend që ai qe Vuksan Ndreka, ish-ifejuari i saj, ktheu rrugë dhe u vërtit ashtu kot nëpër oborr gjersa ai u largua.

Ajo ecte duke mos ja shqitur vështrimin shpinës pakëz të kërrusur të Pjetër Ndrekës, i cili mbante për dore të bijën, sikur ende nuk i qe mbushur mendja ta linte të lirë, që edhe ajo të hidhte hapin sipas ritmit të këngës së re e të këndonte edhe vetë si gjithë vajzat e tjera, të cilat mundoheshin, duke mërmëritur, të ndiqnin pas brigadën e gjimnazistëve.

Edhe ndaj Marta Prendit Pjetri ishte treguar i egër. Ai vetëm ditën e parë i kish ngulur sytë e tij të frikshëm, se vajza desh thirri e trembur, mos ai e qëllonte me dorën që iu tendos si edhe muskujt e fytyrës. Paskëtaj, edhe kur i kalonte pranë, plaku kthente kokën mënjanë dhe diç murmuriste me vete. Marta e merrte me mend që ai e shante.

— Po ai, më mirë të shajë veten — mendonte me të drejtë malësorja e re, — se ai dhe im at e kanë fajin. Ata na fejuan. Ata bënëin çmos qe ne të mos njiheshim para martesës. — Dhe Marta, duke menduar kështu dhe duke parë se mund të jetohej aq pranë me njerëz, të cilët me të drejtë, apo pa të drejtë, e vështronin në mënyrë armiqësore, po nuk bënëin tjetër veçse heshtnin, sikur merrte zemër dhe kishte një farë sigurie, jo aq në veten e saj, as në shoqet e saj, sa në diçka, që ajo e ndjente, e jetonte edhe vetë, po nuk qe në gjendje ta shpjegonte. Ishte vetë jeta që i jepte kaq siguri, jeta që ajo, sikurse edhe i ati i saj e Pjetër Ndreka e shumë të tjerë po e ndryshonin edhe pa qenë të bindur plotësisht. Dhe pastaj, më nga-

dalë, shumë më ngadalë, ndërronin e do të ndërronin edhe ata vetë, pa e kuptuar, që bëheshin kështu edhe edukatorë të vetëvetes. Kohët ndryshonin; dhe njerëzit, sado me vështirësi, bëheshin më të mirë dhe më të dashur me njëri-tjetrin.

Edhe Pjetër Ndreka nuk ishte më aq i egër e aq i zymtë në shpirt e në mendime, sa ç'kujton-te bija e tij. Në qoftë se shpesh shfaqte shenja nervozizmi ndaj saj, kjo ndodhte jo se ishte i lig dhe nuk merrte vesh ç'ndodhte, po se donte t'i kalonte vetëm të gjitha dhimbjet e shqetësimet, pa ua hapur zemrën të tjerëve. Në mendjen e tij qe ngulitur pikëpamja se burri gjithnjë duhet të tregohet i fortë dhe të shfaqë para të tjerëve vetëm ato mendime e ndjenja, që nuk vënë në dyshim autoritetin e tij si burrë. Kish edhe gjëra që nuk i kuptonte, po tani ai s'kish më dëshirë të diskutonte as me vetveten për ato që ndodhnin, se e shihte që vetë jeta nuk i duronte më arësytimet e tij. Ishte apo nuk ishte plotësisht i bindur, atij tani do t'i vinte turp të kërkonte parekur të fejonte të bijën dhe, para se të jepte fjalën, do ta pyeste në i pëlqente djali që i kish zgjedhur, që, nesër, të mos i ndodhte edhe asaj si të vëllait.

Sa për Marta Prendin, ai as që deshi të bisedonte më. Vetëm i vinte maraz që i takoi të ishte aty dhe t'i dilte orë e çast përpara, sikur donte t'i thosh: «E, Pjetër Ndreka, ku janë zakonet dhe burrëria juaj? Ja, unë një copë vajzë, që gjer dje as më përfillnit, i shkela ato me të dy këmbët dhe ju s'keni ç'të më bëni!»

Për këtë i vinte vërtet keq Pjetër Ndreka dhe mallëkonte veten që kish bërë atë krushqi.

Kur kreu i kolonës së aksionistëve u ndal, ai lëshoi dorën e vajzës dhe doli nga radha të shihte ç'kish ngjarë. Nën dritën e dy prozhektorëve dhe të një vargu llambash elektrike, që qenë vendosur anës së trasesë, nja dy metra lart tokës, dalloi figurën e Pal Vatës, që piqej e përqafohej me anëtarët e shtabit dhe me një grup vullnetarësh. Ai rrinte sipër trasesë dhe drita, që i binte prapa krahëve, e tregonte më të madh trupin e tij.

— Do të vete ta përshëndosh, — vendosi dhe u largua, pa i thënë gjë së bijës. Trinkka menjëherë u kthye nga shoqet e veta dhe e ndjeu veten më mirë larg tij.

Ndërsa vajzat prishën rrjeshat e brigadës dhe bisedonin me njëra-tjetrën buzë rrugës, të rinjtë e kreut kishin nisur nga puna dhe thërrisnin me zë të lartë. Pjetër Ndreka ndenji pranë Pal Vatës dhe, duke i rënë me kazmë dheut të ngjeshur, e vështronte vjedhurazi fytyrën e tij të hequr, që dukej më e zbetë nën dritën e llambave elektrike. Ai punonte si gjithë të tjerët, po lodhej shpejt. Drejtonte shpinën për një çast, sikur donte të shihte dhe të merrte fuqi prej lapidarit të së bijës dhe prap përkulej dhe i binte dheut me kazmë.

— Po mbesën ku e ke? — pyeti Pjetri, sa për t'u gjendur në fjalë. — Dëgjova se e ke marrë me vete...

— Erdhi, po nuk i priu. Ishte e pamundur dhe doktorët e këta shokët më thanë, se duhej shtruar në spital.

— Ashtu?

— Po, me t'u kthyer në fshat, do të dërgoj tim bir... — shtoi ai për t'u shfajësuar dhe vazhdoi punën.

— I fortë njeriu, — mendoi Pjetër Ndreka. — Mirë thonë: edhe guri thërmohet, edhe hekuri përkulet, po njeriu duron... I fortë qenka, për besë, — dhe u mundua të kapte me një vështrim edhe figurën e Pal Vatës, edhe lapidarin e bijës së tij, që ishte bërë e lavdishme.

KAPITULLI I NËNTË

Aksionistet e brigadave të malësisë në fillim u druheshin dhe u shmangeshin gjimnazisteve. Ato, edhe i donin, edhe i kishin zili, edhe gudulise-
shin nga të qeshurat e tyre me zë të lartë, nga shkathtësia dhe nga sjelljet e lira e aq të natyr-
shme në punë e pas pune, edhe u druheshin mos
ato u prishnin atë qetësinë e ngurtë e të panatyrsh-
me për moshën e rinisë, të cilën malësoret e rua-
nin si vetëveten, jo se e donin, po se u kish hyrë në
gjak mendimi që vajza gjithnjë duhet të jetë e
ndrojtur, kryeulur dhe veç me shoqen e vet të
ngushtë të pëshpërisë me zë të ulët, sa të mos e
dëgjojë kush. Ditëve të kthjellta ato uleshin varg
pranë njëra-tjetrës para barakës së tyre dhe vësh-
tronin gjimnazistet, që zbatnin çizmet, përvishnin
pantallonat gjer sipër pulpëve, hiqnin gozhupët e
rëndë dhe silleshin nëpër sheshin e sektorit, duke
vrapuar bashkë me shokët e tyre pas një topi, të
cilin kush e kush lakmonte ta kalonte në një
rreth hekuri të mbërthyer lart në një dërrasë. Ato
u dukeshin si çupa të përkëdhelura, që kishin
lindur vetëm për të qeshur e për të lojtur, që nuk
çanin kokën për vështrimet qortonjëse dhe për
fjalët e botës, që silleshin sikur kishin kapur qie-

llin me dorë dhe, megjithëse ishin gjashtëmbëdhjetë e shtatëmbëdhjetë vjeçe dukej se nuk e vrisnin mendjen për... po, pra, për martesë. Malësoret, edhe pa mbushur të dhjetë vjetët, qenë mësuar të dëgjonin prej nënave të tyre porosi të shumta dhe këshilla të rrepta për këtë çështje, për këtë enigmë të jetës së tyre, për këtë frikë, për këtë nder e për këtë turp të jetës. Që në fëmijëri mendimi i tyre ngushtohej dhe mpihej nga porositë e nga këshillat e nënave që u hynin në gjak dhe u paracaktonin një fat aq të vogël dhe aq të keq: të mendonin për burrin që do të merrnin, të kishin kujdes mos u dilte fjalë dhe mbeteshin fare pa u martuar. Martesa që e vetmja gjë për të cilën duhej të mendonte një vajzë me mend në kokë dhe, në qoftë se donte të ishte e lumtur, me kohë duhej t'u harrronte edhe emrin shokëve të fëmijërisë dhe, kur t'i ndeshte në udhë, të kthente kokën mënjanë e të mos u fliste.

Edhe Drande Pilsa, që mbahej prej malësoreve e guximshme dhe pa ndrojë, në fillim nuk u afrohej gjimnazisteve. Fjalëve dhe këshillave të tyre ajo, si edhe shoqet e saj, u përgjigjej me një të qeshur, duke kthyer kokën mënjanë. Ajo kish qejf t'i dëgjonte e të ndiqte shembullin e tyre, po... Eh, sikur të bënte me vete edhe disa vajza të tjera, që të mos ishte ajo e vetmja, të mos ishte ajo e para!..

Në një mbledhje që patën ditët e para, që kishin vajtur në hekurudhë, ajo kish veshur e para pantallonat e aksionistes. Shoqet e veta, që qenë ulur në frona dhe mbanin të mbështjella në duar rrobat që kishin marrë në magazinë, kur panë Dran-

den të veshur me pantallona u kukurisën së qeshuri të gjitha dhe u skuqën në fytyrë. Aq shumë qeshën dhe aq tallshëm e vështronin, sa dhe vetë Drandja deshi t'i hiqte ato pantallona të mallëkuara. I dukej vetja qesharake, sikur që futur në thes. Fjalët që kish menduar t'u thoshte shoqeve i harroi fare dhe mbeti ashtu më këmbë para tyre, e skuqur në fytyrë, duke vështruar si me të lutur komandanten e sektorit, që e kish menduar ndryshe këtë takim.

— Pse qeshni? — u nxeh ajo. — Shihni sa mirë i rrinë pantallonat Drandes! — dhe e rrotulloi vajzën që ta shihin të tjerat nga të gjitha anët.

Vajzat atëhere qeshën me të madhe dhe Drandja i shpëtoi nga duart komandantes së sektorit dhe, meqë s'pati guxim të vente në fjetore e të hiqte pantallonat, u ngjit në skenë, u fsheh prapa perdes dhe qau me dënesë.

— Turp të kini, — u zemërua më keq komandantja, se edhe ajo që e re dhe nuk i mbante dot ngaherë parasysh këshillat që i kishin dhënë për qëndrimin ndaj aksionisteve. — Pse, ç'jemi ne që kemi veshur pantallona? Apo doni që kur të fryjë era t'ju ngrejë fustanin përpjetë? . . . Hë, pse nuk flisni? Pse nuk qeshni më? — pyeti fitimtare, po vajzat aq deshën dhe qeshën përsëri. U detyrua të qeshte me zemërim edhe vetë komandantja.

— Unë do t'i mbath pantallonat, — tha më në fund njëra nga aksionistet, po sipër tyre do të mbaj edhe fustanin. . .

— Ç'kuptim ka kjo?

— Në daçi, — tha malësorja, që dukej se ishte fjalëpakë e kokëfortë dhe u ul.

Mendimin e saj e pëlqyen edhe të tjerat. Vetëm Drandja nuk e veshi fustanin sipër pantallonave. Po atë nuk e qeshën më. Një më parë e një më vonë, pa u ndier, i hoqën fustanët edhe vajzat e tjera. Megjithkëtë ato prapë dalloheshin prej gjimnazisteve. Drandja vriste mendjen të gjente pse atyre u rrinin aq bukur pantallonat, kurse asaj dhe shoqeve të saj u ngjante vërtet se qenë futur në thes. Ajo shihte gjimnazistet, shihte edhe shoqet e veta dhe menjëherë i binte në sy ndryshimi, jo vetëm në qëndrim, po edhe në veshje. Ndërsa maelësoret mendonin vetëm të visheshin, gjimnazistet, që kur hynin në magazinë, e shurdhonin priftin me kërkesat e tyre për të gjetur rroba që t'u rrinin pas trupit të cilat pastaj i merrnin e i rregullonin, i shkurtonin e i ngushtonin gjersa t'iu dukeshin bukur format e trupit, që sapo kishin marrë zhvillim të plotë.

— Budallaçkë, — i kish thënë një gjimnaziste Drandes, — hiç mos ki turp. Njeriu duhet të vishet thjesht dhe bukur. Ç'të keqe ka këtu?.. Edhe këta flokët, që të zenë sytë dhe të mbulojnë zverkun, s'ke ç'i do!.. — dhe ajo u kish rënë flokëve të Drandes me majat e gishtërinjve, pastaj ja kish kapur me të dy duart prapa kokës. — Ja, e shikon, kështu dukesh më e pashme, fytyra të del në sinesh... Apo nuk e ke këtë qafë të gjatë, tamam si sorkadhe... Hajde të vemi që tani te berberi...

— Qyqja! — qe hedhur Drandja dhe i qe larguar gjimnazistes. — Edhe ajo më duhet!

— Po pse, moj? Flokët e gjatë të pengojnë edhe në punë. Ja, shikomë mua, — dhe gjimnazistja tundi e shkundi kokën e saj të vogël e të bu-

kur. Flokët e shkurtër dhe baluket e lëshuara përmbi ballë çapkënçe nuk i luajtën nga vendi. — E sheh? Pa tunde një herë kokën ti?

Drandja e dinte, se me të tundur kokën, flokët do t'i binin në fytyrë, po dinte edhe një gjë më me rëndësi, që gjimnazistja trupvogël e zeshkane e kishte harruar: në malësi femrës i shkurttonin flokët vetëm kur donin ta turpëronin. Kështu kish qenë gjithmonë. Kështu kishin vepruar edhe diversantët me aktivistet e partisë në malësi në vitet e para pas çlirimit. Dhe Drandja, sado që i jepte të drejtë gjimnazistes, i druhej një hapi të atillë; aq më tepër se shoqet e brigadës e dinin historinë e saj. Mund të kish edhe prej atyre që ta përflisnin e ta përqeshnin guximin e saj, ndaj ajo i buzëqeshi trishtueshëm dhe heshti.

Gjimnazistja e kuptoi lëkundjen e shoqes. I hodhi dorën në bel dhe e tërhoqi ndaj vetes, sikur donte ta puthte.

— E di, — i tha, — ti ke turp të dalësh e para ndër shoqet, po një gjë duhet të dish: pas një muaji të gjitha kanë për t'i shkurtuar flokët, ashtu siç kanë filluar të rregullojnë edhe rrobat pas trupit. Edhe tek ne ka qenë turp të shkurttojë flokët vajza. Plakave edhe tani u dukemi të shëmtuara. Po hajde, në daç dhe prashit e mblidh pambukun me flokë të gjatë dhe hyrë në arat me misër pa pantallona! Çdo kohë ka bukurinë e saj, se ka edhe hallet e saj, — përfundoi gjimnazistja në mënyrë filozofike dhe e uli Dranden pranë në fronin e drunjte afër altoparlantit.

— E di çka? — i tha Drandja mendueshëm me vështrim të tretur në muzgun e ftohtë të

mbrëmjes, — edhe unë mendoj si ti dhe due të jem si ti, po...

— Po çfarë? — ndërhyri përsëri e sigurt gjimnazistja, që ishte e gatshme për të dhënë mësim.

Drandja u mat t'i rrëfente gjimnazistes historinë e vet dhe t'i qante hallin, po pyetja e saj nuk iu duk aq e përzemërt, ndaj ndërroi mendje dhe tha më të psherëtirë:

— Ju qytetaret jeni ndryshe...

— Kush të tha se jam qytetare? — u hodh gjimnazistja. — Edhe unë fshatare jam...

Malësorja nuk e besoi. Hetoi edhe një herë fytyrën, trupin dhe duart e gjimnazistes dhe tundi kokën me mosbesim.

— E pamundur.

— Të betohem!

— Nga ç'fshat je? — e pyeti Drandja për ta zënë në fjalë.

— Jam këtej nga Lushnja, nga kooperativa «Rruga e partisë».

— Hej!

— Po. Edhe gjimnazin mos kujto se e ndjek në qytet... Kemi një gjimnaz në kooperativën e afërt. Atje vete për të mësuar bashkë me vëllanë. Ngrihemi herët në mëngjes... Çdo ditë bëjmë një marshim të mirë, se e kemi larg... Në dimër e kemi ca vështirë. Këtu, në Myzeqe, po filluan shirat, të mbyt balta. Dhe, të ecësh gati dy orë nëpër baltë nuk është gjë e lehtë. Po unë kam vendosur, — tha me bindje, — që ta mbaroj gjimnazin me nota shumë të mira. Më ka hypur në kokë të bëhem aviatore.

— Çfarë the? — u habit Drandja.

— Të gjithë habiten me mua. Ç'të duhet ti, moj Ristankë, të bëhesh aviatore? — më thonë. — bëhu të paktën traktoriste. Po jo, — u revoltua ajo. — Unë dua të bëhem aviatore, më kupton? — dhe e kapi malësoren për krahu, sikur ajo kish për të thënë fjalën e fundit. — Dhe jo pilote e atyre aeroplanëve me dy krahë, që spërkatin kënetën me flebol, po pilote e aeroplanëve luftarakë supersonikë!... Eh, kur të vijë ajo ditë! — thirri Ristanka me entuziazëm dhe përplasi dorën e majtë në pëllëmbën e së djathtës.

— Nuk ke frikë?

— Frikë? E pse? Në mos vdekshim në luftë, do të vdesim patjetër në shtrat, — thjeshtësoi ajo me dashje një mendim të De Radës, që i kish pëlqyer shumë. — Moj, po le të vdes, — shtoi pastaj po me atë vrull, — vetëm të fluturoj një herë me ato shigjetat e argjendta, që i vijnë rrotull Shqipërisë për disa minuta... Kam qejf t'i shoh gjërat nga lart. E ndjej që tani si do të më mbushet gjoksi me frymë, dhe zemra me dashuri... — dhe papritur heshti, u vrëjt si mbrëmja dhe sytë e saj të zez u bënë të thellë, të menduar e gati të mistershëm.

Dranden e rrëmbeu ëndrra e guximshme e gjimnazistes dhe e ndjente veten varfanjake pranë saj. Ndërsa Ristanka fliste me aq zjarr për të fluturuar më shpejt se zëri, ajo mendonte se ku do të vente pasi të mbaronin dy muajt e punës në hekurudhë. U kishte shkruar dy letra prindërve dhe ata nuk i qenë përgjegjur. Më kot kish pritur të dëgjonte emrin e vet kur ndahej posta. Ata nuk do të përuleshin aq lehtë. Sidomos i ati.

— Janë të çuditshëm, — e përmendi Ristanka me zërin e saj të fortë e të vendosur. — «Ku është parë të bëhet vajza pilote? Nuk jemi në gjendje lufte që të përgatisim vajzat aviatore», — thonë. Nuk jemi kështu e nuk jemi ashtu dhe ma bëjnë mendjen dhallë. Dhe sa bukur që flasin për emancipimin, pa! — u tall ajo. — Po ç'emancipim është ky, kur djemtë kanë të drejtë të dëshirojnë e të bëhen ç'duan, kurse ne... I kam bërë një letër ministrisë së mbrojtjes... Kam qejf të mos më pranojnë. Atëhere do t'i shkruaj shokut Enver. Nuk kam për të pyetur më njeri për këtë gjë. Ka njerëz që tremben për vete dhe u ngrenë pengesa të tjerëve... E, de, do t'i shkruaj, — u nxeh ajo, — dhe ke për të parë po nuk më dërgoi menjëherë në shkollën e aviacionit... Si thua ti?

— Shkruaji! — i tha me gjithë shpirt Drandja, së cilës sikur iu ndez një shkëndijë në mendje dhe i rrahu zemra fort.

— Ashtu do të bëj. Me të filluar provimet e maturës, do t'i shkruaj. Gjatë kësaj kohe do të jem përgatitur edhe më mirë... Do të arrij të vërtitem rreth vetes me duar të mbledhura deri në njëqind e njëzet herë në minutë pa m'u marrë mendtë. Edhe në hekur do të vërtitem më shumë se pesëdhjetë herë. Ke për të parë...

Drandja nuk e kuptoi ç'lidhje kishin këto të vërtitura me pilotimin e aeroplanit, po nuk pyeti.

— Lumja ti! — i tha dhe iu hodh Ristankës në qafë.

Gjimnazistja vështroi malësoren dhe u step.



Sytë e saj qenë të përlotur dhe, në muzgun e mbrëmjes, iu dukën më të mëdhenj, më të ndritshëm dhe, për çudi, fare të bardhë.

— Drande!

— Ah, moj motër! — psherëtiu malësorja. — Të kam zili... Unë jam në hall të madh.

— Pse?

— Kam prind e jam jetime, kam shtëpi e nuk kam strehë...

— Nuk të marr vesh...

— Dëgjo, pra, historinë time, — vendosi të zbrazej Drandja dhe i tregoi gjimnazistes gjithë ç'i kishte ndodhur. Pastaj të dy vajzat heshtën, heshtën gjatë, gjersa Ristanka e rrëmbeu nga krahu malësoren dhe i tha:

— Hajt të lëvizim, se lëshuam rrënjë! — dhe, pas pak, duke ecur ngadalë, e mbështetur në krahun e saj, i dha zemër:

— Mos u mërzit, — i tha. — Ashtu e kanë prindërit nganjëherë. Ime motër dashuronte një djalë dhe erdhi koha që të martohej. Dërgoi dy shoqe që t'ja tregonin nënës. Nëna ja rrëfeu babait. Babai u nxeh dhe e rrahu motrën. I tha të mos dilte as në punë, po ajo nuk e dëgjoji. Doli të nesërmen në fushë dhe nuk u kthye më në shtëpi. Kaloi një vit dhe babai as emrin e saj nuk donte të dëgjonte. Po ja që u pajtuam, si padashje. Në fillim ime motër vinte në shtëpi kur nuk ishte babai, fshehurazi. Ai e mernte vesh, po bënte sikur nuk dinte gjë, gjersa një ditë e gjeti brenda dhe e pyeti rëndë-rëndë për të shoqin dhe për një-rëzit e tij. Që atëhere u pajtuam dhe shkojnë shumë mirë.

Edhe prindërit e tu kështu do të bëjnë. Ata vetë do ta kuptojnë gabimin... Ti shkruaju përsëri. Një fjalë e mirë të vret më shumë se pushka, thotë një plak në fshatin tonë. Po, ama, e përlulur mos u trego! — gati sa nuk e urdhëroi ajo. — Ne duhet të zëmë vendin që na takon edhe në familje, edhe në shoqëri... Unë nuk jam në një mendje as me time motër, as me ata që mburrin vajzat që veprojnë si ajo. Unë për vete dua të luftoj dhe t'iu dalë të tjerëve ballë për ballë, pa frikë dhe pa turp, gjersa mbroj të drejtën time. Edhe sikur të ma bëjnë mishin copa-copa, unë nuk tundem... Apo nuk kam të drejtë?

Drandja nuk foli, po i shtrëngoi krahun e brishtë gjimnazistes dhe vështroi përpara në errësirë.

— Ç'mendon?

— E di çka? — u gjallërua papritur Drandja.

— Do të vazhdoj edhe unë shkollën... Kam dëgjuar se edhe në Tiranë, edhe në Shkodër ka konvikte...

— Mrekulli! Ja, kjo nuk më kish vajtur në mendje, — thirri Ristanka. — Strehë për ne është e tërë Shqipëria!

KAPITULLI I DHJETË

As kish pandehur ndonjëherë Pjetër Ndreka se do të merrte letër nga e shoqja, ndaj edhe nuk vente kurrë të pyeste si të tjerët në shtabin e sektorit. Kur i tha Vuksani se i kish ardhur letër nga shtëpia dhe i tregoi zarfin, ai ja mori të birit nga dora dhe lexoi me vështirësi emrin e tij, që ishte shkruar me laps kopjativ të lagur. Nga prapa, po me atë shkrim të kujdesshëm, që u ngjante ushtrimeve që bëjnë nxënësit në fletoren e bukurshkrimit, Pjetri lexoi me zë emrin e së shoqes dhe ja ktheu zarfin të birit. Ndjeu në atë çast edhe një farë malli e gëzimi, që mezi u duk në një shkrepëtimë jetëshkurtër të syve.

— Thirr edhe Trinkën, — i tha të birit — dhe na e këndo!

Të tre vanë dhe u ulën në cepin e sheshit të sektorit. Pjetri shtriu këmbët përpara dhe u mbështet rëndë në listelat e gardhit. Trinka ndënjë pranë tij me këmbë të mbledhura dhe me duar të lidhura te gjunjët.

Vuksani e ktheu zarfin nga drita dhe e grisi me kujdes. Nxori letrën që ishte shkruar dhe ajo me laps kopjativ në një mes fletoreje dhe pa në fund emrin e s'ëmës, që qe shënuar, ndryshe

nga teksti i letrës, me gërma të mëdha e të shkrif-
ta. Emrin e kish shkruar ajo vetë, kurse letrën
dukej se e kish shkruar vëllai i vogël i Vuksanit.

«Lusim të jeni mirë me shëndet. Ne të gjithë
jemi shëndoshë e mirë, siç na keni lënë. Para tri
javësh nisëm edhe Trinkën në hekurudhë, se
kështu kishin dhënë fjalën në organizatën e ri-
nisë. Jemi në merak të madh për të. Kanë kaluar
kaq ditë dhe nuk na ka shkruar. Na thanë se jeni
bashkë dhe sikur u qetësuam, po prapë merakun
e kemi.

Këtë letër po ta shkruaj unë, gruaia jote.
Ka një javë që u bë mbledhja e fshatit. Meqë nuk
ishe ti, vajta vetë, bashkë me djalin e me nusen.
Atje u fol për të ngritur kooperativën. Të gjitha
fshatrat e kanë ngritur dhe ne kishim ngelur të
fundit. Nuk pati njeri që të ishte kundër. Edhe
unë vendosa dhe hyra në kooperativë. Kemi dorë-
zuar tokën, dhjetë krerë dhi, plugun dhe kaun. Na
kanë lënë për kopsht djerrinën afër shtëpisë
bashkë me hardhitë e lisave. Këto ditë unë dhe dy
djemtë kemi punuar për të shembur gjerdet e
për të rrafshuar hendeqet. Nusja nuk ka dalë
në punë. Thamë të të pyesim ty më parë, me-
gjithëse këta të organizatës na u qepën keq. Koo-
perativa ka nevojë për krahë pune.

Në fshat kanë ardhur edhe dhjetë djem e
dhjetë vajza nga Lushnja, që punojnë bashkë me
ne. Në shtëpitë tona kanë caktuar një vajzë, që
thotë se është agronome. E pyetëm edhe për ju.
Na tha që nuk ju njihte, po na e hoqi merakun,
se na foli shumë fjalë të mira për hekurudhën.

Si thua ti, a nuk do të ishte mirë të kthehe-



she sa më parë në fshat? Tani Trinkka është bashkë me Vuksanin dhe kujdes për ta nuk duhet të kesh. T'i duhet të vish, se janë ditët e para në kooperativë dhe për shumë gjëra ne nuk dimë si të bëjmë. Themi se nuk kemi bërë keq që hymë edhe ne njësh me të tjerët, pa pritur fjalën tënde».

— E ç'duhet fjala ime më? — turfulloi Pjetri. — Nuk ka më burra...

Trinka vështroi e nemitur të vëllanë. Ai heshti një çast, pasaj lexoi në cepin e letrës dy fjalë të shkruara me shkrim të imtë:

«Përsëndetje nga malësia. Sotira Ndini».

— Do të jetë ajo agronomja — tha me gjysmë zëri Trinkka, po as i ati, as i vëllai nuk ja ushqyen fjalën.

Vuksani palosi letrën mendueshëm, e futi përsëri në zarf dhe ja zgjati të atit. Pjetri e mori, e vështroi një herë nga të dy anët dhe e grisi qetë-qetë e çikë-çikë. I mblodhi copëzat e letrës në dorë, i shikoi edhe një herë dhe i hodhi poshtë. Pa folur, u ngrit, lidhi duart prapa dhe u largua me hap të ngadalshëm, kokulur.

— Edhe kjo u bë — tha me vete. — Do të bëhej, patjetër do të bëhej... E dija unë. Të gjithë e dinin, po s'ma merrte mendja të bëhej kaq shpejt dhe kaq lehtë. Dhe ajo nuk priti, — u zemërua me të shoqen. — Vate shpejt dhe hodhi firmën. Edhe vajzën ma dërgoi këtu pa më pyetur. Doemos. Po jo! Unë...

— He, ç'mendon, axhë? — i thirri komandantja e sektorit dhe i doli para me atë trupin e saj të shkurtër e të ngjeshur.

Pjetri, u përmend.

— Hiç, — i tha dhe deshi të vazhdonte shetitjen. Komandantja i doli në krah dhe eci me të, si pa të keq. Pak më parë ajo kish biseduar me Vuksanin dhe ai i kish folur për letrën që u kishte ardhur.

— A thua se je mërziur kot? — e ngacmoi përsëri vajza. — Nuk të kam parë ndonjëherë kaq të zymtë. . .

— Me orë është njeriu, herë kthjellohet, herë vrenjtet, si puna e motit.

— Pa shkak?

— Edhe pa shkak — ja preu shkurt ai, që donte të çlirohej nga shoqëria e saj dhe të mbetej vetëm, të mendohej, të brente veten më tepër se të mendohej, se ç'kish qenë për t'u bërë që bërë edhe pa mendimin e tij. Po të kish qenë në fshat edhe ai vetë, nuk do të që ndarë nga shokët. Do t'i qenë dhimbsur edhe toka, edhe kau, edhe dhitë, po dhimbjen do ta kishte fshehur dhe, si gjithë të tjerët, do të kish thënë: le të bëhet ashtu siç thotë partia. Dhe do ta kish thënë këtë fjalë jo për të gënjyer veten e të tjerët, po për të bindur veten dhe të tjerët. Kish njëzet e ca vjet që ishte mësuar t'i thoshte shpesh këto fjalë edhe pa qenë fort i sigurt dhe i qartë për ç'do të bënte, po gjithnjë për të mbarë i kish dalë dhe, veç së mirës, gjë të keqe nuk kish parë gjatë gjithë kësaj kohe. Edhe kur kishin prishur kishën disa muaj më parë, ai që zemëruar në fillim dhe kish sharë të rinjtë, që e kishin marrë këtë vendim në mbledhjen e organizatës së tyre. E dinte që për këtë vendim kishin gisht edhe Vuksani e Trinka dhe që grindur me ta. Bile, i kish ndaluar të merrnin pjesë në këtë aksion.

Ata nuk ja kishin kthyer fjalën, po të nesërmen kishin vajtur bashkë me shokët e shoqet dhe i kishin kërkuar çelëset priftit. Po atë ditë ishte mbledhur fshati dhe, duke pasur priftin përpara, një mësonjës kish lexuar disa pjesë nga ditari i klerikut. Ai fliste për vajzat e fshatit, përshkruante bukuritë e tyre dhe lakminë e tij. Mësonjësi lexoi vetëm ato pjesë, që flisnin për vajzërinë e disa grave të martuara dhe nuk zuri në gojë asnjë të re, po kushdo që kishte vajzë në shtëpi, e vështronte priftin në ato çaste me urrejtje e me neveri. Një grua që ngritur në mes të kuvendit dhe e kish pështyrë. Prifti, që kish lidhur duart dhe nuk guxonte të ngrinte kokën përjetë, kish fshirë pësh-tymën dhe prapë kish marrë qëndrimin e mëparshëm.

Kur mbaroi leximin mësonjësi, që ngritur një fshatar e kish pyetur:

— Pa të na thotë padria ç'janë gjithë këto poshtërsira?

— Tundime të të mallëkuarit, — që përgjigjur prifti me gjysmë zëri dhe, që të lehtësonte veten, kish shtuar: — Unë si qyqar, vetëm dëshiroja dhe shkruaja, kurse shokët e mi...

Pjetër Ndreka, atë mbrëmje, u kish thënë fëmijëve:

— Mirë bëtë që e pastruat edhe atë hale. Le të bëhet siç thotë partia... — dhe kish vështruar me inat të shoqen, që kish bërë kryq.

Edhe kooperativa do të ngrihej. Ai nuk e kuptonte pse, po e dinte që do të ngrihej dhe kish dëgjuar sa përparime të mëdha kishin bërë ato fshatra që qenë kolektivizuar. Veç zemra nuk i kish thënë po gjer atëherë.

— A do ta ngremë edhe ne kooperativën, o Pjetër Ndreka? — e kishin pyetur para se të vente në hekurudhë.

— Si gjithë shokët edhe ne — u qe përgjigjur ai shkurt e në mënyrë të papërcaktuar. Nuk kish pandehur që kjo punë do të bëhej aq shpejt dhe, në vend të tij, do të vendoste e shoqja.

— Sot mërzia jote nuk më duket pa shkak — shtoi vajza, që t'i jepte rast Pjetrit të tregonte vetë ç'kish ngjarë. — Mos je mërzitur këtu në hekurudhë dhe ke qejf të kthehesh në fshat?

— Po të mërzitesha, nuk qëndroja — u përgjegj ai ftohtë. — Nuk më detyroi njeri...

— A e di pse të pyes?

— Hë!

— Se ne të rinjtë jemi të rrëmbyer. Mbase ke parë ose ke dëgjuar gjë, që të ka thyer zemrën. Ka në brigada edhe djem, që bëjnë shaka të tepëruara. Mos kush e di... — dhe vajza i hodhi krahun Pjetrit dhe u kthye në drejtim të gardhit, ku priste akoma Vuksani me Trinkën.

Pjetri pa ata dhe vuri buzën në gaz, duke vështruar me të tallur e me bisht të syrit komandan-ten e sektorit.

«Do të ketë biseduar me ta — mendoj — dhe kërkon të më blejë mendjen mua. Po je e vogël, moj rrumbullakja e axhës, që të më dredhosh mua». Megjithatë bëri sikur nuk kuptoi gjë dhe i la përsëri radhën të fliste. Vetë ecte gjithnjë ngadalë e mendueshëm, me duar të lidhura prapa.

— Nuk kam të drejtë?

— Për çfarë?

— Ja, që ka edhe të rinj që e kanë kuptuar keq

revolucionarizimin e jetës dhe luftën kundër zakoneve të këqia dhe paragjykimeve e marrin si luftë kundër të moshuarve. Për ta çdo plak është një mikrob, ose një sabotator.

— E pastaj? — u nxeh Pjetri nga kjo mbrojtje gjithë takt.

— Jo — u tërhoq komandatia, — thashë mos të kanë hedhur ndonjë fjalë...

— Unë dëgjoj ç'thotë partia dhe Enver Hoxha, nuk u ve veshin fjalëve që mund të thotë ndonjë rrugaç... Edhe ti — u nxeh malësori — dili krah ndonjë të mbeturi, e jo mua... A më kupton?

Vajza u step, bile edhe u tremb nga toni, me të cilin Pjetri i shqiptoi fjalët e fundit. Ajo nuk e priste këtë shpërthim dhe, tani që biseda kish marrë atë rrugë, nuk qe e zonja ta kthente përsëri gjendjen në dobi të saj për t'i thënë malësorit ato pak fjalë që kish menduar t'i thoshte.

Pjetri e vështroi përsëri me bisht të syrit dhe i erdhi keq kur pa fytyrën e saj të skuqur dhe vështrimin e hutuar që e kish përqëndruar te Vuksani e Trinkka, sikur priste që ata të ngriheshin e t'i vinin në ndihmë. «Kështu e kanë të rinjtë» mendoi Pjetri. «Rrëmbejnë flakë shpejt, po, meqë nuk maten mirë, kur thonë fjalën e parë, e kanë të vështirë të vazhdojnë bisedën më gjatë. Ja, kjo rrumbullakja» qeshi ai me vete «flet bilbil nëpër mbledhje, kurse tani, me t'u zemëruar unë, e humbi pusullën dhe nuk di ç'të thotë.»

— Më fal, axhë, — i tha komandantja. — Unë ju nderoj...

— Po, moj bijë, ti ke të drejtë, veç nuk duhej të m'i kishe thënë mua ato fjalë, se pasha...

(ai deshi të thoshte pasha Krishtiu), po, besa, sikur dikush të më quante mua mikrob ose sabotator, do ta pështyja në fytyrë dhe do t'i thoshja të vente shpejt e të shihej në pasqyrë, pale si dukej. Armiq janë ata që na kthejnë e u kthejmë pushkën. Edhe ata, që duan t'i kthejnë pushkën shoqi-shoqit, armiq janë. Apo s'thotë kështu partia?

— Ke të drejtë — deshi ta zbuste komandantja.

— Doemos që kam të drejtë. Ju jeni djem e vajza të mira boll, veç na dëgjoni edhe neve, se nuk kemi vetëm thinja në kokë dhe rrudha në fytyrë, por e njohim jetën. E jeta na thotë se armiqtë gjithnjë kanë dashur të na përçajjnë. Kështu ka bërë, sa mbaj mend unë, edhe Turqia, edhe sërbi, edhe italiani, edhe diversantët. Po shqiptarët, bija ime, kanë qenë gjithnjë të mbledhur grusht. Tani që kemi edhe partinë...

— Ashtu është, po...

— Edhe këtë të keqe keni ju të rinjtë: ja merrni tjetrit fjalën nga goja. E kam vënë re edhe në mbledhjet tuaja. Nuk keni durim.

— Më fal!

— Falur e bekuar qofsh! — qeshi Pjetri dhe u mundua të kapë fillin e mendimit të lënë përgjysmë, po në vënd që të vazhdonte arësytimet, tha papritur:

— A e di ti pse kam ardhur unë në hekurdhë?

Pyeti dhe qëndroi para Vuksanit e Trinkës, që u ngritën më këmbë.

— Kam dëgjuar diçka.

— E, pra, unë nuk erdha që të punoja.

Ai u ul dhe i bëri shenjë edhe komandantes që të ulej pranë tij.

— Po pse erdha, do të thuash ti? As unë nuk e di pse erdha. E fejuara e këtij, — dhe tregoi të birin me dorë, — u ngrit në mbledhje të fshatit dhe prishi fejesën, që ne e kishim lidhur me të atin e saj, kur këta ishin a s'ishin dy vjeç. U ndodhëm në një dasmë, na pëlqeu muhabeti dhe, aty për aty, i dhamë edhe fjalën edhe dorën njëri-tjetrit. Dasmorët pinë edhe nga një gotë raki për shëndetin e çiftit të ri. Do të thuash ti që kemi bërë gabim. E po mirë, tani edhe unë ashtu them, po kur u nisa nga fshati për këtu, mendjen e kisha tym dhe shpirtin sterë. Po të më kish dalë ndonjë nga ata përpara, pushkë nuk do të shtija, po do ta kisha pështyrë në fytyrë. Dhe erdha këtu të piquesha me tim bir. Se ç'desha t'i thoshja e seç desha të bëja, as unë nuk e di. Di vetëm që doja të bëja diçka, ta hiqja turpin nga vetja dhe t'ua lija në derë atyre.

— Ç'turp?

Pjetri vështroi vajzën një çast dhe e pyeti:

— E fejuar je?

— Po.

— Sikur të të linte i fejuari, nuk do të ishte turp për ty?

— Pse të më lejë? Ne...

— E di, po sikur...

— Keq do të më vinte, po turp jo... I turpëruar do të mbetej ai që do të bënte një gjë të turpshme...

— Ah, moj bijë, e di që kanë ndërruar shumë gjëra, po për këtë nuk ma mbush dot mendjen.

Bota duan të qeshin. Djalin, edhe kur e qortojnë për gjëra të tilla, më shumë e përkëdhelin, kurse vajzën e merr dreqi...

— Pse?

Pjetër Ndreka pa të bijën që ishte mbështetur në listelat e gardhit, u mat të thoshte diçka, po ndërroi mendje.

Trinka e kuptoi që ai nuk donte të fliste fare hapur në prani të saj dhe ktheu kokën nga rruga që të krijonte përshtypjen se nuk interesohet për bisedën e tyre.

— Dua të them — e kapërxeu fjalën Pjetri — se erdha këtu për tjetër gjë. Po ç'sjell ora, i thonë një fjale, nuk sjell viti. Ndodhi që erdha nga Rrogozhina këtu tok me Pal Vatën. Ai vinte të shihte të bijën, që po jepte shpirt, unë vija të hakmerresha kundër një vajze. Më erdhi turp, të them të drejtën. Sado që në kokë kisha po ato mendime, zemra sikur filloi të më qërohej. Dhe e di ç'kam menduar këtu në hekurudhë? Vajzat gjithnjë mund të kishin bërë punë të mëdha. Po ç'punë të mëdha mund të bënin ato, kur edhe pushkën, edhe fjalën e kishim ne? Tani, po. Veç, — dhe tundi gishtin dëftonjës, në fillim nga e bija, pastaj nga komandantja, — mos harroni një fjalë. Vërtet ne të vjetrit lypset ta shpejtojmë hapin, që t'ju ndjekim pas, po edhe ju mos vraponi kurrë pa mend në kokë. Sado e mirë që të jetë koha, njerëz të ligj do të ketë gjithnjë...

— Do t'iu tregojmë vendin! — ja preu fjalën komandantja.

Pjetri tundi kokën dhe buzëqeshi.

— Dhe më pyete pse jam i mërzitur — e

ndërroi fjalën malësori, që nuk ishte aq optimist, sa aksionistja. — Ja, — dhe i tregoi copëzat e letrës që qenë shpërndarë në barin e shkelur e të pluhuruar. — Më dërgoi letër gruaja dhe më thotë se ka hyrë në kooperativë.

— Shumë mirë.

— Ajo më shkruante — vazhdoi Pjetri pa i dhënë rëndësi entuziazmit të komandantes, — se duhet të kthehem në fshat. Ja, për këtë mendojta. . . Erdha këtu dhe u munda. Këtu ka ardhur edhe Marta Prendi, e fejuara e këtij — tregoi me gisht të birin. — Unë, sa e shoh, ndërroj rrugë e fytyrë, kurse këta vetë kanë nisur t'i tundin kokën njëri-tjetrit.

— Baba!

— Nuk të fola ty — iu hakërrua të birit dhe e shikoi me inat.

Të katër heshtën.

Komandantja e sektorit u mat të thoshte një fjalë e të qetësonte Pjetrin, po asgjë e mënçur nuk i vinte ndër mend. Dhe, në këtë rast, ajo e dinte që duhej thënë patjetër një fjalë me mend, që të zinte vend dhe të mos e acaronte më keq malësorin e turbulluar. Malësorët janë njerëz me seldër. Ata mendojnë, vuajnë, gëzojnë si gjithë të tjerët, po para të tjerëve e fshehin gjithshka dhe krijojnë përshtypjen se lidhen menjëherë pas fjalës.

— Po — tha Pjetri me zë të lartë, pa iu drejtuar askujt. — Do të kthehem! — Dhe u ngrit, sikur do të nisej që n'atë çast për në fshat. — Do të kem frymë ta ngjit edhe këtë të përpjetë — përfundoi në mënyrë të papërcaktuar dhe vësh-

troi përpara në muzgun e mbrëmjes, i papërqëndruar në ndonjë vend.

Sytë i qenë përlotur.

Ata lotë në sytë e Pjetër Ndrekes nuk i pa njeri. Ai u nis i pari drejt barakës, që t'ua fshihte të rinjve dobësinë e tij.

KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Vuksani mori dy ftesa: një për vete, një për të motrën. Kish vendosur që asaj mbrëmje të fliste patjetër me Marta Prendin. Një ndjenjë e turbullt, pa asnjë pikësynim të përcaktuar, e shtyn-te drejt saj, sa që mund të themi se kishte marrë trajtën e një fiksacioni. Ai prapë kish filluar të mendonte për Martën me një ftohtësi që e habitte edhe atë vetë, po edhe që e mundonte, si një sëmundje. Nuk kish një qëllim dhe asnjë ngacmin nuk i shkaktonte ajo vajzë dhe prapë seç e shtynte ta takonte e të bisedonte me të në sy të të tjerëve. As se si do ta takonte, as se ç'do t'i thoshte nuk kish menduar. Kur i thanë që shtabi i sektorit do të organizonte një mbrëmje dëfrimi me brigadat e malësisë e të gjimnazistëve, ai vate ndër të parët për të marrë ftesat.

— Nuk e kam ditur që je kaq i dëshiruar për mbrëmje vallëzimi, — i tha me shaka Shkëlzen Kola, komandant i brigadës, duke i dhënë ftesat. — Apo... — dhe luajti gishtat e dorës për t'i thënë se dyshonte.

— Ah! — i thirri Vuksani dhe i ra kokës me ftesat. — Kujton se të gjithë janë si ti.

— Jo, besa, po ky interesim kaq i madh nuk më duket i kotë. Ti nuk di as të kërcesh.

— Dhe mendon se gjithnjë vetëm ti ke për të kërcyer? — ja ktheu edhe Vuksani me të qeshur dhe u largua, që t'u linte radhën të tjerëve për të marrë ftesat.

— Do të vallëzohet patjetër — tha me vete dhe u drejtua për në barakën e vajzave, që të thërriste Trinkën.

Vajzat qenë ulur sipër shtretërve dhe qeshnin me zë të lartë. Vuksani njohu të motrën, Dranden, që ishte mbështetur në mur dhe kish shtrirë këmbët përpara, Marta Prendin, që bëri sikur nuk e pa, po e qeshura i ngriu në buzë. Një vajzë e veshur me rroba doku blu, që dallonte prej të tjerave, se nuk kishte as gozhup, as shall aksionisti, u kish rrëfyer diçka për të qeshur vullnetareve dhe, meqë nuk e pa Vuksanin kur hyri, e qëndronte prapa portës, vazhdoi të fliste, pa pritur që malësoret e reja të pushonin së qeshuri:

— Po tani është ndryshe. Ua mbledh unë edhe burrave, edhe djemve. Sus rrinë. Kur më caktuan përgjegjëse turni, ata qeshën, kurse unë qava. Vajta në drejtori dhe përplasa këmbët kur i thonë fjalës. Iu qava edhe sekretarit të organizatës bazë. Ata më rrihnin supet dhe më përcollën me fjalë të mira, po vendimin nuk e ndërruan. S'ka — më thanë, — do të bëhesh përgjegjëse turni dhe kemi besim që punët do të të venë mbarë.

«Ç'mbarë zeza» thoshja me vete. Ku isha unë e zonja për të drejtuar gjithë ata punëtorë? Gjer atëhere vetëm pulat kisha trembur. E si mund të drejtoja? «Po nuk të patën frikë» thoshja me vete

«të mori lumi! Duhet të bërtasësh, të nxihesh nga inati», kurse unë, po të bija me ndonjë shakaxhi, do t'ja shkrepja të qeshurit.

Edhe në shtëpi tërë hundë e buzë vajta. Babai më dëgjoi dhe tha prerazi:

— Hiç mos ua zgjat. Dhe po nuk pranuan, ik nga puna fare, se edhe ndonjë nevojë të madhe s'kemi. Sa të kthehet yt vëlla nga ushtria dhe bëhemi pesë rroga në shtëpi.

Kështu futa sherrin në familje. Babai, kohë më parë, ja kish bërë edhe nënës këtë propozim. «Lëre punën dhe merru me shtëpinë» i kish thënë. «Mjaft fshive e pastrove kopshtet dhe shkollat e Lushnjës!» Po nëna ja preu hovin. Ajo edhe kur dëgjoi fjalët që më tha mua, iu kthye:

— Ç'është kjo mendje, more?

Babai u zemërua më keq. Atij nuk i pëlqenin kundërshtimet dhe aq më pak talljet:

— E po ta lëmë të bëhet përgjegjëse turni — tha.

— Ç'të keqe ka? Nuk thua shyqyr që e kanë vajzën me sy të mirë.

— Me sy të keq s'kanë pse ta kenë, po edhe përgjegjësitë e vajzave nuk më pëlqejnë. I kam parë. Të gjitha vajzat, që kanë pasur punë me përgjegjësi, kanë mbetur pa u martuar.

— Se nuk kanë qenë të mira, pa.

— Të mira kanë qenë që ç'ke me të, po ti nuk e kupton, moj dritëshkurtër, që burrat nuk duan të kenë komandante në shtëpi. Hë, më gjej, po të jesh e zonja, një burrë, që ta këtë marrë gruan me pozitë më të madhe se të tijën. Asnjë.

— Edhe ato e kanë vrarë lart, siç duket! — nuk deshi të jepej nëna.

— Le ta vrasin lart sa të duan. Beqarë me përgjegjësi të mëdha rrallë gjen.

Unë i dëgjoja dhe, disa herë, u mata t'u thoshja të mos bëheshin merak për martesën time, se unë e kisha gjetur vetë atë që do të merrja. Dhe, ndershmërisht, t'ju them, një nga arësyet që nuk doja të isha përgjegjëse turni, qe edhe ajo që thoshte babai. Ai që doja unë ishte punëtor dhe më vinte rëndë të isha përgjegjëse e tij. Po të kishin caktuar atë, unë nuk do të qaja; do të krenohesha.

— Po tani? — pyeti Marta Prendi.

Zëri i saj Vuksanit iu duk ndryshe nga ç'e kish dëgjuar në radio.

— Tani ja kam kaluar edhe në një gjë tjetër. Mua më kanë pranuar kandidate për në parti, kurse ai është akoma anëtar i bashkimit të rinisë. Dhe shkojmë shumë mirë. Edhe burrave u vjen mirë kur nderohen gratë e tyre.

— Besa jo! — tha një nga malësoret. — S'ka burrë që të gëzohet kur mburrin gruan e tij. E ka për turp.

— Kanë ndërruar kohët, shoqe e dashur — iu kthye punëtorja. — Iku koha e baba Qemos.

— Andej nga ne — jo.

— Edhe andej do të ndërrojnë dhe shpejt bile; po e di ç'keni ju? Ngrihemi tani, se na presin ka- valierët, pa kemi edhe dy javë për të biseduar — dhe u hodh e para nga shtrati.

Vajzat zbritën, duke qeshur.

Vuksani, që ishte ulur në shtratin e poshtëm, afër derës, u ra në sy papritur dhe u preu hovin e të qeshurave. Punëtorja e re, e rrëmbyer në gëzi-

min e të gjithave, kur e pa, i buzëqeshi me përzemërsi dhe iu kthye vajzave:

— Nuk ju thashë që na presin? — dhe tregoi me dorë Vuksanin.

Asnjëra nga malësoret nuk guxoi të qeshte si më përpara.

Punëtorja ngeli ngushtë, po shakatë nuk i la: — Apo nuk keni ardhur të merrni damën? — i tha Vuksanit. Djali u skuq nga turpi dhe nga inati.

Marta Prendi kaloi prapa shoqeve dhe doli jashtë e para, kurse Trinkë iu afrua të vëllait.

— Të lutem, shoqe, mos u tall — iu kthye ai punëtores. — Kemi ardhur për tjetër punë këtu në hekurudhë dhe jo për dama... — dhe pa pritur më gjatë, mori Trinkën për dore dhe u nda prej tyre.

— Ç'është ajo vajzë? — pyeti të motrën.

— Punëtore. Është nga ato të grupit të kandidatëve për anëtarë partie, që i kanë sjellë në hekurudhë për t'u kalitur. Është vajzë shumë e mirë. Gjithnjë e qeshur dhe gjithnjë gjen nga një histori për të na treguar.

— Do t'ju edukojë — tha me të keq Vuksani.

Vajzës nuk i erdhi mirë. Ajo e kish vënë re shumë herë që edhe i ati, edhe vëllezërit e saj, sa herë u mbetej qejfi ose prekeshin në sedër, ishin të padrejtë ndaj të tjerëve dhe flisnin shumë hidhur kundër tyre. Në të tilla raste biseda ndërpritej vetvetiu dhe secili bluante në vetëvete.

Trinkës nuk iu duk me vend të heshte kësaj radhe.

— Ti kot flet kështu. Ajo nuk na mban kon-

ferenca, po, të them të drejtën, unë po mësoj më tepër prej saj se prej atyre leksioneve që na bëjnë mbas pune.

— E ç'ke mësuar?

Trinka u mendua. As vetë nuk dinte ç'kish mësuar prej asaj punëtores gazmore. Ç'është e vërteta, kish mësuar si prodhohej karta prej druri e prej kashte, si përdoret energjia elektrike, që ajo kujtonte se vlen vetëm për ndriçim, për të vënë në lëvizje maqineri të rënda dhe, çudia më e madhe, si nxirrej pleh nga ajri. Po a ishin këto gjëja kryesore që kish mësuar prej punëtores? Jo. Ajo ishte e sigurt që kish mësuar më tepër, edhe prej fjalëve, edhe prej vetë sjelljeve dhe pranisë së saj, po këtë ishte e vështirë t'ja shpjegonte shpejt e shpejt të vëllait.

— Pse nuk përgjigjesh?

— Nuk e them dot me fjalë. Po ta kisha njohur dy-tri vjet më parë, doemos këtu e jo në fshat, sot edhe unë do të isha si ajo.

— Ke të drejtë — u tërhoq Vuksani. — Edhe unë, po të kisha shkuar në aksion dy-tre vjet më parë, ndryshe do të isha. Po, ani! Më mirë vonë se kurrë. — dhe vështroi të motrën në mënyrë të atillë, sa që asaj iu duk se po shqyrtonte ndryshimet që kishin pësuar. Pastaj i tha befas: — Do të vemi në mbrëmje sonte!

Vajza e kish bërë fjalë të vente me shoqet, po të vëllait i tha:

— Si të duash.

— Ke mësuar të vallëzosh?

— Me gjithë mend pyet?

— Pse?

— Nuk më pëlqen. Më duket, se edhe ti po tallesh.

— E, pra, nuk ke ndryshuar aq sa thua.

— Jo, besa, edhe njëqind vjet të rroj, gjithnjë marri ka për të m'u dukur ky farë vallëzimi.

— As me burrin tënd s'ke për të kërcyer? — qeshi Vuksani.

Trinka në fillim u prek nga kjo pyetje, po kur pa të vëllanë të qeshte, e goditi me pëllëmbë në shpatulla.

— Ti je fare! — i tha.

Ai shpejtoi hapat dhe hyri në barakë, duke kaluar brinjas nëpër aksionistët, që ishin grumbulluar te dera.

Ngjitur me muret, ishin rreshtuar fronat. Në frona qenë ulur aksionistët. Ai vështroi rreth e rrotull. Akoma gjeje vende të lira, po ai nuk vendoste, gjersa kish mundësi të zgjidhte. Në qoshe të sallës dalloi Marta Prendin, që kish ndenjor me trupin drejt e me duart të mbështetura në gjunjë. Ajo dukej e qetë, pa asnjë mendim në kokë, pa asnjë çqetësim. Shoqet pranë saj bisedonin e qeshnin. Ajo vështronte drejt dhe dukej se jetonte në ato çaste në një botë tjetër.

Edhe pranë saj kishte vende të lirë. Vuksani bëri disa hapa përpara, po prapë qëndroi dhe u kthye në drejtimin e kundërt. Nuk i pëlqeu guximi që kish marrë.

Një vajzë ja bëri me dorë. Ai njohu punëtorin, që pak më parë kish shakatuar me të dhe mendoj keq. Po vajza, pa përfillur mendimin e keq të Vuksanit, shtyu aksionistët që kishte pranë dhe liroi një copë vend në fron.

— Ku do të ulemi? — pyeti ai të motrën, që sapo kish hyrë dhe qëndronte pranë tij.

Trinka vështroi sallën. Punëtorja e ftoi edhe atë me dorë.

— Ulemi te Naja..

Vuksani nuk foli dhe nuk kundërshtoi. U ul pa i folur vajzës, që i kish ftuar, duke lënë të motrën pranë saj. Në krahun tjetër ishin Drandja dhe Ristanka, ajo gjimnazistja trupvogël e zeshkane, që kish veshur një bluzë të verdhë me vija të zeza horizontale dhe ngjante si grerëz.

— Më dukesh i zemëruar — i tha Naja Vuksanit.

— Jo — i tha ai, pa ja hequr sytë gjimnazistes, të cilën edhe donte ta shihte, edhe druhej prej saj; edhe kish dëshirë t'i afrohej, edhe i vinte zor. Prania e saj e gëzonte dhe e shtypte. Vajzë e çuditshme.

— Kujtova se i more për keq fjalët që të thashë pak më parë në barakë... Po të jesh fyer, më fal. Unë e pata pa të keq... Jam mësuar me shokët e fabrikës. Ne gjithnjë qeshim e trazojmë njëri-tjetrin, po nuk zemërohemi lehtë... Edhe kur zemërohemi, shakatë e të tjerëve na bëjnë të qeshim edhe me lot në sy.

— Ne nuk jemi mësuar ashtu — tha Vuksani. — Tek ne vajzat qeshnin me vajzat e djemtë me djemtë.

Trinka i ra me bërryl të vëllait, po ai nuk i dha rëndësi.

Naja e kuptoi që Vuksani deshë ta fyente. Pra- pa atyre fjalëve ajo dalloj një mendim të keq dhe

një farë shpirtligësie. Po edhe ajo nuk u dha rëndësi dhe pyeti si fëmijë:

— Pse?

Vuksani e pati të vështirë t'i përgjigjej kësaj pyetjeje të thjeshtë. Jo se s'kish ç't'i thoshte punëtores, po se e pa që çdo gjë që t'i thoshte do t'i acaronte marrëdhënjet me të. Nga kjo e keqe e shpëtoi orkestra.

— Do të kërcejmë bashkë? — i tha Naja.

Vuksani u ngrit. Ai nuk kish vallëzuar ndonjëherë. Shihte si lëviznin këmbëttë tjerët dhe mundohesh të imitonte, pa vënë re se shtrembëronte trupin.

Naja ndjente dorën e Vuksanit, që i kish rënduar në bel dhe i vinte për të qeshur me ato lëvizjet mekanike të këmbëve të tij, që edhe pse nuk dinte, donte të tregohej si i sigurt.

— Dy majtas, një djathtas — i tha ajo dhe u largua prej tij, që të kish mundësi të kontrollonte lëvizjet. — Ja, kështu... shumë mirë — dhe iu afrua përsëri.

«Sikur të na shihte i fejuari i saj!» mendoi Vuksani, kur ndjeu pranë trupin e ngrohët të vajzës. Për të vajza për djalin mund të ishte motër ose grua. Martesa, e, në mos martesa, marrëdhënjet e përkohshme burrë-grua ishin për Vuksan Ndrekën si edhe për shumë të tjerë, të vetmet lidhje, që mund të krijoheshin ndërmjet djemve dhe vajzave. Ky mendim atë e shtypte dhe e ndrydhte, siç shtypte e ndrydhte shumë moshatarë të tij, që kurrë më parë nuk kishin pasur punë e qëllime të përbashkëta me moshataret e tyre.

— Edhe unë nuk ka shumë kohë që kam më-

suar — i tha Naja, kur pa se këmbët e Vuksanit zunë të lëviznin pak a shumë sipas ritmit të muzikës.

— Në fabrikë mësova, herë me një shok, herë me një tjetër. Tani më mbajnë të gjithë për kërcimtare të mirë...

— Po i fejuari yt? — i shpëtoi Vuksanit e tha.

— Nuk të kuptoj.

— Të fejuarit tënd i pëlqen kjo gjë?

— Pse të mos i pëlqejë? — u habit punëtorja.

— Unë nuk do ta lija të fejuarën time të kërcente me një tjetër — tha ai i vendosur.

— Pse?

— Është turp.

— Po ti pse kërcen me mua?

— Unë?... — u përtyp Vuksani.

Naja e kuptoi që malësori mendonte shumë keq për të dhe buzëqeshi hidhur.

U ulën përsëri.

Vuksani fshiu djersët me shami dhe vështroi të motrën sikur donte t'i thoshte: «E shikon? Nuk jam më ai i pari».

Vallëzoi pastaj me grerëzën dhe, të tretën herë, u ngrit dhe i vajti Marta Prendit.

Aksionistët pëshpëritën. Vajza u turbullua nga kjo e papritur dhe u drodh nga frika e nga turpi.

— Nuk di të kërcëj — i tha me zë të mekur. po ai e kapi nga dora dhe ajo iu bind forcës së tij. Ndjeu dorën e fort që i qarkoi belin, dorën tjetër që shtrëngonte dorën e saj dhe trupin e tij të mbështetur në trupin e vet. Duart i dridheshin. I dridheshin këmbët dhe gjithë trupi.

— Dy majtas, një djathtas — i tha ai, pa ja

vënë veshin orkestrës, që ekzekutonte një ritëm të shpejtë.

— Nuk di — përsëriti ajo dhe deshi të çlirohej, po ai e tërhoqi me vete dhe e shpuri në mes të sallës.

— Si quhesh? — i tha.

Vajza e vështroi me habi, po vështrimi i tij e detyroi të përgjigjej:

— Marta Prendi...

— Unë jam Vuksan Ndreka — i tha ai... — Besoj se ma ke dëgjuar emrin...

— Po — mori guxim vajza. — Ka kohë që e kam dëgjuar emrin tënd, po nuk të kisha njohur...

— As unë nuk të kisha njohur...

Orkestra ndërroi ritëm. Vuksani vazhdonte, duke pasur gjithnjë kujdes që të hidhte dy hapa majtas, një djathtas. Ai tani kishte në krahët e veta Marta Prendin dhe ishte i gëzuar e krenar. Nuk mendonte të lidhej përsëri me të. Kish vetëm një dëshirë: ta kuptonin të tjerët se ai qëndronte më lart nga ajo. Vështronte shokët me krenari dhe mundohej të gjente fjalë për të vazhduar bisedën.

— Paske dalë sulmonjëse — i tha, duke vështruar shenjën dallonjëse në gjoksin e Martës.

— Ka një javë — i tha ajo dhe mori frymë e lehtësuar kur pushoi orkestra. Ai e mbajti edhe disa sekonda në krahët e veta, e vështroi me ngulm, po valltarët u rralluan dhe ai s'kish ç'të bënte më. E lëshoi.

Secili shkoi në vendin e vet.

— Ç'ishte kjo që bëre? — i tha e motra me zemërim.

— Ç'bëra? — iu kthye ai buzëgaz e krenar.



- Të kish qenë baba këtu...
— Unë kisha vendosur me kohë...
— Dhe ç'nxore në dritë?

Vuksani nuk iu përgjegj: po i buzëqeshi vetes dhe ndjeu një lehtësi të madhe në trup. Peshat shtypëse dhe e zyrtë e sedrës së fyer nuk i rëndonte më. Ai ishte çliruar një herë e për gjithmonë prej saj dhe ishte i gëzuar.

— Do të vallëzojmë përsëri bashkë? — i tha gjimnazistes, që i shëmbëllente me grerëzat.

Ajo i buzëqeshi.

— Po ti kur do të mësosh? — iu kthye së motrës.

Marta Prendi u kthye në vendin e vet dhe u ul midis shoqeve. Edhe ajo ishte e qetë dhe e lehtësuar, siç është njeriu kur ka kaluar me sukses një provë të vështirë. Ja, pra, — mendonte, — sa e thjeshtë është jeta! Më pranë e në shoqëri gjithshka merr tjetër kuptim, bëhet më e pastër.

— Vallëzove bukur, — e ngacmoi një nga vajzat.

Ajo e vështroi dhe heshti një çast, që të he-tonte mos deshën ta tallnin, po në sytë e shoqes gjeti vetëm përzemërsi të çiltër.

— Jo, — iu përgjegj edhe Marta me të qeshur. — Ishte hera e parë që vallëzoja dhe nuk i hidhja hapat aq me siguri. Herët e tjera do të vallëzoj më mirë.